



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 23 regjistër (JR)  
Datë 19.10.2018

Nr. 19 i vendimit  
Datë 26.07.2019

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

|                        |                  |
|------------------------|------------------|
| <b>Albana Shtylla</b>  | <b>Kryesuese</b> |
| <b>Rezarta Schuetz</b> | <b>Relatore</b>  |
| <b>Luan Daci</b>       | <b>Anëtar</b>    |
| <b>Sokol Çomo</b>      | <b>Anëtar</b>    |
| <b>Natasha Mulaj</b>   | <b>Anëtare</b>   |

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 26.07.2019, ora 11:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 23, datë 19.10.2018, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 46, datë 24.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Xhezair Zaganjori.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Neni C, pika 2, Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seanca publike<sup>1</sup>, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 46, datë 24.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Xhezair Zaganjori dhe shkarkimin e tij nga detyra, bazuar në kriterin e pasurisë, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

<sup>1</sup> Të zhvilluara në datat: 25.06.2019, 10.07.2019 dhe 17.07.2019. Vendimi përfundimtar u shpall më datë 26.07.2019.

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Xhezair Zaganjori (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë gjyqtar/kryetar i Gjykatës së Lartë, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 4, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë.
2. Subjekti i rivlerësimit është bërë subjekt deklarues në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) në vitin 2003<sup>2</sup>. Në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”) i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”) i ndryshuar, subjekti ka dorëzuar gjatë viteve 2003-2016 deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë dhe, për efekt të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016 deklaratën e pasurisë (në vijim “deklarata *vetting*”), brenda afatit ligjor<sup>3</sup>.
3. ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016<sup>4</sup>, i ka dërguar Komisionit raportin përfundimtar, në të cilin konstaton se:
  - i. deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
  - ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
  - iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
  - v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), pasi ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ka hartuar raportin përkatës të deklasifikuar pjesërisht, me vendim të KDZh-së nr. 25, datë 30.01.2018, duke konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës<sup>5</sup>.
5. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale dhe i ka dërguar Komisionit raportin përfundimtar.<sup>6</sup> Në lidhje me këtë kriter vlerësimi, Komisioni shprehet se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 46, datë 24.07.2018, ka vendosur: “[...] Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori, me detyrë kryetar i Gjykatës së Lartë [...]”.

**6.1. Vendimi i mësipërm (nr. 46/2018) i Komisionit është bazuar në vlerësimin e të tria kriterëve**

---

<sup>2</sup> Me numër indeksi {\*\*\*}.

<sup>3</sup> Dorëzuar më datë 30.01.2017.

<sup>4</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 06.11.2017.

<sup>5</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 26.10.2017.

<sup>6</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 15.11.2017.

të rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.<sup>7</sup> Më konkretisht, pasi ka administruar të tria raportet e vlerësimit – raportin përfundimtar të ILDKPKI-së, raportin e DSIK-së dhe raportin e KLD-së – dhe pasi shqyrtoi provat dhe dëgjoi publikisht subjektin e rivlerësimit, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, Komisioni ka vlerësuar se subjekti Xhezair Zaganjori për *kriterin e kontrollit të pasurisë*, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.<sup>8</sup>

**6.2.** Bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, gjatë hetimit administrativ Komisioni është ndalur në kontrollin e deklarimeve të subjektit ndër vite, në deklaratën *vetting* dhe në vlerësimin e saktësisë, mjaftueshmërisë dhe burimin e ligjshëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Nga ky hetim kanë rezultuar disa gjetje/problematika. Në këto kushte, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime dhe, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e gjetjeve. Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të administruar, deklarimeve dhe shpjegimeve të subjektit, rezultoi se subjekti ka pasaktësi dhe mospërputhje të deklarimeve të mëparshme me deklaratën *vetting*. Në lidhje me këtë, Komisioni arsyeton se sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor, prej ku fillon të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore, është pikërisht kjo deklaratë dhe të dhënat që ajo përmban. “[...] Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të Pasurisë, dhe jo me deklaratimet e mëparshme të tij. Këto deklarime mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Konkluzioni përfundimtar i Komisionit do të duhet të nxirret nga motivi dhe sjelljet e subjektit, nga mënyra e plotësimit të deklaratës *vetting* dhe nga të dhënat e hedhura në të. Përdorimi i deklarimeve në vite shërben për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë [...]”<sup>9</sup>. Në vlerësimin e Komisionit, këto pasaktësi dhe mospërputhje nuk u gjykuan si indicie që të çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të pajustificuara apo fshehje të pasurisë. Në këtë vlerësim, u mbajt parasysh fakti që subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e bërë në deklaratën *vetting*.

Më tej, Komisioni ka arsyetuar se pasaktësitë në deklarimet e viteve të kaluara nuk lidhen me deklarimin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi nxjerrja e konkluzionit për “deklarim të pamjaftueshëm”, në lidhje me pasurinë, bëhet mbi bazën e shkakut kushtetues, kur vërtetohet se subjekti, sipas deklaratës *vetting*, nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë, apo përpiqet të kryejë fshehje apo deklarim të rremë të pasurisë. Komisioni çmon se në këtë rast pasaktësitë e konstatuara nuk çmohen se cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësisë.

Për sa më sipër dhe sipas vendimit, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe duke balancuar vlerën e këtyre pasaktësive me provat e tjera të administruara nga Komisioni, gjatë hetimit Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të veta, si detyrim kryesor kushtetues i tij. Në këtë vlerësim, Komisioni shprehet se u mbajt parasysh edhe periudha e rivlerësimit të këtij subjekti.

<sup>7</sup> Shih nenin 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

<sup>8</sup> Shih faqen 36 të vendimit të Komisionit.

<sup>9</sup> Shih faqen 35 të vendimit të Komisionit, paragrafi 48.

**6.3.** Për kriterin e kontrollit të figurës, sipas Komisionit, bazuar në raportin e përcjellë nga DSIK-ja, subjekti i rivlerësimit ka rritur një nivel të besueshëm. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës. Në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja, ka administruar informacionin që disponohet për subjektin e rivlerësimit nga institucionet ligjzbatuese dhe ka dërguar një raport në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku në përfundim konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.<sup>10</sup>

**6.4.** Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në analizë të raportit të vlerësimit të kryer nga KLD-ja, Komisioni vlerësoi se subjekti ka arritur një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale.

### **III. Shkaqet e ankimit**

7. Komisioneri Publik ushtroi ankim<sup>11</sup> ndaj vendimit nr. 46, datë 24.07.2018, vetëm për vlerësimin e gabuar të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas Komisionerit Publik, referuar provave dhe gjetjeve nga hetimi administrativ, në balancë me dokumentet dhe pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në konsideratë edhe të rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”)<sup>12</sup>, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të përmbushë detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Po ashtu, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 (barra e provës), subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me prova dhe shpjegime bindëse të kundërtën e rezultateve të hetimit, rrjedhimisht edhe përfundimet e arritura nga Komisioni për vlerësimin e pasurisë së subjektit nuk gjenden të drejta<sup>13</sup>.
8. Ankimi i Komisionerit Publik për kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, lidhet me elementet që i referohen: *i) saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramenteve të subjektit për qëllim të procesit të rivlerësimit (pika 2 e nenit D, dhe sipas rastit, aplikimi i nenit D, pikat 1 dhe/ose 5 të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me nenin 32, pika 5 dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016); dhe ii) ligjshmërisë së pasurisë – shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive në pronësi ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit apo të personave të lidhur me të.*
9. Në qëndrimin e shprehur në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare, të parashtruara në seancën e datës 17.07.2019, mbështetur në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet D, Ç dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 66 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik kërkoi nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 46, datë 24.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Xhezair Zaganjori.

#### **A. Shkaqet e ankimit për vlerësimin e pasurisë**

10. Në ankim, Komisioneri Publik parashtrroi shkaqe që lidhen me arsyetime dhe interpretime ligjore të gabuara të Komisionit për sa i përket nenit D, pikave 3, 4 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, në ndërthurje me nenin 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe shkaqe që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

<sup>10</sup> Shih faqen 36 të vendimit të Komisionit.

<sup>11</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 12.10.2018.

<sup>12</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 06.08.2018 - shih <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/Rekomandimdat%C3%AB-6.8.2018.pdf>

<sup>13</sup> Shih faqen 4 të ankimit të Komisionerit Publik, paragrafi 9.3.

11. Sa u përket interpretimeve ligjore, Komisioneri Publik argumentoi se Komisioni është mbështetur në arsyetime të gabuara lidhur me përmbajtjen dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe të legjislationit të posaçëm të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për pasojë<sup>14</sup>:

i) *argumenton se* në interpretim të nenit D, pikave 3, 4 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, pagesa e taksave dhe tatimeve gëzon mbrojtje të veçantë ligjore dhe këto dispozita janë shprehje e garancisë për forcimin e sistemit fiskal të shtetit. Në zbatim të pikës 3 të nenit D të Kushtetutës dhe dispozitave në fuqi për tatimin mbi të ardhurat, e ardhur e ligjshme do të jetë ajo e ardhur për të cilën provohet se është paguar detyrimi tatimor ose ato të ardhura për të cilat pagimi i tatimit është përjashtuar me ligj. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, është ligji “kualifikuesi” i vetëm i atyre rasteve kur mospagimi i tatimit për shkak të përjashtimit përkatës ligjor të shprehur nuk do të përbëjë shkak për kalimin e barrës së provës dhe mundësisë për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit D, pikës 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. Për rrjedhojë, nga kontrolli administrativ që kryhet për burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, duhet të provohet nëse përmbushen në mënyrë kumulative dy kushte: a) titulli juridik i krijimit të pasurisë duhet të jetë detyrimisht, në çdo rast, i ligjshëm (veprim juridik i lejuar nga ligji); dhe b) të jenë përmbushur pagesat e detyrimeve ligjore eventuale (detyrimi tatimor është paguar ose është i përjashtuar me ligj)<sup>15</sup>;

ii) *nuk pajtohet me* arsyetimin e Komisionit lidhur me trajtimin juridik që u bën pikave 3 dhe 4 të nenit D të Kushtetutës. Më konkretisht, së pari, lidhur me vendin që zë deklarata *vetting* dhe kontrollin vetëm sipas kësaj deklarate, dhe së dyti lidhur me prezumimin ligjor absolut të fajësisë së subjektit të rivlerësimit dhe prezumimit ligjor relativ të burimit të ligjshmërisë së burimeve. Komisioneri Publik në lidhje me të parën sjell në vëmendje qëndrimin e shprehur<sup>16</sup> se deklarata *vetting* nuk është dokumenti i vetëm ligjor nga ku fillon përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit. Ndërsa për të dytën, Komisioneri Publik çmoi se neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës vendos detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, ndërsa pika 4 e së njëjtës dispozitë parashikon rastin kur subjekti ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, prezumohet në favor të shkeljes disiplinore dhe duhet të paraqesë prova që të vërtetojë të kundërtën. Këto parashikime kushtetuese qëndrojnë të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk mund të konsiderohen me natyrë kumulative), edhe në përcaktimet e nenit 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, ku këto dy situata qëndrojnë si raste të veçanta, të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk mund të konsiderohen se zbatohen vetëm në mënyrë kumulative;

iii) *nuk pajtohet me* arsyetimin e Komisionit se organet *ad hoc* të rivlerësimit kalimtar kanë juridiksion ekskluziv të vlerësojnë vetëm shkeljet sipas ligjit nr. 84/2016, në bazë të deklaratës *vetting*, dhe jo shkeljet e tjera që mund të jenë kryer ndër vite nga subjektet e rivlerësimit, në bazë të deklarimeve të mëparshme, të cilat potencialisht mund të përbëjnë kundërvajtje administrative. Po kështu, Komisioneri vëren se nuk ka argumente dhe bazë ligjore për të hequr nga kontrolli i pasurisë, për qëllim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, edhe shkeljet e deklarimeve periodike

<sup>14</sup>Shih: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-46-dat%C3%AB-24.7.2018-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%AB-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-z.-Xhezair-Zaganjori.pdf>

<sup>15</sup>Shih faqet 6 dhe 7 të ankimit.

<sup>16</sup>Shih: <http://ikp.al/2018/08/28/ankim-kunder-vendimit-nr-47-date-25-7-2018-te-kpk-se-per-subjektin-e-rivleresimit-z-astrit-faqolli/>

ndër vite, pasi ato marrin vlerën e provës, sikurse parashikohet në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, së bashku me provat e tjera, për të arritur në një konkluzion të drejtë;

iv) *gjen të pambështetur* vlerësimin e Komisionit se ka hapësira/boshllëk ligjor, të cilin subjekti e ka shfrytëzuar në favorin e tij nëpërmjet kontratave fiktive, duke shmangur pagesën e detyrimeve tatimore e duke kryer evazion tatimor të ligjshëm, e trajtuar gjerësisht në vijim të ankimit;

v) *konsideron se* shpjegimet e dhëna prej subjektit të rivlerësimit mbetën në nivel deklarativ, duke mos arritur të provojnë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, në kushtet kur nga rrethanat juridike, vetëm aktet në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga ligji mund t'i nënshtrohen testit objektiv të vlerës provuese;

vi) *çmon se* konkluzioni i Komisionit se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të tij, pas kalimit të barrës së provës, nuk u përgjigjet provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, referuar gjendjes së akteve mbi të cilat është marrë vendimi, nga të cilat rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të argumentojë dhe të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, edhe pas kalimit të barrës së provës, duke mos plotësuar kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

12. Në konkluzionet përfundimtare<sup>17</sup>, në lidhje me këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik vlerësoi se janë shtuar dy elemente nga koha e depozitimit të ankimit. I pari lidhet me jurisprudencën e krijuar nga trupa të ndryshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ku kanë gjetur trajtim dhe interpretim gjyqësor çështjet thelbësore që lidhen me konceptet kushtetuese dhe ligjore të rivlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. I dyti, sikundër u parashtrua nga subjekti i rivlerësimit, është botimi i një manuali nga një grup autorësh shqiptarë, ku pasqyrohen interpretimet përkatëse për përmbajtjen e shtesave dhe ndryshimeve të një pjese të tekstit të Kushtetutës dhe të Aneksit të saj. Komisioneri Publik i kërkoi trupit gjykues që, bazuar në shkaqet e ankimit, të mbajë të njëjtin qëndrim që është mbajtur në vijimësi nga ana e Kolegjit, në interpretimin e çështjeve që kanë të bëjnë me zbatimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016 dhe që trajtojnë koncepte të tilla, si: (a) burimi i ligjshëm i pasurisë; (b) të ardhurat e ligjshme; (c) raporti i deklaratës *vetting* me deklaratimet vjetore ndër vite; (d) shkaqet e shkarkimit për deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, elemente këto që sipas Komisionerit janë shtjelluar në argumentimin ligjor të vendimeve të marra nga trupa të ndryshëm gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si vijon: (i) nr. 4/2018; (ii) nr. 6/2018; (iii) nr. 7/2018; (iv) nr. 9/2018; (v) nr. 12/2018; (vi) nr. 1/2019; (vii) nr. 5/2019; (viii) nr. 6/2019; (ix) nr. 7/2019; (x) nr. 8/2019; (xi) nr. 9/2019 etj.
13. Referuar *vlerësimit të pasurive*, shkaqet e ankimit grupohen në katër çështje kryesore që lidhen me: (i) vlerësimin e pasurive të paluajtshme [pesë pasuri]; (ii) përfitimin e qirave ndër vite; (iii) shpenzimet për shkollimin e fëmijëve; dhe (iv) mosmbulimin e shpenzimeve me të ardhura të ligjshme për tri (3) vite [2011, 2012 dhe 2014], të trajtuara më poshtë.

13.1. Për katër pasuritë e paluajtshme, të ndodhura në të njëjtin pallat, me cilësimin: “apartament banimi” me sipërfaqe 293 m<sup>2</sup>, “dyqan/bibliotekë” me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, “bodrum” me sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>, “zyrë” me sipërfaqe 15 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, ndërtuar në vitin 1997,

---

<sup>17</sup>Shih: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/Parashtrimet-e-%C3%A7%C3%ABshtjes-dat%C3%AB-17.7.2019.pdf>

shkaqet e ankimit janë të njëjta, duke qenë se sipas Komisionerit Publik edhe momenti i fitimit të tyre është i njëjtë. Komisioneri Publik parashtrroi sa vijon.

*i) Lidhur me origjinën e krijimit të këtyre pasurive:* këto pasuri janë fituar nga kontrata e shitjes së pasurive të paluajtshme të lidhura më datë 06.10.2001, në Tiranë, nga shitësit H.M. dhe Sh.Z., tek pala blerëse N. dhe Xhezair Zaganjori (të vetëm në 1 kontratë dhe me 6 persona të tjerë në 3 kontrata të tjera).

*ii) Lidhur me momentin (kohën) dhe mënyrën e fitimit të pasurisë,* provat e administruara gjatë hetimit të Komisionit – kontratat noteriale të shitblerjes të datës 06.10.2001 – në të cilat është materializuar vullneti i palëve para organit të ngarkuar me ligj, janë i vetmi veprim juridik që dëshmon momentin e kalimit të të drejtave të pronësisë dhe mënyrën e fitimit të pronësisë. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit se momenti i fitimit të pronësisë është viti 1997, kur sendi i ri, i zhvilluar urbanisht, është përfunduar dhe krijuar<sup>18</sup>, mbetet në nivel teorik ashtu sikurse edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbeten në nivel deklarativ, pasi gjenden të pambështetura në prova dhe fakte të administruara për këtë qëllim.

*iii) Lidhur me vlerën e këtyre pasurive,* subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht pasi ka ndryshime midis deklaratës *vetting*, deklaratës periodike të vitit 2003 dhe vlerës që përmban kontrata e shitblerjes. Për pasojë, mospërputhjet mes vlerave reale e ngarkojnë subjektin me përgjegjësi për deklarim të pasaktë në deklaratën periodike 2003 dhe mungesë të shpjegimit të bindshëm të pasurisë së krijuar në deklaratën *vetting*. Komisioneri Publik argumentoi se qëllimi i fiktivitetit të kontratës së shitblerjes lidhet me regjistrimin e pasurisë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (në vijim “ZRPP Tiranë”) me vlerë më të vogël, me qëllim shmangien e pagimit të detyrimeve fiskale që rrjedhin nga kalimi i pronës së paluajtshme.

*iv) Lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive,* subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar saktësisht burimin, duke pasur parasysh mospërputhjet midis deklaratës *vetting* dhe deklaratës periodike të vitit 2003. Referuar analizës financiare të shtrirë brenda periudhës pranverë – verë 1999, vit në cilin subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si moment të krijimit të të ardhurave, Komisioneri Publik vlerësoi se të ardhurat personale dhe të ardhurat nga qiratë mbeten në nivel deklarativ dhe të pambështetura në dokumente provuese.

**13.2.** Komisioneri Publik vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi nuk provohet vlera reale e këtyre pasurive me dokumentacion mbështetës si plan investimi dhe/ose fatura, preventiv apo situacion punimesh për të provuar vlerën e saktë të investuar për fitimin e pronësisë. Edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk ka arritur të justifikojë bindshëm burimin e krijimit të pasurive<sup>19</sup>.

**13.3.** Në konkluzionet përfundimtare për këto pasuri, Komisioneri Publik parashtrroi se në referencë të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vlerën e deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën vjetore të pasurisë për vitin 2003; (ii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për vlerat e deklaruar; (iii) ka mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive në vlerën 10.700.000 lekë. Komisioneri Publik vëren se gjatë

---

<sup>18</sup> Shih paragrafin 2, faqja 9 e vendimit të Komisionit.

<sup>19</sup> Shih paragrafin 20.2., faqja 14 e ankimit.

gjkimit të çështjes në Kolegj, pas paraqitjes së akteve të tjera, qëndrimet e subjektit të rivlerësimit mbeten të nivelit deklarativ.

**13.4.** Për pasurinë “apartament” me sipërfaqe 81 m<sup>2</sup> (pasuria e 5-të), në lagjen {\*\*\*}, Durrës, blerë në vitin 2006, Komisioneri Publik, referuar edhe pikës 2.11 të rekomandimit të ONM-së, çmoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë provë për të provuar tërheqjen e shumës 16.000 USD të deklaruar rishtas si burim krijimi në përgjigjet ndaj pyetësorit të Komisionit, të datës 1 mars 2018<sup>20</sup>. Për rrjedhojë, diferenca prej rreth 1.760.000 lekësh (konvertuar me kursin mesatar të vitit 2006, sipas Bankës së Shqipërisë), rezultoi e pambuluar me të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

**13.5.** Në konkluzionet përfundimtare, Komisioneri Publik parashtrroi se subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj provoi plotësisht burimin e ligjshëm dhe ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga bashkëshortja e tij, znj. N.Z., por nuk arriti të provojë se mbyllja e llogarisë prej 16.000 USD në një nga bankat e nivelit të dytë, ishte përdorur për krijimin e kësaj pasurie.

**13.6.** Për ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja pas vitit 2001, të deklaruara si burim krijimi pasurie dhe mbulimin e shpenzimeve për vitet në vijim, Komisioneri Publik në referim edhe të pikës 2.8 të rekomandimit të ONM-së, vlerësoi se këto të ardhura nuk i konsideron të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, përderisa nuk provohet pagimi i detyrimit tatimor, duke argumentuar se:

i) *Lidhur me të ardhurat e qirasë për periudhën 2001-2006*, nuk rezultoi të jetë provuar me dokumentacion provues pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara në vitet 2001-2006 (dokumentacioni është paraqitur për pagesën e detyrimeve tatimore nga “{\*\*\*}” vetëm për vitin 2006), me qëllim konsiderimin e këtyre të ardhurave si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës;

ii) *Të ardhurat e qirasë për vitin 2007* nuk mund të konsiderohen si të ardhura të subjektit të rivlerësimit, pasi nuk ka asnjë dokumentacion provues se për realizimin e këtyre të ardhurave është shfaqur vullneti ligjor i tij, si dhe nuk vërtetohet se pjesa takuese ka shkuar apo është ndarë edhe në favor të tij.

**13.7.** Në konkluzionet përfundimtare, Komisioneri Publik parashtrroi se në referencë të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e ligjshme nga qiratë, për shumën totale prej rreth 8,4 milionë lekësh.

**13.8.** *Lidhur me shpenzimet për shkollimin e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit*, Komisioneri Publik konstatoi se nuk është administruar asnjë dokumentacion apo e dhënë provuese mbi: (i) kostot e shkollimit (të tilla si dokumente bankare); (ii) akomodimit; dhe (iii) jetesës së fëmijëve në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Gjermani, duke mos justifikuar gjithë shpenzimet e kryera mbi shkollimin e tyre. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

**13.9.** *Lidhur me mosmbulimin e shpenzimeve vjetore me të ardhura të ligjshme*, Komisioneri Publik, referuar edhe pikës 2.14 të rekomandimeve të ONM-së, duke marrë në përlllogaritje të ardhurat e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon dhe nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet

---

<sup>20</sup> Shih paragrafin e parë në faqen 12 të përgjigjeve të kthyer në datën 01.03.2018, të pyetësorit të datës 14.02.2018.



vjetore si vijojnë: për vitin 2011, në vlerën 189.647,22 lekë; për vitin 2012, në vlerën 1.372.389,92 lekë dhe për vitin 2014 në vlerën 891.772,31 lekë, pasi mungon dokumentacioni provues, gjë që provon se subjekti nuk justifikon dhe mbulon shpenzimet e kursimet me të ardhura të ligjshme.

14. Në konkluzionet përfundimtare<sup>21</sup>, lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik riparashtrroi se për të gjitha shkaqet e ankimit, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik theksoi se edhe pas paraqitjes së akteve të tjera gjatë këtij gjykimi, në seancat e datës 25.06.2019 dhe 10.07.2019, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, të krijuara nga të ardhura të ligjshme, duke mos plotësuar kështu kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe se qëndrimet e tij, në kuptim të detyrimit për të provuar të kundërtën, mbeten më së shumti në nivel deklarativ.

#### IV. Shpjegimet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit

15. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016<sup>22</sup>, në nenin 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012<sup>23</sup> dhe në nenin 456 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim “K.Pr.Civile”)<sup>24</sup> ka ushtruar të drejtën e apelit kundërshtues më datë 22.10.2018, duke kundërshtuar shkaqet e ankimit dhe duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. 46, datë 24.07.2018, të Komisionit.<sup>25</sup>

15.1. Subjekti i rivlerësimit, sipas shkaqeve të ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik, parashtron se:

- i) *njoftimi formal mbi përmbajtjen e ankimit dhe të rekomandimit* është marrë më datë 17.10.2018 së bashku me ankimin, duke mos i dhënë atij vetë mundësinë e njohjes me arsyet e rekomandimit dhe, si rrjedhojë e kësaj, subjekti arsyeton se u gjend në pamundësi për t’u mbrojtur dhe për të komentuar çdo gjetje dhe argument para se Komisioneri Publik të vlerësonte nëse duhej apo jo të ushtronte ankim;
- ii) janë në zbatim të drejtë dhe në përputhje me Kushtetutën argumentimet e Komisionit mbi interpretimet e nenit D të Kushtetutës për pasurinë e ligjshme, llojet e prezumimeve të pasurisë së paligjshme, qëllimet e evidentimit të pasurive të pajustificuara, juridiksionit të organeve të procesit të rivlerësimit, mënyrës se si qarkullon civilisht pasuria dhe se Kolegji duhet të konfirmojë për efekt të nomofilatisë dhe mbarëvajtjes së procesit të rivlerësimit kalimtar këto standarde. Subjekti argumenton se procesi i rivlerësimit ka për qëllim të testojë integritetin pasuror, moral dhe profesional të gjyqtarëve, në mënyrë që pas përfundimit të tij të jetë fituar besimi i publikut në sistemin e drejtësisë. Sipas tij, qëllimi i nenit D të Kushtetutës nuk është

---

<sup>21</sup> Të parashtruara në seancën e datës 17.07.2019 – shih <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/Parashtrimet-e-C3%A7%C3%ABshtjes-dat%C3%AB-17.7.2019.pdf>

<sup>22</sup> Ligji nr. 84/2016, neni 4 “Objekti dhe parimet e procesit të rivlerësimit”, pika 6: “[...] Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. [...]”

<sup>23</sup> Ligji nr. 49/2012, neni 1, pika 2: “[...] Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.[...]”

<sup>24</sup> K.Pr.Civile, neni 456 “Apeli kundërshtues” – “[...] Pala që nuk ka bërë ankim apo pala kundër së cilës është bërë ankimi, mund ta kundërshtojë atë me kundërankim brenda 5 ditëve nga dita që ka marrë njoftim për ankimin e palës tjetër. Ankimi kundërshtues duhet t’u njoftohet palëve të tjera në gjykim, sipas rregullave për njoftimin e ankimit. [...]”

<sup>25</sup> Shih poshtëshënimin 33.

mblehdhja e tatimeve, por identifikimi i pasurive të fituara në mënyrë informale dhe, si të tilla, të pajustificueshme me mënyrat e ligjshme të qarkullimit civil të pasurisë;

iii) *lidhur me 4 pasuritë e paluajtshme të ndodhura në rr. “{\*\*\*}”:*

a) mënyra e fitimit të pasurisë është me bashkim dhe me përzierje, sipas nenit 173 të Kodit Civil, kur është ndërtuar sendi. Kontratat e shitblerjes janë fiktive pasi janë kryer vetëm me qëllim që të realizohej formalisht regjistrimi i pasurive të paluajtshme. Duke qenë veprime juridike të pavlefshme, kontratat nuk prodhojnë pasoja juridike dhe nuk mund të krijojnë detyrime tatimore;

b) ndryshimet në deklaratat e pasurisë për vlerën e fitimit të pasurisë kanë të bëjnë me kostot e ndërtimit të sendit të ri dhe lidhen me diferenca prej pak metrash katrorë sipërfaqe, por nuk mund të konkludohet se është fshehur pasuria, për më tepër që është përmbushur barra e provës për të provuar ligjshmërinë e pasurisë së krijuar;

c) për burimin e krijimit të pasurisë aktet e dorëzuara janë origjinale dhe të kuptueshme, dhe është vërtetuar me informacione zyrtare saktësia e deklarimeve. Në asnjë moment subjekti nuk ka marrë dijeni se ka rrethana të paprovuara, për të cilat duhet të paraqiteshin prova të tjera;

ç) për ndërtimin e pasurisë është lëshuar leja e ndërtimit dhe është respektuar legjislacioni mbi zhvillimin urban të territorit. Në raste të ngjashme të gjykuara nga Komisioni, nuk ka marrë kaq vëmendje dhe kërkesë llogarie ndërtimi i paligjshëm dhe nuk është kërkuar, as nuk ka pasur as plan investimi, as preventivë e as situacion punimesh, duke pasur parasysh informalitetin e ekonomisë dhe veprimtarisë private në fushën e ndërtimit, në mënyrë që të mos ngarkohen me barrë të pamundur justifikimi subjektet e rivlerësimit;

iv) *lidhur me pasurinë e paluajtshme apartament, të ndodhur në Durrës, të ardhurat e bashkësisë ligjore me bashkëshorten ndër vite kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar vënien e një pasurie sikurse vlera e apartamentit;*

v) *lidhur me të ardhurat nga qiraja, marrëdhënia juridike ka pasur bashkëpronarët në cilësinë kontraktore të qiradhënësve dhe, nga ana tjetër, qiramarrësit respektivë. Çmimi i çdo qiraje mujore është përfituar nga çdo familje e bashkëpronarëve të objektit, në përpjesëtim me pjesën e tyre ideale të bashkëpronësisë. Qiramarrësi, në momentin e shlyerjes së detyrimit mujor, paguan pjesën e të ardhurave neto të qirasë; pjesa tjetër e çmimit të përcaktuar në kontratë duhet të shërbente për shlyerjen e detyrimit tatimor;*

vi) *lidhur me shpenzimet për shkollimin e fëmijëve, në deklaratat periodike të pasurisë nuk janë deklaruar shumatorët e çdo transferte periodike për shkollimin pasi më parë nuk ka pasur një metodikë të qartë për zërat e shpenzimeve që duheshin deklaruar. Shumatorja e çdo transferte të kryer periodikisht për shkollimin e fëmijëve është deklaruar në deklaratën *vetting* dhe për këtë qëllim janë bashkëlidhur edhe transaksionet bankare;*

vii) *lidhur me mbulimin e shpenzimeve me të ardhura të ligjshme për vitet 2011, 2012 dhe 2014, në çdo rast dhe në çdo vit të ardhurat familjare janë dukshëm më të larta se shpenzimet e kryera, për këto vite nuk merret parasysh deklarimi i gjendjes *cash* në shumën 900.000 lekë për shpenzime urgjente dhe, nëse vlerësohet e nevojshme, për çdo shumatore subjekti mund të argumentojë dhe të paraqesë në cilësinë e provës të vërtetën për çdo shpenzim dhe të ardhur.*

**15.2.** Në përfundim të apelit kundërshtues, subjekti i rivlerësimit vlerëson se nuk ka shkaqe ligjore për cenimin e vendimit të Komisionit dhe, në konsideratë të çfarë është arsyetuar në apelin kundërshtues, Kolegji duhet të vendosë lënien në fuqi të vendimit nr. 46, datë 24.07.2018, të Komisionit.

16. Subjekti i rivlerësimit në konkluzionet përfundimtare parashtrori që konkluzioni i Komisionit se ka kryer evazion fiskal të ligjshëm nuk bazohet në ligj dhe në prova. Shitja e pasurive në vitin 2001 është formale dhe është bërë për të përshpejtuar regjistrimin e saj në ZRPP, duke qenë se katër trashëgimtarët dhe bashkëshortët e tyre respektivë tashmë ishin pronarë prej më shumë se 4 vitesh, që përkon me periudhën kur ka ndodhur zhvillimi urban i truallit prej 250 m<sup>2</sup>, sipas lejes përkatëse të ndërtimit. Formaliteti është i qartë edhe në dukjen e thjeshtë. Duke qenë se këto kontrata nuk kanë prodhuar pasojat juridike për të cilat kanë qenë destinuar juridikisht, tjetërsimi i pasurive objekt transaksioni nuk ka ndodhur si pasojë e tyre [kontratave]. Për rrjedhojë, kontratat nuk krijojnë pasoja juridike, pasi veprimi është absolutisht i pavlefshëm.
17. Në parashtrimet e tij gjatë gjykimit në Kolegj, si dhe në konkluzionet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit vuri theksin në interpretimin e Aneksit të Kushtetutës, referuar Komentarit mbi Reformën Kushtetuese në Sistemin e Drejtësisë<sup>26</sup>, duke shprehur vlerësimin e tij për qartësinë dhe cilësinë e materialit, siç u shpreh subjekti, “të hartuar nga autorë me kualifikim të lartë profesional, shumica e të cilëve kanë qenë njëkohësisht edhe anëtarë në komisionin që ka ideuar dhe realizuar ndryshimet ligjore, duke përfshirë edhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës”<sup>27</sup>. Lidhur me shkaqet e ankimit, subjekti i rivlerësimit theksoi se provat e paraqitura në seancat e datës 25.06.2019 (23 dokumente) dhe 10.07.2019 (10 dokumente) janë pothuajse përgjigje e kërkesave të Komisionerit Publik, duke konkluduar në moscenimin e vendimit nr. 46, datë 24.07.2018, të Komisionit.

## V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit

### I. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

#### a) Juridiksioni i Kolegjit

18. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të pezullimeve, shoqëruar nga detyrimi për trajnim<sup>28</sup>. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili pas rivlerësimit, e ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Xhezair Zaganjori, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

#### b) Legjitimimi i ankuesit

19. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data

<sup>26</sup> Botim i vitit 2019 nga Instituti për Studime Publike & Ligjore (ISPL) mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA).

<sup>27</sup> Parashtrimet e subjektit në seancën gjyqësore publike të datës 17.07.2019.

<sup>28</sup> Neni F, pika 2 dhe neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, të cilët bashkërisht përcaktojnë që të vetmet vendime të cilat nuk i nënshtrohen ankimit në procesin e rivlerësimit, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, janë ato që lidhen me vendime pezulluese dhe trajnim të detyrueshëm për subjektin e rivlerësimit.

e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016<sup>29</sup>.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

20. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit nga Komisioneri Publik kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit nr. 46, datë 24.07.2018, për subjektin e rivlerësimit Xhezair Zaganjori, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në datat 25.06.2019, 10.07.2019 dhe 17.07.2017 në prani të palëve. Në seancën gjyqësore të datës 26.07.2019, gjatë së cilës u shpall vendimi, subjekti i rivlerësimit nuk ishte i pranishëm.
21. Nga fashikulli rezulton se subjektit të rivlerësimit i është dërguar me shkresën nr. {\*\*\*}prot., datë 16.10.2018, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendimi për pranimin e ankimit të Komisionerit Publik (marrë në dorëzim më datë 17.10.2018<sup>30</sup>). Nga faqja zyrtare e Komisionerit Publik, rezulton se rekomandimi i ONM-së për subjektin e rivlerësimit është kryer më datë 06.08.2018 (rreth 13 ditë kalendarike pas shpalljes së vendimit të Komisionit). Rekomandimi i ONM-së është publikuar dhe njoftuar për shtyp në faqen zyrtare të institucionit të Komisionerit Publik në të njëjtën ditë, më datë 06.08.2018<sup>31</sup>, ndërsa ankimi është kryer më datë 12.10.2018 (rreth 67 ditë kalendarike pas datës së rekomandimit)<sup>32</sup>. Seanca publike për subjektin, parashikuar nga neni 65 i ligjit nr. 84/2016, është caktuar më datë 25.06.2019, mbi tetë muaj pas njoftimit të vendimit të Komisionit për pranimin e ankimit të Komisionerit Publik. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit është informuar rregullisht për themelin e shkaqeve të ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik, duke pasur mundësinë të njihej me to, të ushtronte të drejtën për apelin kundërshtues, në përputhje me përcaktimet e nenit 456 të K.Pr.Civile, sikurse rezulton që e ka ushtruar<sup>33</sup>, si dhe të dispononte kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për të kundërshtuar shkaqet e ankimit.<sup>34</sup> Trupi gjykues vlerëson se procedura e ndjekur nga Komisioneri Publik është në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, si dhe aktet nënligjore që rregullojnë

<sup>29</sup> Vendimi nr. 46, datë 24.07.2018, i Komisionit për rivlerësimin e subjektit Xhezair Zaganjori, i është njoftuar Institucionit të Komisionerit Publik me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2018, protokolluar pranë këtij institucioni më datë 28.09.2018. Ankimi i Komisionerit Publik është përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.10.2018, protokolluar pranë Komisionit me nr. {\*\*\*}, datë 12.10.2018 (ditën e 15-të të marrjes së njoftimit të vendimit).

<sup>30</sup> Shih fashikulli nr. 16.

<sup>31</sup> Shih: <http://ikp.al/2018/10/15/rekomandim-per-vendimin-e-kpk-se-nr-46-date-24-7-2018/>;

<http://ikp.al/2018/08/06/njoftim-per-shtyp-9/>

<sup>32</sup> Shih: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-46-dat%C3%AB-24.7.2018-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%AB-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-z.-Xhezair-Zaganjori.pdf>

<sup>33</sup> Në datën 24.10.2018, Komisioni mori në shqyrtim apelin kundërshtues, datë 22.10.2018, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit. Me vendimin nr. 46/2, datë 24.10.2018, "Për mospranimin e kundërankimit të z. Xhezair Zaganjori", Komisioni vendosi të mos e pranojë kundërankimin si të paplotë dhe jo në përputhje me pikën 1 të nenit 46 të ligjit nr. 49/2012, që parashikon depozitimin e kopjeve për çdo palë të përfshirë në proces, pasi ishte depozituar vetëm në një kopje. Pas dërgimit të kopjeve të kërkuara të apelit kundërshtues më datë 27.10.2018, Komisioni me vendimin nr. 46/3, datë 29.10.2018, "Për pranimin e kundërankimit të z. Xhezair Zaganjori", ka vendosur të pranojë kundërankimin si ankim i plotë dhe në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 49/2012. Ky vendim i është njoftuar nëpërmjet shërbimit postar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.10.2018, ONM-së me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.10.2018, Komisionerëve Publikë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.10.2018, dhe Kolegjit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.10.2018.

<sup>34</sup> Shih: <http://kpa.al/njoftim-37/>; <http://kpa.al/njoftim-151/>

funksionimin e këtij institucioni. Në periudhën kohore mes ankimit të Komisionerit Publik dhe seancës publike në Kolegj kaluan më shumë se tetë muaj, gjatë të cilëve subjekti i rivlerësimit pati kohë të sjellë prova shkruese, debatoi me Komisionerin Publik në seancë publike dhe parashtrori qëndrimet dhe argumentet me shkrim dhe me gojë. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se kontradiktorialiteti i procesit nuk është cenuar. Trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se duhej t'i jepej mundësia të mbrohej dhe të komentonte çdo gjetje dhe argument para se Komisioneri Publik të vlerësonte nëse duhet të ushtrohej ose jo ankimi, është i pabazuar në ligj dhe fakte, pasi subjekti i rivlerësimit kishte të drejtë të paraqiste apelin kundërshtues në çdo rast brenda një afati 5 ditor nga dita që ka marrë njoftimin për ankimin, çka do të thotë që afati nuk lidhet me njohjen e rekomandimit të ONM-së, por të ankimit të Komisionerit Publik. E rëndësishme është të theksohet edhe se Kolegji i Posaçëm i Apelit vihet në lëvizje nga ankimi i Komisionerit Publik dhe jo nga rekomandimi i ONM-së. Gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues pasi dëgjoi shpjegimet e palëve lidhur me ankimin, në funksion të shqyrtimit të çështjes, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të administrojë në cilësinë e provave dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në seancat e datës 25.06.2019 dhe 10.07.2019<sup>35</sup>, në mbështetje të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i dha vlerë provuese çdo të dhënë që rezultonte nga aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht formës së paraqitjes, me qëllim kryerjen e një shqyrtimi garantist, përfshirë edhe aktin e ekspertimit financiar privat të datës 05.07.2019. Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerësoi edhe vlerën provuese të fotografive të vitit 1998-1999 dhe të certifikatave të vdekjes së prindërve, të sjella nga subjekti i rivlerësimit.

## *II. Mbi shkaqet e ankimit dhe të ankimit kundërshtues*

### *a) Shkaqet e ankimit lidhur me interpretimet ligjore*

22. *Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për arsyetime dhe interpretime ligjore të gabuara të Komisionit mbi përmbajtjen dhe zbatimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikat 3 dhe 4 të tij, për sa i përket: (i) burimit të ligjshëm të pasurisë; (ii) deklaratës vetting në raport me deklaratimet periodike të pasurisë ndër vite; (iii) trajtimit që duket se Komisioni u bën pikave 3 dhe 4 të këtij neni, duke i konsideruar me natyrë kumulative, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “trupi gjykues i Kolegjit”) vëren sa vijon:*

22.1. Lidhur me burimin e ligjshëm, Komisioni ndër të tjera arsyeton se jo çdo pasuri për të cilën s'është paguar detyrimi fiskal, duhet të kualifikohet *apriori* e paligjshme, pasi mundet që subjekti i rivlerësimit të shpjegojë bindshëm dhe të sjellë prova që vërtetojnë të kundërtën. Komisioni argumenton se, megjithëse detyrimi fiskal për një pasuri mund të mos jetë paguar, burimi i krijimit të saj mund të rrjedhë nga një punë apo veprim juridik që ligji nuk e ndalon apo e lejon në mënyrë të shprehur. Sipas Komisionit, mospagimi i detyrimeve fiskale mundet të konsiderohet si shkelje e etikës së magjistratit apo shkelje administrative, sipas parashikimeve respektive ligjore, por nuk mund të shërbejë si shkak për dhënien e masave disiplinore në bazë të nenit D të Kushtetutës dhe dispozitave ligjore të dala në zbatim të saj.<sup>36</sup>

22.2. Në parashtrimin e tij, Komisioneri Publik thekson se sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, e ardhur e ligjshme është ajo për të cilën provohet se është paguar detyrimi tatimor ose ato të ardhura të përjashtuara nga detyrimi për pagimin e tatimit me ligj. Është ligji “kualifikuesi” i rasteve kur mospagimi i tatimit për rrjedhë të një përjashtimi ligjor nuk do të

<sup>35</sup> *Vendime të dhëna në seancat gjyqësore publike të datave 25.06.2019 dhe 10.07.2019.*

<sup>36</sup> *Shih faqen 27 të vendimit të Komisionit.*

përbëjë shkak për kalimin e barrës së provës dhe mundësisë për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimit ligjor të deklaramit të pamjaftueshëm të kontrollit të pasurisë, përcaktuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Sipas Komisionerit Publik, subjektet e rivlerësimit në momentin e deklaramit të pasurive të tyre, duhet të provojnë edhe aktin/burimin e krijimit, i cili duhet të jetë i ligjshëm dhe detyrimet ligjore të jenë përmbushur. Dy kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative: i) pasuria bazohet në burim/akt të ligjshëm (për shembull, kontratë pune, kontratë shitjeje, kontratë qiraje, kontratë dhurimi, kontratë shkëmbimi; etj.) dhe ii) sipas rastit, detyrimi tatimor është paguar ose është i përjashtuar për atë pasuri.

**22.3.** Në apelin kundërshtues, subjekti i rivlerësimit parashtroi se analiza e Komisionit mbi interpretimin e nenit D është në përputhje me Kushtetutën. Mbrojtja e ligjit fiskal nuk ka lidhje me procesin e rivlerësimit, megjithëse ligjvënësi për njërin prej shkaqeve të prezumimit të pasurisë së paligjshme ka shquar mospagimin e detyrimeve fiskale në më pak se gjysma e të gjithë pasurisë. Subjekti i rivlerësimit konkludon se Komisioneri Publik gabon në identifikimin e kushtit të parë dhe të dytë të shquarjes së një pasurie si të ligjshme, si dhe në mënyrën si i koncepton dhe i interpreton ato më tej.

**22.4.** Lidhur me vlerën e deklaramit *vetting* në raport me deklaramet ndër vite, Komisioni ndër të tjera arsyeton se juridiksioni kushtetues dhe ligjor [i Komisionit] kushtëzohet dhe mjaftohet me kontrollin e deklaramit *vetting* të subjektit të deklaramit. Sipas Komisionit, në zbatim të nenit D të Kushtetutës, organet e rivlerësimit kanë si objekt të vlerësojnë nëse subjektet e rivlerësimit kanë fshehur pasuri (*nuk e kanë deklaruar atë*), apo nuk justifikojnë ligjërisht pasuritë e deklaramit dhe, për efekt të këtij procesi, subjektet e rivlerësimit do të plotësonin një deklaramit të re, të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pasurisë së tyre, burimeve të krijimit të kësaj pasurie dhe dokumenteve justifikuese. Pra, objekt kontrolli nga ana e organeve të rivlerësimit në kuadër të këtij procesi do të ishte vetëm deklaramit *vetting* dhe jo deklaramet e bëra ndër vite nga subjektet e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, as shkeljet e tjera që mund të jenë kryer ndër vite nga subjektet e rivlerësimit, në bazë të deklaramitve të mëparshme. Këto të fundit, potencialisht mund të përbëjnë kundërvajtje administrative (*nëse nuk janë parashkruar*), sipas ligjit për deklaramin e pasurive dhe për vlerësimin e të cilave ndër vite juridiksionin ekskluziv e ka pasur ILDKPKI-ja, si organ i përhershëm me juridiksion të zakonshëm.<sup>37</sup>

**22.5.** Në vlerësimin e Komisionerit Publik, dispozita kushtetuese nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës jep renditjen e provave, nga ku duhet të fillojë hetimi administrativ për kontrollin e pasurisë, por nuk përbën, apo nënkupton, shkakun e vetëm mbi bazën e të cilit merret vendimi i Komisionit. Duke qenë njëra nga provat, ashtu sikurse aktet e tjera të administruara gjatë procesit të përcaktimit të gjendjes së fakteve dhe të rrethanave që kanë lidhje me çështjen (neni 49 i ligjit nr. 84/2016), për shkak të urdhërimit ligjor përkatës, deklaramit *vetting* nuk ka mbivlerë mbi provat e tjera – deklaramet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja.

**22.6.** Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje se mënyra e interpretimit dhe konceptimit të Komisionit përputhet me qëndrimin e mbajtur tashmë nga Kolegji në vendimin nr. 3, datë 17.07.2018<sup>38</sup>. Duke bërë një interpretim teleologjik të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, duhet të kuptohet që qëllimi i këtij procesi nuk është të vlerësojë dhe të hetojë nëse subjektet e rivlerësimit ndër vite kanë kryer ndonjë kundërvajtje administrative apo shkelje

<sup>37</sup> Shih faqet 29-30 të vendimit të Komisionit.

<sup>38</sup> Shih <http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-F.-Lulo-pdf.pdf>

të ligjit për deklarimin e pasurive fillestare apo periodike, të cilat kanë qenë objekt i hetimit dhe verifikimit nga ILDKPKI-ja, i cili ka funksionuar si organ i zakonshëm dhe i përhershëm i vlerësimit të pasurisë të funksionarëve publikë. Qëllimi i këtij procesi është të vlerësohet nëse gjyqtarët apo prokurorët kanë fshehur pasuri, nëse nuk e kanë deklaruar atë, dhe nëse e justifikojnë ligjërisht pasurinë e deklaruar sipas Aneksit të Kushtetutës. Kjo do të thotë, sipas subjektit, se nëse ka pasur mosdeklarim apo mosjustifikim të pasurisë nga subjektet e rivlerësimit, këto organe do ta bënin ekskluzivisht vetëm në raport me deklaratën *vetting* dhe jo në raport me deklaratimet ndër vite të funksionarëve sipas ligjit për deklarimin e pasurisë.

**22.7.** Lidhur me trajtimin e pikave 3 dhe 4 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni ndër të tjera, arsyeton se prezumimi absolut i fajësisë së subjektit të rivlerësimit, konkretisht në pjesën e mosdeklarimit apo fshehjes së pasurisë, është irrelevant në çështjen objekt gjykimi. Lidhur me prezumimin relativ ligjor të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, konkretisht pjesa tjetër dhe kumulative e pikave 3 dhe 4 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerëson se subjekti dhe bashkëshortja, apo thënë ndryshe bashkësia ligjore ndër vite, kanë pasur likuiditete dhe të ardhura të mjaftueshme dhe të krijuara në mënyrë të ligjshme sa për të mbuluar shpenzimet. Për rrjedhojë, nuk mund të arrihet në konkluzionin se ka shkelje dhe shkak kushtetues dhe ligjor për të mos konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Xhezair Zaganjori.

**22.8.** Në vlerësimin e Komisionerit Publik, arsyetimet e Komisionit nuk qëndrojnë, pasi prezumimet ligjore absolute të fajësisë së subjektit të rivlerësimit dhe prezumimi ligjor relativ i burimit të ligjshmërisë nuk janë rrjedhojë e parashikimeve të nenit D, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës. Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës vendos detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive. Po në këtë nen, pika 4 parashikon që kur subjekti ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, për të prezumohet në favor të shkeljes disiplinore dhe duhet të paraqesë prova që të vërtetojë të kundërtën. Këto parashikime kushtetuese qëndrojnë të pavarura nga njëra-tjetra, janë komplementare (plotësuese) dhe nuk mund të konsiderohen me natyrë kumulative (pa njërin nuk ekziston tjetra). Zbërthimi i kësaj dispozite kushtetuese është bërë në ligjin nr. 84/2016, duke gjetur pasqyrim në nenin 61, pikat 1 dhe 3 të tij, të cilat qëndrojnë si raste të veçanta të pavarura nga njëra-tjetra dhe jo kumulative dhe që pasqyrojnë respektivisht sanksionimin kushtetues të nenit D, pikat 4 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës.

**22.9.** Subjekti i rivlerësimit shprehet se Komisioneri Publik gabon kur interpreton nenin D, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës dhe pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi leximi fillimisht i Kushtetutës dhe më tej i ligjit, nën të njëjtin këndvështrim kushtetues, bën arsyeshmë dhe lehtësisht të konkludohet se katër paragrafët rregullojnë të njëjtën marrëdhënie juridike dhe janë zgjatime të logjikës kushtetuese të shquarjes së një pasurie të pajustificuar dhe njëherazi të paligjshme për procesin e rivlerësimit. Interpretimi i kundërt do t'i humbte kuptimin edhe nenit D të Kushtetutës, edhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**22.10.** Më tej, subjekti i rivlerësimit vlerëson se Komisioni e ka interpretuar drejt nenin D të Kushtetutës mbi pasurinë e ligjshme, llojet e prezumimeve të pasurisë së paligjshme, qëllimet e evidentimit të pasurive të pajustificuara, juridiksionin e organeve të procesit të rivlerësimit, mënyrën se si qarkullon civilisht pasuria dhe se Kolegji duhet t'i konfirmojë për efekt të nomofilatisë dhe mbarëvajtjes së procesit të rivlerësimit kalimtar, këto standarde kushtetuese. Po kështu, interpretimet e Komisionit janë në të njëjtën linjë me interpretimet e Komentarit mbi

Reformën Kushtetuese në Sistemin e Drejtësisë. Nga ana tjetër, konkluzionet e Komisionerit Publik rreth interpretimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, janë jo vetëm të gabuara, por edhe të rrezikshme, pasi ato bien haptazi në kundërshtim me të drejtën e brendshme dhe standardet e mirëpranuara ndërkombëtare në këtë fushë, duke cenuar parimet themelore të demokracisë dhe të shtetit të së drejtës dhe të drejtat e njeriut, veçanërisht të nenit 1 të protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNj”)<sup>39</sup>. Subjekti në konkluzionet përfundimtare deklaroi se i gjithë debati, apo paqartësitë, në procesin e kontrollit të pasurisë i përket viteve të largëta kur nuk ka qenë gjyqtar, madje as në Shqipëri.

### *III. Arsyetimi i trupit gjykues*

**22.11.** Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, lidhur me këtë shkak ankimi dhe qëndrimin të subjektit të rivlerësimit, lidhur me burimin e ligjshëm të pasurisë, vendin që zë deklarata *vetting* në raport me deklaramet periodike të pasurisë ndër vite, si dhe trajtimin ligjor të pikave 3 dhe 4 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të zbërthyer në pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar dhe të harmonizuar të vetë Kolegjit, e cila ka shtjelluar në mënyrë shteruese se saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarameteve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë në pronësi apo në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur janë elementë përcaktues për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë, në plotësimin e kërkesave të normave kushtetuese dhe ligjore të posaçme për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.<sup>40</sup>

**22.12.** Trupi gjykues i Kolegjit, në vijim të sa më sipër, vlerëson se në kontekstin e procesit të rivlerësimit, deklarimi i saktë dhe i plotë i burimit të krijimit të pasurisë dhe të ardhurave, si dhe ligjshmëria e këtij burimi është kusht thelbësor për të kaluar testin e kriterit të vlerësimit të pasurisë. Për këtë qëllim, subjektet duhet të paraqesin dokumentacion provues mbi përmbushjen e detyrimeve tatimore. Në të kundërt, burimi, e ardhura dhe pasuria e krijuar do të konsiderohen të paligjshme dhe, për rrjedhojë, krijohen kushtet e pamjaftueshmërisë për kriterin e kontrollit të pasurisë. Udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së “Për mënyrën e deklaramet të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Udhëzimi nr. 4095/2016 i ILDKPKI-së”), ka detajuar me përcaktime konkrete që për të ardhurat e deklaruara, subjektet e

---

<sup>39</sup> *Neni 1 i Protokollit 1 të KEDNj-së parashikon: “1. Çdo individ ose person juridik ka të drejtën e gëzimit në paqe të pronave të tij. Askush nuk do të humbasë objektet në pronësi, përveçse kur e kërkon interesi publik dhe sipas kushteve të parashikuara me ligj dhe sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. 2. Dispozitat e mësipërme nuk mund të kufizojnë në asnjë mënyrë të drejtën e shtetit që të zbatojë ligjet që sheh të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm apo për të siguruar pagimin e taksave dhe kontributeve të tjera apo sanksioneve.” - [https://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_SQL.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf)*

<sup>40</sup> [http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-i-anonimizuar\\_A\\_Cama.pdf](http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-i-anonimizuar_A_Cama.pdf) (paragrafët 23-26); <http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-A.-Sevdari-i-anonimizuar-per-publikim.pdf> (paragrafi 21.20); [http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2019/06/Vendimi\\_09\\_18.04.2019\\_SR\\_-Astrit\\_Faqolli.pdf](http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2019/06/Vendimi_09_18.04.2019_SR_-Astrit_Faqolli.pdf) (paragrafët 10.1.5, 12.2.), <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/09/VENDIMI-I-ANONIMIZUAR-B-Abdullahi.pdf> (paragrafi 86) etj.



rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, duhet të provojnë me dokumentacion justifikues vërtetësinë e deklaramit dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive<sup>41</sup>.

Në dritën e sa më sipër, rrjedh që në mënyrë që pasuria në pronësi të një subjekti të rivlerësimit dhe personi i lidhur me të të konsiderohet e ligjshme duhet që njëkohësisht të jetë bazuar në një veprim të ligjshëm juridik por edhe të jetë paguar detyrimi tatimor, ose të jetë në kushtet e përjashtimit ligjor nga detyrimi tatimor.

**22.13.** Trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit bien ndesh me përkufizimin e pasurisë së ligjshme, përcaktuar shprehimisht në Nenin D pika 3 e Aneksit të Kushtetutës që shprehimisht parashikon pagimin e detyrimeve tatimore si element të ligjshmërisë<sup>42</sup>. Dispozita kushtetuese dhe ajo ligjore, qartësisht nuk lenë vend për interpretime të kushtëzuara nga “llojet e prezumimeve të pasurisë së paligjshme, qëllimet e evidentimit të pasurive të pajustificuara, juridiksionit të organeve të procesit të rivlerësimit, mënyrës se si qarkullon civilisht pasuria”, siç pretendon subjekti (shih paragrafin 22.10 më sipër), në tejkallim të qartësisë gjuhësore të zgjedhur nga ligjbërësi. Për më tepër, leximi literal i dispozitës kushtetuese dhe asaj ligjore që kushtëzon ligjshmërinë me pagimin e detyrimeve tatimore, është në harmoni me orientimet e dala në zbatim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit dhe udhëzimeve për zbatimin e saj<sup>43</sup> për deklarimin e pasurive nga funksionarët publikë, të cilat kontrollin adekuat të pasurive e kushtëzojnë me kontrollin e kryqëzuar me detyrimet tatimore të paguara nga këta funksionarë. Përveç elementit provues që ofron pagesa e detyrimeve tatimore, sipas të njëjtit burim<sup>44</sup>, verifikimit të pagesës së detyrimeve tatimore si mjet për të kontrolluar ligjshmërinë e pasurisë, për funksionarët publikë mbështetet mbi arsyetimin që këta të fundit duhet t’i nënshtrohen një kontrolli më të rreptë se qytetarët e tjerë.

Po ashtu, kontrolli i ligjshmërisë së burimeve, si një ndër qëllimet e ligjit nr. 9049/2003, ka qenë pjesë integrale e detyrimeve të funksionarëve zyrtarë, subjekte deklaruese, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit<sup>45</sup>.

Komisioneri Publik në ankimin e tij<sup>46</sup> thekson rëndësinë e forcimit të sistemit fiskal nëpërmjet pagimit të taksave dhe tatimeve me ligj dhe mbrojtjen e veçantë që gëzojnë këto burime financiare sipas Kodit Penal të vitit 1993 dhe kërkon që për këto garanci, në këndvështrim edhe të rëndësisë së sa më sipër, edhe pika 3 e nenit D të Kushtetutës të konsiderohet si shprehje e kësaj garancie. Për këtë arsye, Komisioneri vëren që të ardhurat e ligjshme duhet të vlerësohen në kuadër dhe

<sup>41</sup> Shih: <http://www.ildkpi.al/rregullore-dhe-udhezime/>

<sup>42</sup> Pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon: “[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj [...]”.

<sup>43</sup> Shih: <http://www.oecd.org/corruption/anti-bribery/47489446.pdf>, Udhëzimi Teknik i Konventës së Kombeve të Bashkuara (Technical Guide to the UN Convention (UN, 2009, pp. 25-26), ndër të tjera kërkon një “sistem të sigurt të kontrollit të asetëve dhe të ardhurave për gjithë personat, individë dhe persona juridikë – përfshirë në administratën tatimore – akses lidhur me individët ose personat fizikë të asociuar me funksionarët publikë [...]”.

<sup>44</sup> Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën për Luftën kundër Korrupsionit (Rezoluta 58/4) 2003 në 25.05.2006. Shih: <https://www.unodc.org/unodc/en/corruption/ratification-status.html>.

<sup>45</sup> Neni I i ligjit 9049/2003 parashikon: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta.”

<sup>46</sup> Shih faqen 5 të ankimit, paragrafi 12, në: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-46-dat%C3%AB-24.7.2018-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-z.-Xhezair-Zaganjori.pdf>

interpretim të nenit D, të lidhura me pagesën e detyrimit tatimor, përjashtuar të ardhurat të cilat sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8438/1998”) janë përjashtuar me ligj nga tatimi. Trupi gjykues, në vlerësim të këtij parashtrimi të Komisionerit, përkundër parashtrimin të subjektit të rivlerësimit të shtjelluar më sipër në paragrafin 22.3, vëren se vjelja e detyrimeve tatimore në Shqipëri përbën një nga burimet e buxhetit të shtetit edhe sipas ligjit përkatës<sup>47</sup>. Për këtë qëllim, ekziston një kuadër aktesh ligjore dhe nënligjore që synojnë edhe përmbushjen rigorozë të detyrimeve tatimore nga individët dhe personat fizikë. Shmangia e pagesës së detyrimeve tatimore përbën edhe sanksion administrativ, edhe penal, dhe masat përkatëse janë të parashikuara në ligjin nr. 8438/1998 dhe në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 33, datë 08.06.2016, ndër të tjera shprehet: [...] *Për më tepër, duke qenë se detyrimet tatimore përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave të buxhetit të shtetit, garantimi i sjelljeve ligjore të tatimpaguesve siguron krahas qëndrueshmërisë ekonomike, edhe mundësinë e zbatimit të politikave sociale efektive.* [...]

Për këtë arsye, trupi gjykues vëren që parashtrimi i Komisionerit që përjashtimi nga detyrimi për pagimin e tatimit bëhet vetëm me ligj, është i drejtë, pasi bazohet në parimet thelbësore të legjislationit që rregullon tatimet. Për këtë qëllim, legjislatori ka parashikuar në mënyrë të shprehur dhe shteruese në nenin 9 të ligjit nr. 8438/1998, rastet e të ardhurave të përjashtuara nga pagesa e tatimit. Kuadri ligjor për tatimet nuk lë vend për interpretime mbi mungesa të mundshme rregullimi ligjor, në kontekst të mospagimit të detyrimeve tatimore, në kushtet kur janë parashikuar të ardhurat e tatueshme dhe ato të përjashtueshme, duke parandaluar dhe më tej ndëshkuar çdo veprim apo mosveprim që synon shmangien e tyre.

Duke u kthyer në rrethanat e procesit të rivlerësimit, Kolegji i Posaçëm të Apelit gjatë jurisprudencës së tij është shprehur se standardi i vendosur nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, kërkon që subjekti të shpjegojë bindshëm jo vetëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, por edhe ligjshmërinë e të ardhurave, të cilat duhet të jenë të krijuara nga burime të ligjshme, të jenë të deklaruara dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse<sup>48</sup>.

**22.14.** Trupi gjykues vëren se objekt i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, janë edhe deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja që, mbështetur në ligjin nr. 84/2016, nëse subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklaram të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklaramit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përcakton që deklaramet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji. Këto deklarama, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë. Kontrolli i deklaramës *vetting*

---

<sup>47</sup> Ligji nr. 8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka përcaktuar në nenin 4, pika 4.1 se: “Të ardhurat e buxhetit të shtetit dhe të hyrat e tjera përbëhen nga: të ardhurat me natyrë tatimore të vendosura me ligj.” Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (që ka shfuqizuar ligjin nr. 8379/1998), parashikon se tek arkëtimet që kryhen nëpërmjet llogarisë së unifikuar të thesarit, përfshihen edhe të ardhurat nga tatimet, taksat dhe tarifat.

<sup>48</sup> Shih vendimin nr. 6/2019: <http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-A.-Sevdari-i-anonimizuar-per-publikim.pdf>

dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, vlerësohet si mjet që shërben gjatë procesit të rivlerësimit për kriterin pasuror, për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij. Kjo merr vlerë specifike, sidomos në rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të një pasurie, pasi këtu paraqitet deklarimi i subjektit në momentin e krijimit të pasurisë, si dhe transaksionet e kryera në vite me këtë pasuri.<sup>49</sup> Kjo analizë është në përputhje edhe me vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin nënvizohet se organet e reja kushtetuese të procesit të rivlerësimit nuk kanë zhbërë sistemin ekzistues të kontrollit dhe vlerësimit të funksionarëve publikë. Po në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese mban qëndrimin se kompetencat e organeve ekzistuese, siç janë ILDKPKI-ja, DSIK-ja apo organet e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk mund të shihen të shkëputura nga kompetencat e organeve të rivlerësimit, pasi procesi i rivlerësimit është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të.

**22.15.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se secili nga paragrafët e nenit D të Aneksit të Kushtetutës normon një situatë të caktuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve. Konkretisht, *pika 1* parashikon qëllimin e kontrollit të pasurisë dhe të deklaratimit, identifikimin e subjekteve që kanë pasuri të pajustificuar ose të subjekteve që nuk kanë deklaruar saktë dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe ato të personave të lidhur; *pika 2* parashikon detyrimin për plotësimin e saktë dhe të plotë të deklaratës *vetting* dhe detyrimin e ILDKPKI-së për të përpiluar një raport për ligjshmërinë e pasurive, saktësinë dhe plotësinë e deklaratimit sipas ligjit; *pika 3* parashikon detyrimin e subjektit për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara; *pika 4* parashikon se nëse deklarohet pasuri më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, subjekti prezumohet fajtor për shkelje disiplinore dhe duhet të paraqesë prova që të vërtetojnë të kundërtën; dhe *pika 5* parashikon rastin e mosdorëzimit të deklaratës në kohë, apo përpjekjes për të fshehur, apo paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë, gjë e cila shkakton prezumimin e masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të paraqesë prova që vërtetojnë të kundërtën.

Në përmbledhje, secila prej këtyre pjesëve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon një element specifik dhe të pavarur nga të tjerët, “pavarësi” e cila pasqyrohet në përcaktimet e masave disiplinore sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, ky nen zbërthen secilën prej pikave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke e materializuar sanksionimin kushtetues edhe me përcaktimin konkret të shkeljes. Më konkretisht, pika 1 e nenit 61 përcakton si shkelje “deklarimin më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të”; pika 2 përcakton si shkelje “problemet serioze që lidhen me ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar”, çka ndikon në kontrollin e figurës; pika 3 përcakton si shkelje “pamjaftueshmërinë për kriterin e kontrollit të figurës” dhe “pamjaftueshmërinë për kriterin e kontrollit të pasurisë”; pika 4 “përshtatshmërinë për shkak të nivelit të aftësive profesionale”; dhe pika 5 përcakton si shkelje “cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë”. Sikurse rezulton nga ky zberthim, pikat 3 dhe 4 të nenit D të Kushtetutës janë pasqyruar në parashikimet 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, të cilat pasqyrojnë dy raste të veçuara nga njëri-tjetri, ku njëri lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme dhe tjetri me pamjaftueshmërinë e pasurisë. Të dyja këto raste rrjedhin nga situata specifike të veçanta dhe nuk mundet të konsiderohen se zbatohen në mënyrë kumulative.

---

<sup>49</sup> Shih: [http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-i-anonimizuar\\_A\\_Cama.pdf](http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-i-anonimizuar_A_Cama.pdf)

**22.16.** Përkundër sa Komisioni ka parashtruar, lidhur me kohën e krijimit të pasurive objekt shqyrtimi, që përkon me periudhën përpara se subjekti të emërohej gjyqtar, siç edhe e theksoi ai vetë në konkluzionet përfundimtare se “paqartësitë në kriterin e pasurisë u përkasin viteve të largëta kur nuk ka qenë gjyqtar e madje as në Shqipëri”, trupi gjykues vëren se referuar kuadrit ligjor kushtetues dhe legjislacionit të posaçëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, në asnjë dispozitë nuk parashikohen kritere vlerësimi të kushtëzuara me periudha kohore të krijimit të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me ta, me qëllim përfshirjen apo përjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit. Sikurse është elaboruar tashmë nga Kolegji, nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, që janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive për të cilat nuk mund të justifikohet ligjërisht burimi i tyre apo që posedojnë të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Në rastin konkret, verifikimi dhe qartësimi i kriterit të pasurisë për periudhën përpara vitit 2003 – kur subjekti i rivlerësimit ka hyrë në sistemin e drejtësisë nëpërmjet emërimit të tij në Gjykatën Kushtetuese<sup>50</sup> – dhe për rrjedhojë marrjes prej tij të cilësisë “subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003”, merr rëndësi të posaçme në kontekstin e procesit të rivlerësimit. Sikurse subjekti deklaroi gjatë procesit të rivlerësimit dhe në deklaratat vjetore periodike, pasuritë e krijuara përpara vitit 2003, ose sipas fjalëve të subjektit “në vite të largëta”, kanë shërbyer si burim i krijimit të pasurive të paluajtshme, shpenzimeve dhe likuiditeteve në vitet në vijim.

**22.17.** Së fundmi, trupi gjykues thekson se Kolegji i Posaçëm i Apelit ka përgjegjësi kushtetuese që nëpërmjet vendimmarrjes së tij të interpretojë kornizën ligjore që normon procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në qasje të plotë me qëllimin dhe frymën e kushtetutëbërësit, dhe në arsyetimin e vendimit të tij orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme sipas nenit 66, pika 2 ligjit nr. 84/2016. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, ndër të tjera është shprehur: [...] *Megjithatë, duke pasur parasysh kompetencat e KA-së, si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, vlerësohet se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën [...].* Vendimet e Kolegjit bazohen dhe interpretojnë kuadrin ligjor ekzistues në Republikën e Shqipërisë në përputhje me hierarkinë e akteve normative, të përcaktuara në nenin 116 të Kushtetutës.

*b) Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurive*

*b/1) Shkaqet e ankimit për vlerësimin e pasurive të paluajtshme të ndodhura në Tiranë*

- 23.** *Lidhur me katër pasuritë e paluajtshme të ndodhura në Tiranë, në rrugën “{\*\*\*}”, Komisioneri Publik ngre shkaqet e ankimit sipas të cilave: a) në referencë të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vlerën e deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe në deklaratën vetting; b) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për vlerat e deklaruar (fatura/preventiv/situacion); c) ka mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive në vlerën 10.700.000 lekë. Në lidhje me këto shkaqe të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:*

---

<sup>50</sup> Emëruar anëtar i Gjykatës Kushtetuese me dekretin nr. 3557, datë 14.11.2002, të Presidentit të RSh-së.

24. Për këto 4 (katër) pasuri të paluajshme të ndodhura në Tiranë, Komisioneri Publik ka parashtruar të njëjtat shkaqe ankimi, meqenëse momenti i fitimit të pronësisë është i njëjtë. Për rrjedhojë, pretendimet e Komisionerit Publik mbi saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimit, ligjshmërinë e burimit dhe mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për këto pasuri do të vlerësohen së bashku.<sup>51</sup> Në deklaratën fillestare të pasurisë për vitin 2003 dhe në deklaratën *vetting* për këto pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vijon:
- i) “Apartament banimi” në bashkëpronësi me bashkëshorten, secili 50% pjesë takuese. Pasuria është ndërtuar në vitin 1997 dhe është formalizuar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes me kontratën e shitblerjes të datës 06.10.2001, me çmim të caktuar në kontratë, në vlerën 500.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri:
    - në deklaratën *fillestare të pasurisë për vitin 2003*, me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup> + 87 m<sup>2</sup> ballkon, me vlerë 7.400.000 lekë, me burim krijimi shitjen e një apartamenti dhe të ardhura personale; dhe
    - në deklaratën e pasurisë *vetting* me sipërfaqe 293 m<sup>2</sup>, me vlerë 5.800.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga shitja e apartamentit, të ardhura personale dhe të ardhura nga qiraja;
  - ii) “Njësi shërbimi/bibliotekë”, në të njëjtin pallat banimi, me sipërfaqe të përgjithshme 281 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me bashkëshorten dhe 6 persona të tjerë, secili 1/8 pjesë ideale dhe të pandarë. Pasuria është ndërtuar në vitin 1997 dhe është formalizuar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëpronarëve të tjerë me kontratën e shitblerjes të datës 06.10.2001, me çmim të caktuar në kontratë në vlerën 500.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për këtë pasuri:
    - në deklaratën fillestare të pasurisë për vitin 2003: sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, vlerë 1.800.000 lekë, burim krijimi të ardhura personale; dhe
    - në deklaratën e pasurisë *vetting*: sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, vlerë 1.400.000 lekë, burim krijimi të ardhura personale dhe qira.
  - iii) “Bodrum”, në të njëjtin pallat banimi, me sipërfaqe të përgjithshme 281 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me bashkëshorten dhe 6 persona të tjerë, secili 1/8 pjesë ideale dhe të pandarë. Pasuria është ndërtuar në vitin 1997 dhe është formalizuar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëpronarëve të tjerë me kontratën e shitblerjes të datës 06.10.2001, me çmim të caktuar në kontratë, në vlerën 500.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri:
    - në deklaratën *fillestare të pasurisë për vitin 2003*: sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, vlerë 1.500.000 lekë (ku përfshihet edhe zyra), burim krijimi të ardhura nga qiraja e bibliotekës; dhe
    - në deklaratën e pasurisë *vetting*: sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>, vlerë 800.000 lekë, burim krijimi të ardhura personale dhe qira.
  - iv) “Zyrë” në të njëjtin pallat banimi, me sipërfaqe të përgjithshme 57 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me bashkëshorten dhe 6 persona të tjerë, secili 1/8 pjesë ideale dhe të pandarë. Pasuria është ndërtuar në vitin 1997 dhe është formalizuar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëpronarëve të tjerë me kontratën e shitblerjes të datës 06.10.2001, me çmim të caktuar në kontratë në vlerën 500.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri:
    - në deklaratën *fillestare të pasurisë për vitin 2003*: sipërfaqe 20 m<sup>2</sup>, vlerë 1.500.000 lekë (ku përfshihet dhe bodrumi), burim krijimi të ardhura nga qiraja e bibliotekës; dhe
    - në deklaratën e pasurisë *vetting*: sipërfaqe 15 m<sup>2</sup>, e deklaruar në vlerën 400.000 lekë, burim krijimi të ardhura personale dhe qira.

<sup>51</sup> Shih faqen 10 të ankimit të Komisionerit Publik: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-46-dat%C3%AB-24.7.2018-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-z.-Xhezair-Zaganjori.pdf>

*A) Lidhur me momentin e fitimit të pronësisë së këtyre pasurive*

25. Komisioneri Publik konstaton se Komisioni ka dalë në konkluzion të gabuar lidhur me momentin (kohën) e fitimit të pronësisë së këtyre pasurive dhe mënyrën e fitimit të tyre, pasi provat e administruara gjatë hetimit administrativ, kontratat e shitblerjes së datës 06.10.2001, janë i vetmi veprim juridik që dëshmon mënyrën e fitimit të pronësisë dhe momentin (kohën) e kalimit të drejtave pronësore. Sipas Komisionerit Publik, pjesa arsyetuese e vendimit të Komisionit, ka dalë në konkluzion të gabuar lidhur me momentin (kohën) e fitimit të pronësisë së apartamentit dhe mënyrën e fitimit të tij<sup>52</sup>. Më tej, Komisioneri thekson se kontratat e shitblerjes së datës 06.10.2001, janë i vetmi veprim juridik që dëshmon mënyrën e fitimit të pronësisë dhe, për pasojë, arsyetimi i Komisionit mbi këtë aspekt mbetet në nivel teorik, ashtu sikurse edhe pretendimet e paraqitura nga subjekti mbeten në nivel deklarativ, të pambështetura në provat dhe faktet e administruara për këtë qëllim.
26. Në arsyetimin e tij Komisioni argumenton se momenti i fitimit të pronësisë nuk është viti 2001, kur janë hartuar kontratat e shitjes formalisht, por viti 1997, kur sendi i ri, i zhvilluar urbanisht, është përfunduar dhe krijuar, duke arritur në përfundimin se mënyra e fitimit të pronësisë nuk është kontrata e shitjes. Sipas Komisionit, nuk kemi të bëjmë me mënyrë të prejdardhur të fitimit të pronësisë, por me një mënyrë origjinale të fitimit të pronësisë. Pronësia mbi sendin e krijuar rishtazi është fituar me bashkim dhe përzjerje, siç parashikon neni 173 i Kodit Civil. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se momenti i fitimit të pronësisë, pavarësisht nëse është mënyrë origjinale apo e prejdardhur që ligji parashikon, nuk është veprimi i regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, por është momenti ideal juridik i vërtetimit dhe plotësimit të kushteve ligjore kumulative, vërtetimi i të cilave prodhon pasojat juridike, konkretisht ndërtimi i sendit të ardhshëm.<sup>53</sup>
27. Në apelin kundërshtues, subjekti i rivlerësimit parashitroi se të gjitha provat e dorëzuara prej tij vërtetojnë se sendi është zhvilluar urbanisht që në vitin 1997 me bashkëkontribut ndërmjet familjeve që kanë lidhje gjinie ndërmjet tyre dhe se, për rrjedhojë, edhe pronësia mbi sendet njësi banimi dhe shërbimi përbërëse të objektit është fituar në vitin 1997 dhe jo në vitin 2001. Në lidhje me këtë argument, subjekti i rivlerësimit solli në vëmendje aktin e kolaudimit të hartuar në gusht të vitit 2000, që sipas tij është dokument ligjor me fuqi të plotë provuese, sipas nenit 253 të K.Pr.Civile, që shënon përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe certifikon përdorshmërinë e sendit. Për të vërtetuar kohën dhe mënyrën e fitimit të pronësisë, subjekti i rivlerësimit në seancat gjyqësore të zhvilluara më datë 25.06.2019 dhe më datë 10.07.2019, paraqiti disa prova<sup>54</sup>. Po aty, subjekti ritheksoi gjetjen e Komisionit se momenti i fitimit të pronësisë nuk është veprimi administrativ i regjistrimit të pasurisë, por është momenti ideal juridik i vërtetimit të plotësimit të

<sup>52</sup> Faqja 11 e ankimit të Komisionerit Publik, paragrafi 20.1.2.

<sup>53</sup> Shih faqen 9 të vendimit të Komisionit.

<sup>54</sup> (i) Deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep. nr. {\*\*\*} kol., datë 22.02.2019, para noteres M.P., me deklarues M.H, V.N., N.Z. dhe A.M.; (ii) kontrata e sipërmarrjes, datë 01.08.1996, midis palëve, familjes M – Z, përfaqësuar nga znj. M.H dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga presidenti i firmës, z. Dh.Gj., me afat punimi 1.08.1997 – 31.03.1997. Objekti i kontratës është ndërtimi i banesës me 5 kate në rr. “{\*\*\*}”, ku pala investitore merr përsipër financimin e punimeve. Lidhur me kryerjen e pagesës, kontrata parashikon se pagesa nga ana e investitorëve do të bëhet me lekë në dorë kundrejt situacioneve; (iii) kontrata për furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike të KESH-it nr. {\*\*\*}, e lidhur ndërmjet Filialit Elektrik dhe përdoruesit të energjisë elektrike Xhezair Zaganjori, adresa: rr. {\*\*\*} ({\*\*\*}), datë 13.12.1997, Kati 3 (të dhëna me shënime dore); (iv) dy fotografi, në njërin prej të cilave është shënuar data 12.01.1998; (v) dy certifikata vdekjeje të datës 02.07.2019, sipas së cilave prindërit kanë vendbanimin në rrugën “{\*\*\*}”.

kushteve ligjore kumulative, përditësimi i të cilave prodhon pasoja juridike, konkretisht ndërtimi i sendit të ardhshëm.

28. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi parashtrimet e Komisionerit Publik, dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, konstaton se Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve (në vijim “KKKP ish-pronarëve”) me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.09.1994, i ka njohur z. H.M. dhe znj. Sh.Z., pronësinë mbi një truall me sipërfaqe 592 m<sup>2</sup>, prej të cilëve 207 m<sup>2</sup> janë kthyer si truall i lirë dhe 385 m<sup>2</sup> për t’u kompensuar. Kjo pjesë e fundit u është kthyer me vendimin nr. 10, datë 13.03.2001, të KKKP ish-pronarëve.<sup>55</sup> Më tej, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë (në vijim “KRRT”), me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 13.10.1995, ka miratuar sheshin e ndërtimit për godinë 7-8 kate polifunksionale dhe me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 13.04.1996, ka miratuar lejen e ndërtimit për godinë 5 kate polifunksionale, në Rrugën {\*\*\*}, drejtuar z. H.M. dhe znj. Sh.Z..

Familja M – Z, në cilësinë e investitorëve, përfaqësuar nga znj. M.H., kanë lidhur kontratën e sipërmarrjes së datës 01.08.1996, me firmën private. “{\*\*\*}” ShPK për ndërtimin e banesës me 5 kate në rr. “{\*\*\*}”, me afat punimi 01.08.1996 – 31.03.1997. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.07.1997, KRRT ka miratuar rifreskimin e lejes së ndërtimit dhe shtesën e katit sipas vendimit nr. {\*\*\*}, në pronësi të z. H.M. dhe znj. Sh.Z.. Në formularët shoqërues të dy vendimeve të KRRT-së të datave 13.04.1996 dhe 04.07.1997, përcaktohet se objekti financohet nga vetë pronarët [znj. Sh.Z. e H.M.]. Pas ndërtimit të objektit, më datë 24.8.2000, është hartuar akti i kolaudimit tekniko-ekonomik, sipas të cilit investitorë të punimeve janë z. H.M. dhe znj. Sh.Z., me drejtues punimesh Ing. M.H. Vlera e objektit, sipas preventivit, është 30.000.000 lekë, ndërsa vlera faktike e punimeve është 38.000.000 lekë dhe afati i punimeve është gusht 1996 – shtator 1997.

Më datë 18.10.2000 familja M – Z, përfaqësuar nga znj. M.H, i kanë bërë kërkesë ZRPP Tiranë për hipotekimin e objektit “Godinë 7-katëshe polifunksionale dhe parkim nën tokë”, në rrugën “{\*\*\*}”. Në vijim është lëshuar vërtetimi hipotekor i pronësisë në favor të z. H.M. dhe znj. Sh.Z.. Sipas këtij vërtetimi, në regjistrin hipotekor nr. {\*\*\*}, ZK. {\*\*\*}, datë 26.12.2000, figuron e regjistruar në pronësi të z. H.S.M. dhe znj. Sh.H.Z. pasuria me sip. 622 m<sup>2</sup>, në adresën: rruga “{\*\*\*}”, Godina 2 – 5 – 7, me bodrum, sipërfaqe 281 m<sup>2</sup>; kati përdhes me sipërfaqe 281 m<sup>2</sup>; kati i parë – apartament me sipërfaqe 255 m<sup>2</sup>, apartament me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>; kati i dytë – apartament me sipërfaqe 291 m<sup>2</sup>; kati i tretë – apartament me sipërfaqe 256 m<sup>2</sup>; kati i katërt – apartament me sipërfaqe 256 m<sup>2</sup>; kati i pestë e kati i gjashtë – apartament dubleks me sipërfaqe 350 m<sup>2</sup>. Më tej, më datë 06.10.2001, z. H.M. dhe znj. Sh.Z., në cilësinë e shitësve dhe të pronarëve të vetëm ligjorë, kanë lidhur 4 (katër) kontrata shitblerjeje pasurie të paluajtshme, me palë blerëse z. Xhezair Zaganjori dhe znj. N.Z.<sup>56</sup> (në 1 kontratë blerës të vetëm dhe në 3 të tjera blerës së bashku me 6

<sup>55</sup> Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 13.03.2001, citojmë: “[...] rezulton se kjo dosje është shqyrtuar një herë nga KKK pronave, ku me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.09.1994, i është njohur z. H.M dhe znj. Sh.Z. pronësia mbi një truall me sipërfaqe 592 m<sup>2</sup>, prej të cilëve 207 m<sup>2</sup> janë kthyer si truall i lirë dhe 385 m<sup>2</sup> për t’u kompensuar. Aktualisht, sot mbi të gjithë truallin me sipërfaqe 592 m<sup>2</sup> është ndërtuar një pallat 5-katësh dhe 7-katësh, i cili është hipotekuar në ZRPP “Tirana 1” me nr. {\*\*\*}, datë 26.12.2000, zona kadastrale {\*\*\*} (bazuar në lejen e ndërtimit të KRRT Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 13.04.1996 dhe nr. prot. {\*\*\*}). Meqenëse e gjithë ndërtesa është e ngritur mbi truallin e kthyer me sipërfaqe 207 m<sup>2</sup> dhe atë të njohur me sipërfaqe 385m<sup>2</sup>, kërkohet që ky truall të trajtohet i lirë për efekt regjistrimi në hipotekë [...]”.

<sup>56</sup> (i) Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.10.2001, ndërmjet shitësit H. M. dhe Sh.Z dhe blerësit Xhezair Zaganjori dhe N.Z., me objekt “Apartament” në katin e dytë, me sipërfaqe 293 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZRPP Tiranë në nr. {\*\*\*}, datë 26.12.2000, zona kadastrale {\*\*\*}. (ii) Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., n. {\*\*\*} kol., datë 06.01.2001, ndërmjet shitësit H.M dhe Sh.Z dhe blerësit Xhezair

persona të tjerë).

29. Provat dokumentare tregojnë se z. H.M. dhe znj. Sh.Z. paraqiten në cilësinë e pronarëve të vetëm ligjorë të truallit dhe të godinës, si dhe në cilësinë e investitorëve për ndërtimin e objektit. Në këtë cilësi, ata më datë 06.10.2001 kanë lidhur kontratat e shitblerjes për të kaluar të drejtën e pronësisë te subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, nëpërmjet këtyre 4 (katër) kontratave të shitblerjes, janë bërë pronarë të vetëm të ligjshëm të një pasurie apartament të ndodhur në Tiranë dhe bashkëpronarë të ligjshëm me 6 persona të tjerë në tri pasuri të ndodhura në Tiranë, më datë 06.10.2001, ditën e nënshkrimit të këtyre kontratave.<sup>57</sup>
30. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se arsyetimi i Komisionit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit se pronësia mbi këtë pasuri daton prej vitit 1997 mbeten në nivelin deklarativ, pasi ato gjenden të pambështetura në provat dhe faktet e analizuara më sipër. Trupi gjykues vëren se kontrata për furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike të KESH-it, që mban datën 13.12.1997, nuk përbën dokument ligjor që provon pronësinë mbi një pasuri të paluajtshme, në kuptim të legjislacionit civil dhe atij të posaçëm për fitimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme. Ky dokument, siç rezulton nga rrethanat konkrete – konkretisht kalimi i të drejtave të pronësisë zyrtarisht daton në tetor 2001, kurse kontrata rezulton të jetë lidhur në dhjetor 1997 – mund të provojë deri në njëfarë mase përshtatshmërinë për përdorim të këtij objekti, për të cilin është lidhur kjo kontratë<sup>58</sup>. Njëkohësisht, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se në situatën e provave dokumentare të pakontestueshme – si kontratat e shitblerjes së vitit 2001 nga njëra anë – dhe mungesës së dokumentacionit provues të një peshe të barabartë me kontratat, që do të provonte të kundërtën me fakte të pakontestueshme dhe prova, konkluzioni i Komisionit që hodhi poshtë kontratat e shitblerjes mbështetur vetëm në deklaratat e subjektit, tejkalon kompetencën e Komisionit apo të një institucioni të rivlerësimit kalimtar. Në këtë këndvështrim, arsyetimi i Komisionit që kërkon të vendosë se cila është mënyra e fitimit të pronësisë nëpërmjet veprimit juridik (kontratës së shitjes me akt noterial) apo fitimit me përzierje, duke u shprehur se [...] *momenti i fitimit të pronësisë nuk është viti 2001, kur janë hartuar kontratat e shitjes formalisht, por viti 1997, kur sendi i ri i zhvilluar urbanisht është përfunduar dhe krijuar [...]*, kapërcen tagrat e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 që e drejton shprehimisht procesin e rivlerësimit, për sa i përket kriterit pasuror vetëm në “deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre, përmbushjen r detyrimeve financiare [...]”.

---

Zaganjori, N.Z. dhe 6 persona të tjerë, me objekt “Kati i parë”, me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZRPP Hipoteka Tiranë, me nr. {\*\*\*}, datë 26.12.2000, zona kadastrale {\*\*\*}. (iii) Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.01.2001, lidhur ndërmjet shitësit H.M dhe Sh.Z dhe blerësit Xhezair Zaganjori, N.Z. dhe 6 persona të tjerë, me objekt “Kati përdhes” me sipërfaqe 281 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZRPP Hipoteka Tiranë me nr. {\*\*\*}, datë 26.12.2000, zona kadastrale {\*\*\*}. (iv) Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.01.2001, lidhur ndërmjet shitësit H.M dhe Sh. Z. dhe blerësit Xhezair Zaganjori, N.Z. dhe 6 persona të tjerë, me objekt “Bodrum” me sipërfaqe 281 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZRPP Hipoteka Tiranë, me nr. {\*\*\*}, datë 26.12.2000, zona kadastrale {\*\*\*}. Kjo pasuri në vërtetimin e pasurisë së datës 20.04.2015, rezulton me sipërfaqe 260 m<sup>2</sup>.

<sup>57</sup> Shih vendimin unifikues nr. 1/2009 të Gjykatës së Lartë.

<sup>58</sup> Subjekti i rivlerësimit në provat dhe shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit (faqe 5), është shprehur: “Në mungesën time dhe të bashkëshortes (ishim në këtë kohë në Gjermani) shihet se kjo kontratë është nënshkruar nga M.H [...] prindërit e mi janë shpërngulur për të jetuar në apartamentin e përbashkët në shtator të vitit 1998 [...]” – shih fashikullin 15.



Trajtimi i çështjes në këtë mënyrë duket sikur i referohet pretendimit për të mbrojtur një interes që lidhet me të drejta pronësie, çka bën që trajtimi i tij të shtjellohet në rrugë gjyqësore ngushtësisht civile, përkundër procesit administrativ të rivlerësimit dhe, duke anashkaluar provat dokumentare, del përtej objektit dhe qëllimit të procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo mënyrë interpretimi është në tejkalim të kompetencave që Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 u kanë dhënë institucioneve të rivlerësimit. Rregullimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshje që i përkasin sferës së marrëdhënieve juridike civile nuk është qëllim i procesit të rivlerësimit kalimtar. Neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016 përcaktojnë shprehimisht parimet mbi të cilat duhet të vlerësohen subjektet e rivlerësimit, për sa i përket kriterit pasuror Për këtë arsye, ky shkak ankimi i Komisionerit Publik është i drejtë dhe u pranua nga trupi gjykues.

31. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion provues ligjor të llojit leje ndërtimi, preventiv, situacion të shpenzimeve të kryera në emër të tij dhe të bashkëshortes apo të tjera dokumente të cilat mund të vërtetojnë deklarin e pagesave të kryera për efekt të ndërtimit të pasurisë për të konfirmuar vlerat reale të pretenduara të krijimit të këtyre pasurive, në përputhje me kërkesat e pikës 26 të udhëzimit nr. 4095/2016 të ILDKPKI-së<sup>59</sup>. I vetmi dokument i sjellë nga subjekti, në procesin e ankimit përpara Kolegjit, ishte një kontratë sipërmarrjeje e datës 01.08.1996, që përcaktonte si palë përsëri familjen M. dhe Z., përfaqësuar nga znj. M.H, ndërsa nuk përmban asnjë referencë të subjekti apo bashkëshortja si investitorë apo të përfshirë në çfarëdo cilësie në këtë ndërmarrje. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për vlerën dhe kohën e dhënies së shumave të cituara, në formën e investimeve, dhe për mënyrën e fitimit të pronësisë në mënyrë të përzier, mbetën në nivel deklarativ dhe të paprovuara me dokumentacion të rregullt ligjor.

#### *B) Lidhur me vlerën e krijimit të këtyre pasurive*

31. Në ankim, Komisioneri Publik konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht vlerën e pasurisë dhe që ndryshe nga përfundimi i arritur nga Komisioni, se në rastin e lidhjes së 4 (katër) kontratave të shitblerjes së pasurive të paluajtshme, shmangia (e barrës tatimore) është kryer duke shfrytëzuar boshllëqet ligjore dhe duke sjellë për pasojë evazion tatimor të ligjshëm, mospërputhjet me vlerat reale të shitjes çojnë në konkluzionin se kontrata e shitjes e vitit 2001 është fiktive në vlerë (sa për dukje), me qëllim regjistrimin e pasurisë me vlerë më të vogël dhe shmangien e pagimit të detyrimeve fiskale në favor të buxhetit të shtetit. Këto veprime e ngarkojnë subjektin me përgjegjësi për deklarim të pasaktë në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2003 dhe mungesë të shpjegimit bindshëm të pasurisë së krijuar në deklaratën e pasurisë *vetting*.
32. Komisioni ka arsyetuar se ka një mospërputhje ndërmjet deklarimeve në kohë, për sa i përket kontributit që subjekti dhe bashkëshortja kanë dhënë për krijimin e pjesëve takuese të pasurisë, pasi në vitin 2003 vlera e shpenzimeve të deklaruara është 7,4 milionë lekë, kurse në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar shpenzime totale në vlerën 9,1 milionë lekë. Gjithsesi, kjo mospërputhje, arsyeton Komisioni, nuk krijon dyshime për fshehje të pasurisë dhe deklarata e procesit të rivlerësimit kalimtar është e saktë dhe përputhet me realitetin. Më tej, Komisioni

---

<sup>59</sup> Pika 26 parashikon se për rastet kur subjektet e rivlerësimit dhe/ose personat e lidhur me të, kanë kryer ndërtime, shtesa ose rikonstrukcione të pjesshme ose të plota, për banesa ose çdo ndërtim tjetër, duhet të paraqesin dokumentacionin e plotë ligjor, lejen e ndërtimit, preventivin, situacionin e plotë të shpenzimeve të kryera etj.

argumenton se fiktiviteti në dukje i kontratave të lidhura me familjarët e bashkëshortes, nuk ka pasur qëllim mashtrimin apo fshehjen e fakteve, ngjarjeve apo pasurisë, pasi subjekti vetëm ka shfrytëzuar hapësirat ligjore në favor të interesave të tij. Së fundmi, këto veprime janë kryer jashtë periudhës së rivlerësimit dhe nuk mund të konkludohet për shkelje ligjore që çojnë në shkarkimin e subjektit nga detyra.

33. Në parashtrimet përpara Kolegjit, subjekti i rivlerësimit arsyetoi se vlera 9,1 milionë lekë përfshin vlerën totale të harxhuar për ndërtimin e godinës së re, për apartamentin dhe 3 hapësira të përbashkëta, përfshirë këtu edhe 1,6 milionë lekë për arredimin e apartamentit. Në deklaratën e vitit 2003, vetëm për apartamentin është referuar shuma 7,4 milionë lekë, që përfshin shumën 5,8 milionë të koston së ndërtimit dhe 1,6 milionë lekë për arredimin. Në konkluzionet përfundimtare, subjekti parashtrioi se nuk është dakord me vlerësimin e Komisionit se ka kryer evazion fiskal të ligjshëm, pasi kontratat e vitit 2001 janë formale. Ato janë përpiluar në të njëjtën ditë, kanë të njëjtën përmbajtje dhe shuma është e njëjtë, pavarësisht sipërfaqeve të ndryshme për të cilat bëhet fjalë në secilën kontratë. Kontratat nuk kanë prodhuar asnjë pasojë juridike për të cilën ato janë të destinuara juridikisht, që do të thotë se nuk janë ato që kanë tjetërsuar pasuritë objekt transaksioni.
34. Trupi gjykues vëren që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shuma të ndryshme në deklaratat të ndryshme, për sa i përket vlerës së krijimit të pasurisë. Konkretisht, kjo vlerë është raportuar ndryshe në deklaratën fillestare të pasurisë për vitin 2003, në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ndryshe në kontratat e shitblerjes së pasurive të paluajtshme (shih paragrafin 24 të këtij vendimi). Në përgjigjet e dhëna Komisionit në datën 01.03.2018 ndaj pyetësorit të datës 14.02.2018, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *U zgjodh varianti me kontratë shitjeje me një shumë fikse simbolike, e cila në thelb më është thënë se u mendua si një lloj “dhurate” për gjyshin e familjes, H.M. [...].* Nga dokumentacioni i administruar në dosjet e Komisionit, bashkëlidhur praktikës së përcjellë nga ZRPP Tiranë mbi regjistrimin e këtyre 4 (katër) pasurive, rezultojnë 4 (katër) mandatpagesa nga z. H.M., secila në vlerën 2500 lekë, referuar 4 kontratave të shitblerjes<sup>60</sup>. ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 05.4.2018<sup>61</sup>, ka informuar Komisionin se [...] *përlllogaritja e tatimit në këtë periudhë është bërë duke u bazuar në vlerën e transaksionit, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe tabelës bashkëlidhur.*
35. Nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit është kontradiktor në shumat e deklaruara të vlerës së krijimit të 4 (katër) pasurive në Tiranë dhe se në kontratat e shitblerjes nuk është pasqyruar shuma e pretenduar nga subjekti që është paguar në formën e investimeve për të mbuluar kostot e ndërtimit të godinës. Për më tepër, mospasqyrimi i vlerave reale të blerjes së pasurisë në kontratat e shitblerjes së pasurisë ka ndikuar në përlllogaritjen e pasaktë të vlerës së tatimit nga kalimi i të drejtës së pronësisë. Pavarësisht se mban në konsideratë që detyrimi ligjor për pagesën e tatimit ishte i shitësve [z. H.M. dhe znj. Sh.Z.], trupi gjykues vëren se subjekti, për shkak të faktit të pohuar nga ai për pamundësinë e shitësve për të ndjekur veprimet administrative dhe lidhjeve të ngushta familjare mes palëve kontraktore<sup>62</sup>, njohurive profesionale të subjektit si njohës i ligjit, si dhe pjesëmarrjes së tij me veprime konkludente në nënshkrimin e kontratave të shitblerjes – paraqitja personalisht para noterit dhe shprehja e vullnetit të plotë për nënshkrimin e

<sup>60</sup> Shih fashikullin 4, faqe 591-610 – bashkëlidhur shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 13.02.2018, të ZVRPP Tiranë.

<sup>61</sup> Fashikulli 4, faqe 587-588 – shkesa nr. {\*\*\*} prot., datë 05.04.2018, ZVRPP Tiranë.

<sup>62</sup> Në seancën gjyqësore të datës 25.06.2019, subjekti u shpreh se: “[...] është fakt ndërtimi i godinës me investim të përbashkët, se s’mund ta ndërtonte gjyshi 90 e ca vjeç”. Mosha e z. H.M., 93 vjeç në dhjetor 2000, është konfirmuar edhe në deklaratën noteriale të bashkëpronarëve të datës 22.02.2019, të paraqitur në cilësinë e provës në po këtë seancë gjyqësore në Kolegj.

kontratave për blerjen e pasurive në shumën 500.000 lekë secila – duhet të vlerësohet qasjen e tij në raport me këtë situatë faktike në përputhje me ligjin.

36. Trupi gjykues i Kolegjit analizoi legjislacionin e kohës në nënshkrimin e kontratave të shitblerjes së datës 06.10.2001, dhe konkretisht ligji nr. 8438/1998 (i ndryshuar) parashikon se të ardhurat e rrjedhura nga kalimi i të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme janë të tatueshme (neni 4). Tatimi derdhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurisë, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (neni 11). Pasqyra nr. 2 që i bashkëlidhet këtij ligji paraqet vlerat e tatimit në përqindje sipas katër (4) grupeve/fashave dhe varion nga 0,5% deri në 3% të vlerës së shitjes<sup>63</sup>.
37. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të nevojshme të trajtojë interpretimin ligjor që Komisioni i ka bërë termit “evazion tatimor i ligjshëm”, si një koncept që mund të krijojë keqkuptime dhe të lërë vend për interpretime të pasakta në vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit. Termi “evazion tatimor i ligjshëm” mungon në normimin ligjor në koncept dhe përmbajtje, dhe për më tepër zgjedhja e këtij termi sfidon logjikën. Në vendet frëngjishtfolëse termi “evazion” përdoret për t’iu referuar konceptit të shmangies së tatimit, ndërsa termi “mashttrim tatimor” përdoret për t’iu referuar konceptit të evazionit tatimor.<sup>64</sup> Në fjalorin e termave ligjorë të gjuhës angleze, ky term përkufizohet si “përprjekje e paligjshme për të zvogëluar shumën tatimore të pagueshme me mjete mashtruese”<sup>65</sup>. Me fjalë të tjera, termi “evazion tatimor” përkufizon një formë negative të të vepruarit me qëllim shmangien/mospagimin e detyrimeve tatimore që rrjedhin nga ligji, gjë që i bën këto veprime të paligjshme dhe të sanksionueshme administrativisht dhe penalisht. Shmangia e detyrimeve tatimore dënohet nga legjislacioni shqiptar (shih paragrafin 21.13. të këtij vendimi). Mospasqyrimi i vlerave reale në kontratat e shitblerjes së pasurive me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore ka qenë çështje e evidentuar edhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNJ”), e cila në vendimin “Çështja Sharra dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, të datës 10 nëntor 2015, (pika 86) ka parashtruar:

*[...] Së dyti, Gjykata do t’u referohej argumenteve të shprehura gjatë takimit parlamentar të datës 7 maj 2012 për shkakun se shitblerjet e regjistruara në ZRPP, nuk e reflektonin në përgjithësi dhe domosdoshmërisht vlerën reale të tregut si rezultat i evazionit të taksave, mbuluar nga palët sipas kontratës së shitjeve. Për pasojë, Gjykata mendon se referimi i plotë në çmimet e shitjeve të shitblerjeve të regjistruara nuk do të ishte aspak në zbatim të parimit se kompensimi, në rastet e shpronësimit të paligjshëm, duhet të jetë në përputhje me vlerën e tregut, për këtë arsye Gjykata ka ndërmarrë edhe masa për të parandaluar dhe luftuar evazionin e taksave. [...]*

38. Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se argumentimi i Komisionit lidhur me mungesën e legjislacionit në këtë periudhë për çmimet e referencës në shitjen e pasurive të paluajtshme dhe boshllëqet ligjore, për të justifikuar deklarin e shumës prej 500.000 lekësh në kontratat e shitblerjes, bie ndesh me ekzistencën e legjislacionit të kohës që rregullon tatimin mbi të ardhurat. Ky i fundit parashikon me hollësi detyrimet e palëve kontraktore për të deklaruar vlerën reale të transaksionit të pasurisë dhe detyrimin e ZVRPP-së, në cilësinë e agjentit tatimor, për vjeljen e

<sup>63</sup> Për vlera shitjeje deri në 2 milionë lekë, zbatohet tatimi në 0,5% të vlerës; për vlera shitjeje 2 milionë deri në 4 milionë lekë, tatimi përllogaritet deri në 1% të vlerës; për vlera shitjeje 4 milionë lekë deri në 6 milionë lekë, tatimi llogaritet në 2% të vlerës dhe për vlera 6 milionë lekë e sipër, tatimi llogaritet në 3% të vlerës.

<sup>64</sup> <https://www.tatime.gov.al/c/180/181/fjalori-tatimor>

<sup>65</sup> <https://thelawdictionary.org/tax-evasion/>

detyrimin tatimor. Po kështu, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se përkundër argumentit të subjektit të rivlerësimit se, duke qenë kontratat e shitblerjes fiktive dhe absolutisht të pavlefshme, edhe pagimi i detyrimit tatimor është fiktiv, rezultoi nga provat dhe faktet e parashtruara se subjekti i rivlerësimit me veprime konkludente ka nënshkruar katër kontrata noteriale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, në bazë të të cilave përfitoi dhe gëzon ende titullin e pronësisë mbi këto pasuri të paluajtshme. Po ashtu, përkundër sa parashtron subjekti, vlefshmëria juridike e kontratave për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme është e lidhur specifikisht me elemente të tilla si forma e kërkuar shprehimisht nga ligji, mungesa e së cilës e bën aktin të pavlefshëm<sup>66</sup>. Nëpërmjet nënshkrimit të aktit noterial, noteri vërteton me anë të formaliteteve të kërkuara nga legjislacioni për noterinë, se vullnetet e deklaruara të palëve në prani dhe përpara tij janë të pavesuara, të ligjshme dhe të plota.<sup>67</sup> Pretendimi për pavlefshmëri absolute të kontratave të shitblerjes nuk rezulton të jetë bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor<sup>68</sup> dhe nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton asnjë e dhënë që shitësi apo blerësi të kenë paraqitur padi në gjykatë me këtë objekt kërkimi.<sup>69</sup> Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.

39. Trupi gjykues i Kolegjit, sikurse ka arsyetuar edhe më lart, shih paragrafin 22.1. të këtij vendimi, nuk pajtohet me argumentimin e Komisionit se këto veprime janë kryer jashtë periudhës së rivlerësimit dhe për pasojë nuk mund të konkludohet për shkelje ligjore që çojnë në shkarkimin e subjektit nga detyra. Legjislacioni i posaçëm për rivlerësimin kalimtar nuk vendos kritere kohore lidhur me provueshmërinë e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive në pronësi apo përdorim, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Për më tepër, vendosja e kritereve kohore do të ishte alogjike dhe do të binte ndesh me konceptin e rivlerësimit, i cili për nga natyra nënkupton kontrollin e veprimeve të ndodhura në të shkuarën<sup>70</sup>. Për nga natyra, rivlerësimi është analizë e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria dhe për këtë shkak institucionet e rivlerësimit kontrollojnë burimin (në të shkuarën) për të cilin është krijuar kjo pasuri. Rivlerësimi (*vetting*) mund të përkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike. “[...] Integriteti i referohet respektimit nga një funksionar i standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe sjelljes profesionale, përfshirë edhe rregullsinë dhe përshtatshmërinë e situatës financiare [...]”<sup>71</sup>. Si rrjedhojë, kjo qasje e Komisionit nuk qëndron. Po ashtu, përkundër sa parashtror subjekti në seancë publike lidhur me garancitë që ofron neni 1 i Protokollit 1 të KEDN<sup>72</sup>-së lidhur me gëzimin

<sup>66</sup> Neni 83, paragrafi 2 i Kodit Civil parashikon: “Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji.”

<sup>67</sup> Shih vendimin unifikues të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 1/2009. Për më tepër, shih vendimin nr. 52, datë 02.02.2012, të Gjykatës së Lartë.

<sup>68</sup> Kodi Civil, në nenin 94 “Veprime juridike që shpallen të pavlefshme”, në paragrafin e parë parashikon: “Të anulueshme quhen veprimet juridike të cilat janë të vlefshme gjersa gjykata me kërkesën e të interesuarit i shpall të pavlefshme [...]”.

Për më tepër shih vendimin unifikues nr. 5, datë 30.10.2012, të Gjykatës së Lartë.

<sup>69</sup> Shih legjislacionin e kohës, ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë”.

<sup>70</sup> Shih nenin D të Aneksit të Kushtetutës që u jep vlerë pasurive të krijuara përpara procesit dhe deklarimit të plotë dhe të saktë, si dy parime paralele që udhëheqin rivlerësimin (judicial vetting).

<sup>71</sup> <https://www.ohchr.org/Documents/Publications/RuleoflawVettingen.pdf>

<sup>72</sup> Shih poshtëshënimin 39.

Shih edhe [https://echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_1\\_Protocol\\_1\\_ENG.pdf](https://echr.coe.int/Documents/Guide_Art_1_Protocol_1_ENG.pdf), faqe 15, paragrafi 61: “[...] Neni 1 i Protokollit 1 përfshin tre rregulla specifike. I pari, shtjelluar në fjalinë e parë të paragrafit të parë, ka natyrë të përgjithshme dhe nxjerr në pah parimin e gëzimit të qetë të pronës. Rregulli i dytë, përfshirë në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, mbulon vetëm privimin nga “objektet në pronësi” dhe ua nënshtron atë disa kushteve. Rregulli i

e pronave si parim që duhet të udhëheqë procesin, trupi gjykues çmon të theksojë se ky standard ndërkombëtar zbatohet në rrethanat kur pronësia konfiskohet apo shpronësohet dhe është garanci për pronarët. Në kontekstin e rivlerësimit, sipas nenit D, në fokus të procesit, siç është shtjelluar më sipër, janë kontrolli i pasurive (përshtatshmëria e situatës financiare/*financial propriety*) dhe deklarimi i plotë dhe i saktë nga ana e subjekteve. Për këtë arsye, trupi gjykues e gjen të pabazuar referimin në Protokollin 1 të KEDNj-së në këtë proces.

41. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se shkak i ankimit të Komisionerit për deklarim të pasaktë dhe mospërputhje të deklarimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit qëndron. Lidhur me peshën dhe rolin e këtyre fakteve, Kolegji shprehet në mënyrë të detajuar në përgjigje të shkaqeve të ankimit.

*C) Lidhur me burimin e krijimit të këtyre pasurive*

42. Komisioneri Publik lidhur me deklarimin e burimit të krijimit të këtyre pasurive, e ndan burimin e të ardhurave në tri grupe: i) të ardhura nga shitja e apartamentit; ii) të ardhura personale deri në pranverë – verë 1999 (periudhë në të cilën subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka shlyer pjesën e tij të investimit); dhe iii) të ardhura nga qiraja. Në lidhje me këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik pretendon se:

*i) Ligjshmëria e burimit të deklaruar – “të ardhurat nga shitja e apartamentit” – nuk arrin nivel të besueshëm (mbetet e paprovuar) në kushtet kur titulli i pronësisë së këtij apartamenti vazhdon të jetë në emër të bashkëpronarëve Zaganjori.*

43. Komisioni argumenton se burimi i krijimit të pasurisë në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, sipas pjesëve takuese që ai me bashkëshorten kanë në bashkësinë ligjore mbi objektin 5-katësh të ndërtuar në vitin 1997, janë kryesisht të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm, të ardhurat personale të të dy bashkëshortëve dhe të ardhurat nga qiraja e njëjësive të shërbimit.
44. Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti prova për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e këtyre 4 pasurive të paluajtshme. Kështu, në lidhje me burimin e të ardhurave nga shitja e apartamentit, në seancën gjyqësore të 10.07.2019, subjekti i rivlerësimit paraqiti tri dokumente për të vërtetuar burimin e ligjshëm të vlerës prej 4.000.000 lekësh, të pretenduar se u është paguar familjarëve nga shitja e apartamentit në Tiranë<sup>73</sup>. Në lidhje me faktin që kjo pasuri figuron në ZRPP Tiranë ende e regjistruar në emër të tij, subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk ishte në dijeni dhe theksoi detyrimin e blerësit për të regjistruar pasurinë e paluajtshme në emër të tij.<sup>74</sup>
45. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja dhe dy prindërit e tij kanë disponuar në cilësinë e shitësve me kontratën e shitblerjes<sup>75</sup> shitjen e apartamentit<sup>76</sup> në bashkëpronësi, blerësit F.S., në vlerën 3.950.000 lekë, të likuiduar nga blerësi në prani të noterit. Kontratës i është bashkëlidhur kopja e pagesës së tatimit mbi shitblerjen e banesës së paguar nga

---

*tretë, përfshirë në paragrafin e dytë, u njeh të drejtën shteteve anëtare, ndër të tjera, të kontrollojnë përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm [...]”.*

<sup>73</sup> (i) Kontrata e noterizuar e shitblerjes, datë 13.01.1999, e apartamentit të bashkëpronarëve Zaganjori; (ii) shkresa datë 01.07.2019, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, drejtuar znj. N.Z.; (iii) 2 certifikata vdekjeje, datë 02.07.2019, sipas të cilave prindërit e subjektit e kanë vendbanimin në rr. “{\*\*\*}”.

<sup>74</sup> Shih përgjigjet e datës 01.03.2018 ndaj pyetësorit të datës 14.02.2018 dhe deklaratimet gjatë gjykimit në Kolegj.

<sup>75</sup> Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.01.1999.

<sup>76</sup> Apartamenti nr. {\*\*\*}, që ndodhet në banesën nr. {\*\*\*}, në rrugën “{\*\*\*}”, me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup>.

subjekti i rivlerësimit pranë bankës së kursimeve, më datë 13.01.1999, në vlerën 3.950 lekë<sup>77</sup>. Në përgjigjet nga ZRPP Tiranë të administruar nga Komisioni, kjo pasuri rezultoi ende të jetë e regjistruar në regjistrat e ZRPP Tiranë në emër të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes së tij dhe dy prindërve.

46. Trupi gjyqësor i Kolegjit analizoi se, referuar kontratës së shitblerjes së datës 13.01.1999 dhe jurisprudencës gjyqësore<sup>78</sup>, pronësia mbi apartamentin e ndodhur në rrugën “{\*\*\*}” i ka kaluar blerësit, z. F.S, në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Ky fakt u konfirmua edhe nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës në përgjigjen e dhënë subjektit se [...] *ky apartament është regjistruar në hipotekë me nr. {\*\*\*} regjistri, datë 13.01.1999, në emër të z. F. S. Ky apartament është blerë sipas kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep, {\*\*\*} kol., datë 13.01.1999, noter R.S [...]* <sup>79</sup>. Për rrjedhojë, z. F.S gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qenien pronar mbi këtë pasuri. Në vijim, trupi gjyqësor i Kolegjit vlerëson se shuma në vlerën 3.950.000 lekë është e ardhur e ligjshme, e krijuar nga kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme përpara noterit dhe është e justifikuar ligjërisht. Për rrjedhojë, shkaku i ankimit të Komisionerit që lidhet me moskonsiderimin e kësaj vlere si e ardhur e ligjshme nuk qëndron.

*ii) Burimi i deklaruar “të ardhurat personale, deri në pranverë-verë 1999”, mbetet i paprovuar pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar kursimet e deklaruara, burimin e ligjshëm të të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e këtyre kursimeve, si dhe prova/dokumentacion bankar apo jo bankar, për të vërtetuar mënyrën si këto shuma janë sjellë/dërguar në Shqipëri.*

47. Lidhur me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij në periudhën kohore në fjalë (verë 1999), Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë paguar nga Gjermania edhe shumat një (1) milion lekë dhe 1,6 milionë lekë për ndërtimin dhe arredimin e njësisë së tyre të banimit në objektin e përbashkët, në pranverën e vitit 1999. E gjithë vlera e ndërtimit dhe e arredimit, arsyetoi Komisioni, arrin në 5,8 milionë lekë, ndërsa një pjesë e të ardhurave – rreth 2,5 milionë lekë – në fillimin e ndërtimit (1996), ishin tërhequr nga “Volks Bank” në Hajdelberg të Gjermanisë, ku subjekti i rivlerësimit ishte i angazhuar si hulumtues dhe i janë dhënë bashkëpronarit që merrej me administrimin dhe ndërtimin e sendit që po krijohej.
48. Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti një sërë aktesh<sup>80</sup> në cilësinë e provës për të vërtetuar mundësinë financiare për të kryer pagesën e deklaruar të investimit. Në

<sup>77</sup> Shih fashikullin 13, faqe 1675-1677.

<sup>78</sup> Shih vendimi unifikues nr. 1/2009 të Gjykatës së Lartë.

<sup>79</sup> Shih shkresën e datës 01.07.2019, të paraqitur në cilësinë e provës nga subjekti në seancën gjyqësore të datës 10.07.2019.

<sup>80</sup> (i) Vërtetim nga “{\*\*\*}”, datë 09.07.2018, i shoqëruar me vulë apostile, datë 21.03.2019, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka përfituar një bursë MPG për periudhën 01.01.1998 – 31.08.1999, në shumën 94.600 marka (neto, pasi nuk paguhej taksa për bursa) - 55.800 marka për periudhën 01.01.1998 – 31.12.1998 dhe 38.800 marka për periudhën 01.01.1998 – 31.08.1999; (ii) tri vërtetime nga Fakulteti i Drejtësisë, datë 20.11.2018, nr. {\*\*\*} prot., datë 20.11.2018 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 20.11.2018, se subjekti i rivlerësimit ka qenë pedagog me kohë të plotë për periudhën 01.12.1981 – 20.08.1992 dhe të ardhurat e realizuara për periudhën 16.12.1991 – 15.08.1992 janë në total 9.980.529 lekë (bruto) dhe 8.534.733 lekë (neto); (iv) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 24.06.2019, nga Shkolla e Magjistraturës se subjekti i rivlerësimit është paguar për periudhën 2000-2002 në total 318.004 lekë (bruto), tatim në burim 31.774 lekë dhe 286.230 lekë (neto); (v) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 13.11.2018, nga MEPJ, se subjekti i rivlerësimit ka qenë ambasador i Rsh në Bon, dhe ka përfituar të ardhura bruto për periudhën janar 1993 – tetor 1997, në total 72.500 USD; (vi) vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nr. 673 prot., datë 31.01.2019, nga Instituti i

seancën gjyqësore të datës 10.07.2019, të zhvilluar në Kolegj, subjekti i rivlerësimit deklaroi se shuma 9,1 milionë lekë përfshin shumën totale të dhënë për pjesën e tij në ndërtimin e godinës së re, apartamentin dhe 3 hapësira të përbashkëta, përfshirë këtu edhe 1,6 milionë lekë për arredimin e apartamentit të tij. Kjo shumë është dhënë në periudhat kohore dhe në sasi të vijojnë: 2,5 milionë lekë në vitin 1996, 4 milionë lekë nga shitja e apartamentit z. F.S dhe 2,6 milionë lekë në verë të vitit 1999. Në seancën gjyqësore të datës 25.06.2019, subjekti i rivlerësimit, në shtesë të argumenteve në kundërankim, deklaroi se ai ka kontribuar për investimin edhe me të ardhurat e tij si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Gjermani dhe më pas si hulumtues në “{\*\*\*}”, nga ku ka përfituar 55 800,00 marka për periudhën 01.01.1998 – 31.12.1998 dhe 38 800,00 marka për periudhën 01.01.1999 – 31.08.1999<sup>81</sup>. Në seancën gjyqësore të datës 10.07.2019, subjekti pretendoi se paratë i kishte sjellë në Shqipëri dorazi dhe se në ato vite nuk kishte banka nëpërmjet të cilave ai të kishte mundësi të kryente dërgesat, duke u shprehur: *[...] i kam sjellë siç i kanë sjellë të gjithë... jam i sigurt që i kam deklaruar kur kam fluturuar, kur kam ardhur, se s’i mbaj mend mirë si i kemi nisur ato, po besoj unë i kam marrë ato në vitin ’95, ’96 ose edhe në ’99 dhe ua kam dhënë nga banka bashkëpronarëve të tjerë, si kontributin tim për ndërtimin e godinës [...].*

49. Trupi gjykues i Kolegjit analizoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provave për të provuar aftësinë financiare të tij dhe të bashkëshortes për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shumën e pretenduar si kontribut për ndërtimin e godinës. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, u morën në konsideratë të gjitha vlerat e mundshme të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, përfshirë vlerën 9,1 milionë lekë (pa vlerën e arredimit), të deklaruar në Kolegj, vlerën 8,4 milionë lekë të deklaruar në deklaratën *vetting*, vlerën 8.305.000 lekë të rezultuar nga kostoja faktike e ndërtimit, sipas aktit të kolaudimit vetëm për sipërfaqen takuese të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij<sup>82</sup>, si dhe vlerën 9,5 milionë lekë si vlerë takuese nga kostoja faktike vetëm për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, e deklaruar si kontribut/investim në mënyrë të barabartë nga të gjithë bashkëpronarët, në deklaratën noteriale të datës 22.02.2019, të depozituar në seancën e datës 25.06.2019<sup>83</sup>. Analiza u krye për periudha kohore të caktuara, përkatësisht sipas momenteve kur subjekti deklaroi se është paguar secili kontribut. Lidhur me mundësinë e kursimit deri në vitin 1992, trupi gjykues nënvizon se të ardhurat e përfituara nga

*Sigurimeve Shoqërore, sipas të cilit znj. N.Z. për periudhën gusht 1999 – dhjetor 2002 dhe për periudhën janar 2003 – qershor 2005 ka realizuar të ardhura mbi bazë të të cilave është derdhur kontribut nga subjekti “{\*\*\*}”; (vii) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 21.01.2019, nga MASR, sipas të cilit znj. N.Z. ka punuar si mësuese në periudhat 01.02.1989 – 30.06.1989 dhe 01.09.1989 – 21.08.1992; (viii) librezë pune e znj. N.Z., datë 18.10.1989, Qendra e Arsimit {\*\*\*}, nr. regj. {\*\*\*}.*

<sup>81</sup> Konvertuar me kursin mesatar të markës kundrejt lekut për vitin 1998, vlera është 4.779.409 lekë dhe për vitin 1999 vlera është 2.915.564 lekë – burimi:

[https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/Arkiva\\_e\\_kursit\\_te\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/)

<sup>82</sup> Në aktkolaudimin e vitit 2000, konfirmohet një vlerë faktike e investimit prej 38.000.000 lekësh për një sipërfaqe totale ndërtimi prej 2050 m<sup>2</sup> (përfshirë 21 m<sup>2</sup> sipërfaqe të përbashkëta, shkallë dhe ashensor), nga ku rezulton një kosto ndërtimi faktike prej 18.537 lekësh/m<sup>2</sup>. Sipërfaqja totale e ndërtesës që i përket subjektit dhe bashkëshortes, rezulton të jetë 448 m<sup>2</sup> (293 + 70 + 65 + 15 + 21/4) dhe vlera totale e investimit të tyre përlllogarit në 8.305.000 lekë (18.537 x 448).

<sup>83</sup> Në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.02.2019, para noteres M.P, me deklarues M.H, V. N., N.Z. dhe A.M, deklarohet: “[...] së bashku me bashkëshortët respektivë E.H, D.N, Xhezair Zaganjori dhe K. M (A), janë bashkëpronarë në pjesë të barabarta prej ¼ të pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*}, të regjistruar më datë 15.08.2001, pronë e ndërtuar mbi truallin në pronësi të z. H.M dhe znj. Sh.Z [...] ndërtimin e kësaj pasurie e financuam të gjithë së bashku dhe në mënyrë të barabartë [...] i gjithë ndërtimi u bë vetëm me kontributin/investimin e përbashkët dhe të barabartë nga ana jonë [...]”. Nga akti i kolaudimit rezulton se vlera faktike e punimeve është 38.000.000 lekë, duke e pjesëtuar me 4 në mënyrë të barabartë, rezulton se për secilin çift bashkëpronarësh vlera faktike e paguar është 9.500.000 lekë.

individët në Shqipëri deri në vitin 1992, për shkak të krizës drastike financiare që kaloi vendi atë vit, si pasojë e ndryshimeve të natyrës politike dhe ekonomike, janë të papërfillshme<sup>84</sup> për shkak të inflacionit deri në masën 400 për qind (%) që kaloi ekonomia shqiptare. Si rrjedhojë, vërtetimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat nga punësimi pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe punësimi i bashkëshortes si mësuese deri në vitin 1992, megjithëse përbëjnë prova të rregullta dhe të besueshme në aspektin e formës dhe të përmbajtjes, nuk mund të vërtetojnë kursimet për këtë periudhë. Për pasojë, këto shkresa u çmuan me vlerë provuese të kufizuar në kontekstin e rivlerësimit dhe pa efekt në vendimmarrjen e trupit gjykues<sup>85</sup>.

50. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 25.06.2019 se “ka jetuar me 1 mijë e pak USD në Bon si ambasador dhe se shpenzimet e qirasë së banesës, drita, ujë dhe shpenzime të tjera nuk e kalonin vlerën 900 marka dhe se në rastin më të keq ka tepruar gjysma, por edhe më tepër”<sup>86</sup>, nuk u shoqëruan me dokumentacion provues qoftë për shpenzimet apo kursimet e deklaruar. Referuar analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit mbi të ardhurat, shpenzimet dhe kursimet e tij dhe të bashkëshortes, të deklaruar dhe të provuara me dokumentacion dhe akte shkresore zyrtare, trupi gjykues konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të vërtetojë bindshëm burimin e ligjshëm të shumës 9,1 milionë lekë. Në analizën financiare të kryer u mbajtën në konsideratë mundësitë e kursimit nga raporti mes të ardhurave dhe shpenzime referuar: a) të ardhurave të subjektit të rivlerësimit nga paga si ambasador i Republikës së Shqipërisë në Gjermani; b) të ardhurave nga bursa e akorduar nga “{\*\*\*}”; c) të ardhurave nga puna si pedagog në Fakultetin e Drejtësisë; ç) si dhe të ardhurave të bashkëshortes nga puna pranë shoqërisë “{\*\*\*}”, dhe shpenzimet për konsum referuar nivelit të jetesës në Gjermani përgjatë periudhës së jetesës së deklaruar në atë vend dhe më pas në Shqipëri<sup>87</sup>, si dhe shpenzimet e tjera të deklaruar

---

<sup>84</sup> <https://data.worldbank.org/indicator/FP.CPI.TOTL.ZG?locations=AL>  
<https://www.ebrd.com/downloads/research/economics/workingpapers/wp0088.pdf>  
[https://www.indexmundi.com/albania/inflation\\_rate\\_\(consumer\\_prices\).html](https://www.indexmundi.com/albania/inflation_rate_(consumer_prices).html)  
<http://open.data.al/en/lajme/lajm/id/71/Historic-Inflation-in-Albania>  
[https://www.bankofalbania.org/rc/doc/inflacioni\\_8660.pdf](https://www.bankofalbania.org/rc/doc/inflacioni_8660.pdf), faqe 18 dhe 19.  
<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/71/titull/HistorikiInflacionitneShqiperi/Historik-i-Inflacionit-ne-Shqiperi>

<sup>85</sup> Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] Komisioni dhe Kolegji i Apelit të bazojnë vendimin e tyre vetëm [...] në prova që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

<sup>86</sup> Deklarimi i subjektit në seancën publike në Kolegji, datë 25.06.2019.

<sup>87</sup> Për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës për këtë periudhë është përdorur metodologjia si në vijim: shpenzimet e jetesës për periudhën deri në vitin 1992 janë konsideruar 100% e të ardhurave të kësaj periudhe, duke konsideruar faktet e cituara në paragrafin 49, për periudhën 1993-1994, 100% e të ardhurave nga pagat, në referencë të nivelit të Poverty Line të Eurostat për vitin 1995 – viti i parë për të cilin ka informacion nga Eurostat. Nga të dhënat e këtij të fundit rezultoi se paga vjetore bruto e subjektit si ambasador i Republikës së Shqipërisë, prej 12.500 USD, është konsideruar në nivelin e Poverty Line të vitit 1995, prej 16.932 eurosh; shpenzimet e jetesës për vitet 1995-1998 dhe për 8 muaj të vitit 1999 janë përlllogaritur referuar nivelit të Poverty Line të nxjerrë nga Eurostat, për një familje me katër persona me dy fëmijë nën 14 vjeç në euro/vit (<http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do>), të konvertuara në lekë me kursin e euros të vitit 1999, sipas arkivit të Bankës së Shqipërisë ([https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/Arkiva\\_e\\_kursit\\_te\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/)); ndërsa shpenzimet e jetesës për periudhën shtator-dhjetor 1999 janë konsideruar 66% e të ardhurave nga pagat; ndërsa shpenzimet e jetesës për periudhën 2000-2002 janë vendosur sipas shkresës së ILDKPKI-së.



nga subjekti i rivlerësimit<sup>88</sup>. Nga analiza e këtyre dokumenteve dhe burimeve të hapura, në këtë rast Eurostat (shih poshtëshënimin 87), subjekti i rivlerësimit rezulton të mos mbulojë me burime të ligjshme kursimet e pretenduara dhe shpenzimet për konsum ose shpenzime të tjera në vlerën 6.698.384 lekë<sup>89</sup>.

51. Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti i rivlerësimit pavarësisht se provoi ligjshmërinë e burimeve të tij për të ardhurat në Gjermani, nuk provoi kursimet dhe mënyrën e transferimit të tyre në Shqipëri (qoftë edhe për tërheqjen e pretenduar nga bankat gjermane), mbi dërgimin nga Gjermania në Shqipëri të bashkëpronarët të shumave të pretenduara në periudhën 1995-1999. Përkundër argumentit të subjektit të rivlerësimit se në vitet 1998-1999 nuk kishte banka, trupi gjykues vëren se bankat në Shqipëri kanë funksionuar edhe në periudhën kohore në fjalë. Dokumentet zyrtare nga burime të hapura tregojnë se, duke filluar nga viti 1993, në Shqipëri operonin shtatë (7) banka, në vitin 1997 tetë (8) banka dhe në vitin 1998 dhjetë (10) banka<sup>90</sup>. Për këtë arsye, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron dhe për këtë arsye nuk mund të çmohet nga trupi gjykues as si argument që mund të arsyetohej si pretendim i subjektit të rivlerësimit për pamundësi objektive për të sjellë dokumente, i parashikuar nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016<sup>91</sup>, pasi në rastin konkret nuk u pretendua pamundësi objektive për të disponuar një apo disa dokumente. Subjekti u kufizua vetëm me pretendimin e pambështetur në fakte për ekzistencën e kapaciteteve bankare në fund të viteve '90, që rezulton një fakt i pakontestueshëm.

Po kështu, deklaratimet e subjektit për mënyrën informale të operimit me këto fonde, pa detaje për mënyrën e sjelljes në Shqipëri apo të tërheqjes në ndonjë formë në momentin e pagesës, nuk përmbushin asnjë nga kërkesat e ligjit dhe ato të udhëzimit nr. 4095/2016 të ILDKPKI-së (pikat 21)<sup>92</sup>, lidhur me paraqitjen e dokumentacionit justifikues ligjor për mënyrën e kalimit të mjeteve monetare të të ardhurave të siguruara nga jashtë Shqipërisë.

---

<sup>88</sup> Përfshirë shpenzimet e kryera për të mbuluar diferencën e çmimit të blerjes së apartamentit në rrugën “{\*\*\*}” (shkëmbimi me EKB-në), pagesën e kryer për tatimin për shitjen e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, si dhe shpenzimet e arredimit të apartamentit.

<sup>89</sup> Kjo përlllogaritje rezulton nga zbritja e shpenzimeve të jetesës dhe të tjera shpenzime të konfirmuara/deklaruar (referuar gjithashtu në poshtëshënimet 80 dhe 81) nga të ardhurat e ligjshme të konfirmuara me dokumentacion provues, si vijon: 1) të ardhurat e subjektit të rivlerësimit si pedagog në Fakultetin e Drejtësisë për vitet 1991-1992 dhe 1999-2003; 2) të ardhurat e subjektit si ambasador i Republikës së Shqipërisë në Gjermani për periudhën 1992-1997; 3) të ardhurat e subjektit si hulumtues në “{\*\*\*}” për vitet 1998-1999, në shumën 94.600,00 marka; 4) të ardhurat e subjektit nga Shkolla e Magjistraturës për vitet 2000-2002; 5) të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi pranë “{\*\*\*}” në vitet 1999-2002.

<sup>90</sup> Vështrim historik i bankave në Shqipëri, botim i shoqatës së bankierëve shqiptare, 2012. Në vitin 1993 operonin 7 banka, në vitin 1997 në Shqipëri operonin 8 banka (faqe 83), në vitin 1998 10 banka (faqe 84, tabela 5)-<https://aab.al/wp-content/uploads/2019/02/historiku-en-pdf-resize.pdf>

<sup>91</sup> Sipas kësaj dispozite: “[...] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetohet institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme [...]”.

<sup>92</sup> Neni 32 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] 1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaratimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. [...]”.

Pika 21 e Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së parashikon: “Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga emigracioni prej subjektit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklaratimit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë.”

Pika 22 e udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së parashikon: “Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga aktiviteti privat i subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur me të, të shoqërohet për

iii) *Burimi i deklaruar “të ardhurat nga qiraja” nuk mund të konsiderohet i ligjshëm në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasi për këtë periudhë mungon akti i pronësisë, marrëdhënies kontraktuale të qirasë dhe shlyerjes së detyrimeve tatimore.*

52. Komisioni ka arsyetuar në vendim se nga hetimi administrativ ka rezultuar se objekti ka përfunduar së ndërtuari në gusht të vitit 1997 dhe se nga ky moment ka qenë edhe funksional. Marrëdhënia juridike e qirasë ka lindur në shtator të vitit 1997 me subjektin “{\*\*\*}”. Sipas Komisionit, ka rezultuar se bashkëpronarët, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, për arsye operativiteti dhe mbarëvajtjeje të mënyrës se si do të përditësohej marrëdhënia juridike e qirasë, kanë rënë dakord verbalisht dhe me veprime konkludente që përfaqësimin e zakonshëm me palën qiramarrëse ta realizonte njëra nga bashkëpronarët, konkretisht znj. M.H. Ndërkohë që ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit bashkë me bashkëshorten, si pjesë dhe kontribut në bashkësinë ligjore, kanë filluar ta përfitojnë drejtpërdrejt të ardhurën respektive nga qiraja në muajin janar 1999 e në vijim.<sup>93</sup>
53. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për të 4 (katra) pasuritë e paluajtshme, që përveç të ardhurave personale, kanë qenë edhe të ardhurat nga qiraja, ndërsa në deklaratën fillestare të pasurisë për vitin 2003 ka deklaruar se burim krijimi për pasurinë e paluajtshme “bodrum” kanë shërbyer të ardhurat nga qiraja e bibliotekës. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se znj. M.H, si bashkëpronare dhe përfaqësuese e bashkëpronarëve të tjerë, ka nënshkruar kontratat respektive me “{\*\*\*}”. Për të vërtetuar pagesat e qirasë gjatë gjithë periudhës, duke filluar nga muaji shtator 1997, dhe shlyerjen e detyrimit tatimor për këtë qira, në seancat gjyqësore të datës 25.06.2019 dhe 10.07.2019, subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumente në cilësinë e provës<sup>94</sup>.
54. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se më datë 10.09.1997, znj. M.H, në cilësinë e qiradhënëses dhe si pronare e vetme ligjore, ka nënshkruar kontratën për dhënie me qira të hapësirës së katit përdhes me sipërfaqe 250 m<sup>2</sup>, për periudhën 01.09.1997 - 31.08.2002, me pagesë mujore 3200 USD, që do të paguhej në formën e një transferte në llogarinë {\*\*\*} City Bank, Selanik, me përfaqësuesin e “{\*\*\*}”.<sup>95</sup> Po kështu, znj. M.H ka deklaruar që për kontratat e qirasë me {\*\*\*} – Shqipëri, për periudhën 2001-2006, ka transferuar në mënyrë të vazhdueshme pjesën takuese të qirasë te bashkëpronarët e tjerë, si dhe ka paguar rregullisht detyrimet tatimore<sup>96</sup>. Ndërkohë që 8 (tetë) bashkëpronarët e 3 (tre) njësi të shërbimit në godinë, përfshirë subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, i kanë dhënë znj. M.H vetëm në shkurt 2003 autorizim për të nënshkruar në

---

*periudhën e deklaruar me dokumentacionin justifikues ligjor nga zyrat e tatim taksave për fitimin e realizuar dhe dividendin e tërhequr.”*

<sup>93</sup> *Shih faqen 26 të vendimit të Komisionit*

<sup>94</sup> (i) *Deklaratë noteriale nr. 201 rep., nr. 57/1 kol., datë 22.02.2019, para noteres M.P, me deklarues M.H, V.N., N.Z. dhe A.M; (ii) korrespondencë ndërmjet drejtuesit të “{\*\*\*}” me Degën e Thesarit të Departamentit për {\*\*\*}, datë 08.10.1997; (iii) mandatpagesë nga “{\*\*\*}” në vlerën 12.800 USD, të kryer nga Londra në datën 13.11.1997, për z. E.H; (iv) mandatpagesë nga “{\*\*\*}” në vlerën 12.800 USD, të kryer nga Londra në datën 22.06.1998 (pagesë qiraje qershore – shtator 1998); (v) raport analitik për marrëdhëniet me bankën – Citistatement, për M.H dhe/ose E.H dhe/ose V.N për transfertë depozitimi 12.800 USD, me balancë 24.000,33 USD, datë 05.07.1998; (vi) akt ekspertimi financiar, datë 05.07.2019 (87 faqe), i hartuar nga znj. B.S, audituese ligjore (ekspert kontabël i autorizuar), nr. licence {\*\*\*}, datë 15.10.2008*

<sup>95</sup> *Shih kontratën për marrje me qera vendi për zyrë datë 10.09.1997 (fashikulli 15) ku gjenden dy kontrata të përfaqëta me disa ndryshime në tekst: faqe 2087 dhe faqe 2091.*

<sup>96</sup> *Shih deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., e datës 03.05.2016, në fashikullin 15, faqe 1523.*

emër të tyre kontrata për dhënie me qira të ambienteve.<sup>97</sup> Nga ana tjetër, pas depozitimit të ankimit të Komisionerit Publik, të 8 (tetë) bashkëpronarët, përfshirë subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, në shkurt 2019 (gjatë periudhës kur çështja pritej të shqyrtohej në Kolegi) kanë nënshkruar një deklaratë noteriale<sup>98</sup>, të cilën subjekti e paraqiti në seancën e datës 25.06.2019 në Kolegj. Sipas kësaj deklarate, përfaqësuesja e bashkëpronarëve, znj. M.H, ka paguar [për të gjithë ata] të gjitha detyrimet tatimore dhe të ardhurat vjetore të përfituara nga këto kontrata të ndara në 4 pjesë të barabarta dhe i ka shpërndarë rregullisht te secili nga deklaruesit, në çdo janar të vitit pasardhës. Gjithashtu, ata deklarojnë se bashkëpronarëve, znj. N.Z. dhe z. Xhezair Zaganjori, qiraja iu është dhënë për periudhën janar 1999 – qershor 2006. Ndërsa më përpara, gjatë periudhës shtator 1997 – dhjetor 1998, pjesa e tyre takuese përdorej për të kompensuar bashkëpronarët që kishin investuar më tepër dhe pjesërisht për investime/rregullime në hapësirat e objektit. Për të provuar këtë pretendim, në seancën e datës 10.07.2019, subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës një akt ekspertimi bashkëlidhur të cilit ndodheshin vërtetime transfertash bankare të përfituara nga M.H dhe/ose E.H dhe/ose V.N nga “{\*\*\*}” në llogarinë fillimisht në Citibank (deri në vitin 2003) dhe më tej në llogarinë e znj. M.H në Bankën Italo-Shqiptare. Në të njëjtën seancë, subjekti i rivlerësimit paraqiti nxjerrje të llogarive nga Banka e Kursimeve dhe nga banka “Intesa Sanpaolo” mbi pagesat e kryera nga “{\*\*\*}” ndaj Sektorit të Tatimeve për familjen {\*\*\*}, me shënimin “tatim mbi qira”.

55. Nga aktet e paraqitura dhe të administruara, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor mbi mënyrën e kalimit të shumës takuese nga qiratë e deklaruara si të përfituara pas janarit të vitit 1999, nga znj. M.H.

55.1. Sipas dokumentacionit bankar të paraqitur, të gjitha pagesat e qirasë nga “{\*\*\*}” kanë kaluar kryesisht në llogarinë e znj. M.H dhe/ose të z. E.H dhe/ose të znj. V.N (në rastin e llogarisë në Citibank, Selanik). Pagesat e tatimit mbi qira nga “{\*\*\*}”, të kryera pranë Bankës së Kursimeve për llogari të familjes {\*\*\*}, përgjatë periudhës tetor 1998 – shkurt 2000<sup>99</sup>, dhe në bankën “Intesa Sanpaolo”, për periudhën mars 2000 – dhjetor 2005, nuk provojnë se cilës pasuri i përkasin, dhe nuk i referohen në asnjë rast qirasë së përfituar nga “{\*\*\*}”. Për më tepër, kontratat e qirasë janë lidhur vetëm me znj. M.H, e cila ka deklaruar fillimisht në deklaratën noteriale të datës 03.05.2016 dhe më tej në deklaratën noteriale të datës 22.02.2019 (bashkërisht me bashkëpronarët e tjerë) se ka marrë përsipër dhe ka paguar detyrimin tatimor mbi të gjithë shumën e qirasë sipas kontratave të qirasë, pa iu referuar në asnjërin nga deklaratat apo pa specifikuar në asnjë rast se kjo pagesë është kryer nga shoqëria “{\*\*\*}”. Po kështu, nuk rezulton ndonjë e dhënë që znj. M.H të jetë në marrëdhënie të posaçme ligjore, financiare apo përfaqësimi me shoqërinë “{\*\*\*}”<sup>100</sup>, në cilësinë e administres, ortakës apo përfaqësueses ligjore, që të mund të ketë kryer pagesat nga llogaria e kësaj shoqërie dhe që të justifikonin pretendimin se ajo ka kryer pagesat e këtyre detyrimeve<sup>101</sup>. Kontratat e qirasë me “{\*\*\*}”, për periudhën shtator 1997 – gusht 2002, nuk përmbajnë asnjë parashikim lidhur me palën që kishte detyrimin për të kryer pagesën e detyrimeve tatimore. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se edhe nëse do të merreshin në konsideratë këto të ardhura, përlllogaritja

<sup>97</sup> Prokura e posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., e datës 28.02.2003, *Fashikulli 15*.

<sup>98</sup> Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.02.2019, para noteres M.P.

<sup>99</sup> Dokumentacion i paraqitur jo në formën e rregullt ligjore (kopje e panjësuar me origjinalin).

<sup>100</sup> Shih “Ekstraktin historik” të këtij personi juridik në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit në:

[file:///C:/Users/admin/Downloads/EkstraktIThjeshte-10\\_2\\_2019.pdf](file:///C:/Users/admin/Downloads/EkstraktIThjeshte-10_2_2019.pdf) dhe

[file:///C:/Users/admin/Downloads/EkstraktHistorik-10\\_2\\_2019.pdf](file:///C:/Users/admin/Downloads/EkstraktHistorik-10_2_2019.pdf).

<sup>101</sup> Subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi asnjë dokument provues për informacionin e dhënë në aktin e ekspertimit, se znj. H. ka qenë punonjëse pranë shoqërisë “{\*\*\*}” gjatë periudhës 1998-2019.

e tyre si burim të ardhurash për subjektin e rivlerësimit [dhe bashkëshorten e tij] do të fillonte nga tetori i vitit 2001, kur ata kanë fituar ligjërisht titullin e pronësisë mbi tre njësitë e shërbimit. Edhe znj. M.H. në deklaratën e saj të parë [në vitin 2016], shpjegon se ajo ka transferuar të ardhurat nga qiraja me “{\*\*\*}” te bashkëpronarët vetëm për periudhën 2001-2006. Nga ana tjetër, nuk rezulton që deri në muajin shkurt 2003, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij t’i kenë dhënë autorizim znj. M.H për të nënshkruar kontrata qiraje në emër të tyre, për pjesët e tyre takuese të pasurive të përbashkëta.

**55.2.** Trupi gjykues, vëren se sipas ligjit nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, tatimi mbi të ardhurat nga qiraja ka qenë 20%. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8438/1998<sup>102</sup> (që shfuqizoi ligjin nr. 7786/1994), tarifa tatimore për të ardhurat nga qiraja u ul në 10%. Sipas ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar, detyrimin për të paguar tatimin e ka çdo person që përfiton të ardhura [pra qiradhënësi] të cilat i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat. Me ligjin ndryshues nr. 8841/2001<sup>103</sup>, legjislatori parashikoi detyrimin e mbajtjes në burim nga qiramarrësi të tatimit për pagesat për qiratë (neni 8). Referuar parashikimeve ligjore sa më sipër, trupi gjykues vëren se edhe sikur të prezumohej se pagesa e tatimit është kryer nga shoqëria “{\*\*\*}”, sikurse pretendon subjekti, nga dokumentacioni bashkëlidhur aktit të ekspertimit rezulton se: i) kjo shoqëri ka paguar tatim mbi qiranë për llogari të familjes {\*\*\*}, duke filluar nga muaji tetor 1998, ndërkohë që ambienti i është dhënë me qira “{\*\*\*}” në muajin shtator 1997 dhe vjelja e të ardhurave nga qiraja ka filluar nga data 3 tetor 1997, sikurse rezulton nga korrespondenca me z. J.Mc.G dhe nga pagesat e derdhura në Citibank në llogarinë në emër të z. E.H, në vlerën 12.800 USD për 4 muaj (dokumentacion i paraqitur në seancën gjyqësore të datës 10.07.2019); ii) rezulton se subjekti i rivlerësimit në çdo deklaram të tij, qoftë në deklaratat periodike, qoftë edhe gjatë hetimit administrativ, u referohet të ardhurave nga kjo qira në formën bruto të tyre. Kështu, në provat dhe shpjegimet me shkrim lidhur me rezultatet paraprake të hetimit dërguar nga Komisioni më 26 qershor 2018, subjekti i rivlerësimit është shprehur: [...] *Deri në fund të vitit 2002, i bie që vetëm nga ky subjekt qiramarrës [{\*\*\*}], unë me bashkëshorten kemi përfituar shumë prej 38.400 USD [...].* Po kështu, në deklaratën periodike vjetore për vitet 2004 dhe 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura në vlerën 9.600 dollarë nga qiraja me “{\*\*\*}”. Nga një përlllogaritje sipas këtyre deklarimeve, rezulton si vijon: 9.600 USD të deklaruar për secilin nga vitet, 2004 dhe 2005, nga subjekti, rezultojnë të jenë shuma që përftohet nga 12 muaj pagesë e shumës prej 800 USD (pra, ¼ pjesë e 3.200 USD – pjesa takuese e subjektit dhe e bashkëshortes prej të ardhurave bruto nga qiraja), ndërsa vlera 38.400 USD përlllogaritet si pjesa takuese e subjektit dhe e bashkëshortes për vitet 1999-2002 (9.600 USD në vit x 4 vite), kjo e fundit vlera bruto e qirasë mujore. Nëse do të ishte kryer pagesa e tatimit mbi këto qira, vlera e përfituar nga subjekti nga këto të ardhura për vit do të përlllogaritej në 8.640 USD (9.600 USD [qira bruto mujore] – 960 USD [10% tatim]), kurse për periudhën 1999-2002 këto të ardhura do të duhet të deklaroheshin në vlerën neto prej 34.560 USD (38.400 USD [qira bruto] – 3.840 USD [10% tatim]); iii) pavarësisht se ligji nr. 8438/1998 ka parashikuar në ndryshimet e vitit 2001 se tatimi për të ardhurat e qirasë mbahet në burim<sup>104</sup>, znj. H. deklaron se pagesa e tatimit për qiranë e ambienteve

<sup>102</sup> Ligji është shpallur me dekretin nr. 2289, datë 31.12.1998, të Presidentit të Republikës dhe hynte në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

<sup>103</sup> Publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 26.12.2001

<sup>104</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.04.2018, drejtuar KPK-së, për pyetjen: “A duhet të paguhen taksa apo tatime në buxhetin e shtetit dhe cili është subjekti që ka detyrimin (qiramarrësi dhe qiradhënësi)?” – shprehet se: “Në rastin e kontratave të qiradhënies të lidhura ndërmjet dy individëve, detyrimin për deklarimin dhe pagimin në organet tatimore të tatimit të qirasë e ka individi përfitues. Në rastin e kontratave të

më qira nga “{\*\*\*}” është kryer prej saj. Ky parashikim i pagesës së tatimit nga qiradhënësi [znj. M.H] rezulton edhe në kontratën e qirasë për periudhën janar – dhjetor 2005 [neni 3/1]. Për rrjedhojë, nga analiza tërësore, trupi gjykues i Kolegjit krijon bindjen se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti për të provuar të ardhurat nga qiraja për këtë periudhë (1997-2003) nuk plotëson kërkesat e udhëzimit nr. 4095/2016, të ILDKPKI-së (pikat 8, 10 dhe 23<sup>105</sup>), pasi subjektit i mungonte titulli i pronësisë deri në tetor 2001 dhe mungon dokumentacioni që do të provonte kalimin e të ardhurave nga qiraja dhe pagesën e tatimeve për pjesën takuese nga vetë subjekti Për periudhën kohore pas fitimit të pronësisë, e konkretisht, tetor 2001, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti për të provuar burimin e ligjshëm nga qiratë përmban mospërputhje mes parashikimit ligjor për tatimin në burim përkundër deklaratës së znj. M.H dhe kontratave të qirasë, të cilat duket se zbatojnë ligjin dhe praktikën e mëparshme të këtyre palëve kontraktore. Në analizë të këtyre dokumenteve dhe fakteve, trupi gjykues vëren si rrjedhojë se dokumentet e sjella duket se nuk kanë ndjekur logjikën e ligjit. Parë bashkërisht edhe me pretendimin e subjektit për të provuar pagesën e tatimit, megjithëse mungon dokumentacioni që provon kalimin e shumës së qirasë për pjesën takuese të tij dhe të bashkëshortes, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk është bindës.

56. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se në kushtet e mungesës së titullit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme të dhënë me qira, mungesës së marrëdhënies kontraktuale dhe mungesës së vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve tatimore, të ardhurat nga qiraja për këtë periudhë nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në vijim të këtij vlerësimi, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk është i saktë kur deklaron në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 se burimi i krijimit për pasurinë “zyrë” është e ardhura nga qiraja e bibliotekës, në kushtet kur pronësia mbi të dyja këto njësi është fituar njëkohësisht, pra në vitin 2001.
57. Në konkluzion të shqyrtimit të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik lidhur me 4 (katër) pasuritë e paluajtshme të ndodhura në Tiranë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, siç përcaktohet nga neni 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016 dhe nga neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës.

*b/2) Shkaqet e ankimit për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të ndodhur në Durrës*

58. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të ndodhur në Durrës, Komisioneri Publik vlerëson se referuar nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e saj, përderisa nuk*

---

*qiradhënies ndërmjet një individi dhe një personi të tatuashëm të regjistruar në një nga mënyrat ligjore (QKB, Gjykatë, Tatime) dhe i pajisur me numër identifikimi të subjektit të tatuashëm (NIPT), detyrimin për përlogaritjen, deklarimin dhe pagimin, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar, e ka ky i fundit, por shuma e tatimit do të mbahet nga të ardhurat bruto që përfiton subjekti, sipas përcaktimit ligjor në nenin 8 të po këtij ligji”.*

<sup>105</sup>*Pika 8 e udhëzimit parashikon: “Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor, kontratë shitblerjeje, kontratë sipërmarrjeje, akt-marrëveshje, kontratë paraprake, kontratë porosie etj., dhe certifikatën e pronësisë në rastet kur prona është e regjistruar në ZVRPP”.*

*Pika 10 e udhëzimit parashikon: “Deklarimi i pasurive të paluajtshme të dhëna me qira te persona të tjerë të lidhur, shoqërohet me kontratën e qiradhënies të lidhur para noterit”.*

*Pika 23 e udhëzimit parashikon: “Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga qiraja, të shoqërohet me vërtetimin përkatës për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja”.*

*konfirmohet tërheqja e shumës prej 16000 USD nga llogaria bankare, sipas deklaratave të vetë subjektit.*

59. Në arsyetimin e vendimit, Komisioni argumenton se në vitet 2003-2005, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë depozituar në bankën “Intesa Sanpaolo” ShA totalin e shumës 47.000 USD dhe se nga kjo shumë janë përfituar interesa në vlerën 3.000 USD. Nga kjo shumë, në këtë bankë, janë tërhequr 34.000 USD, që shërbyen për blerjen e apartamentit në Durrës. Këto fakte, vëren Komisioni, dalin nga këqyrja e deklaratave të pasurisë së subjektit të rivlerësimit ndër vite.<sup>106</sup>
60. Komisioneri Publik vlerëson se diferenca prej rreth 1.760.000 lekësh (diferenca e vlerave 32.000 USD - 1.200.000 lekë, e konvertuar me kursin mesatar të vitit 2006, sipas BSh), rezulton e pambuluar me të ardhura të ligjshme, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë provë për të provuar tërheqjen e shumës 16.000 USD, të deklaruar rishtas si burim krijimi në përgjigjet ndaj pyetësorit të Komisionit, të datës 1 mars 2018.<sup>107</sup>
61. Në *apelin kundërshtues*, subjekti i rivlerësimit parashtron se burimi i krijimit të kësaj pasurie ka qenë kryesisht qiraja mujore nga “{\*\*\*}”, nga janari i vitit 1999 deri në fundin e vitit 2002, në shumën 38.400 USD, dhe kursimet. Pjesa prej 16.000 USD janë kursimet nga kjo e ardhur. Subjekti po ashtu deklaroi se në vitet 2003-2005 janë depozituar në bankën “Intesa Sanpaolo” ShA 47.000 USD dhe prej kësaj depozite janë përfituar interesa në vlerën 3.000 USD. Nga kjo depozitë, është tërhequr shuma prej 34.000 USD, që ka shërbyer për blerjen e apartamentit në qytetin e Durrësit.<sup>108</sup> Në prapësimet gjatë seancës gjyqësore të datës 10.07.2019 në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nënvizoi se shuma prej 32.000 USD, duke qenë shpenzimi i vetëm i kryer në vitin 2006, mbulohej edhe vetëm me të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes gjatë atij viti, të cilat shkonin në vlerën 6,2 milionë lekë. Ndërkohë, në vitin pasardhës (2007), teprica nga diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve shkon në rreth 3 milionë lekë (sipas deklaratave të pasurisë të viteve 2006 dhe 2007). Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj nxjerrjen e llogarisë nga banka “Intesa Sanpaolo”, të datës 06.07.2018, në të cilën janë pasqyruar lëvizjet e llogarisë në USD pranë kësaj banke për periudhën 01.07.2003 – 06.07.2018.
62. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se lidhur me pasurinë e paluajtshme “apartament”, të ndodhur në lagjen {\*\*\*}, Durrës, me sipërfaqe 81 m<sup>2</sup>, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar bashkëpronësi me bashkëshorten, blerë më datë 07.06.2006<sup>109</sup>, me çmim 32.000 USD, të paguar jashtë zyrës noteriale<sup>110</sup>. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, burim krijimi i kësaj pasurie janë deklaruar të ardhurat personale dhe ato nga qiraja. Ndërsa në *deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2006*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar tërheqje të shumës prej 1,25 milionë lekësh dhe mbyllje të llogarisë bankare pranë Bankës Italo-Shqiptare (sot banka “Intesa Sanpaolo”), në muajin maj 2006.

Në përgjigjet e pyetësorit të Komisionit të datës 14.02.2018, subjekti i rivlerësimit është shprehur se pjesa më e madhe e shumës 16.000 USD është tërhequr nga depozita që kishte bashkërisht me bashkëshorten në Bankën Amerikane të Shqipërisë (tani “Intesa Sanpaolo”). Ndërsa në provat dhe shpjegimet me shkrim mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ të Komisionit të datës

<sup>106</sup> Faqja 15 e vendimit të Komisionit.

<sup>107</sup> Shih paragrafin e parë në faqen 12 të përgjigjeve të kthyer në datën 01.03.2018, të pyetësorit të datës 14.02.2018.

<sup>108</sup> Faqja 18 e apelit kundërshtues.

<sup>109</sup> Me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.

<sup>110</sup> Deklaruar në kontratën e shitjes, të administruar në fashikullin 13, faqe 1730 – 1732.

26.06.2018, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma prej 16.000 USD duhet të jetë dhënë në fillim të vitit 2006.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar<sup>111</sup> se në vitin 2003 ka çelur llogari në Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot banka “Intesa Sanpaolo”) me shumën 16.000 USD dhe 1.200.000 lekë në Bankën Italo-Shqiptare. Llogarinë në bankën “Intesa Sanpaolo” e ka shtuar me 15.000 USD në vitin 2004 dhe 16.000 USD në vitin 2005. Nga konfirmimet e lëvizjeve bankare të dërguara në Komision nga banka “Intesa Sanpaolo” për llogari të Bankës Italo-Shqiptare, konstatohet se depozita prej 1,2 milionë lekësh (e konvertuar në USD, përlllogaritet në vlerën rreth 12.000 USD<sup>112</sup>) është çelur nga subjekti i rivlerësimit në datën 29.03.2004 dhe është tërhequr në datën 07.04.2006 (përreth 25 muaj). Ndërkohë që nga nxjerrja e lëvizjeve të llogarisë më datë 06.07.2018, në bankën “Intesa Sanpaolo”, nuk konstatohen gjurmë të ndonjë tërheqjeje të mundshme nga kjo llogari në vitin 2006 (deri më datë 07.06.2006 kur është nënshkruar kontrata e shitblerjes së pasurisë). Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se deklarimi i subjektit mbi tërheqjen nga llogaria bankare e shumës 16.000 USD – që sipas tij shërbeu për të financuar një pjesë të pagesës së apartamentit me çmim 32.000 USD në Durrës – në një nga bankat e nivelit të dytë, mbeti e pavërtetuar me dokumentacion të rregullt bankar.

63. Nga ana tjetër, gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendoi se të ardhurat e tij në vitin 2006 ishin të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimin për blerjen e apartamentit në Durrës. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, në *pyetësorët* e Komisionit dhe *gjatë gjykimit* në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se një pjesë e të ardhurave rridhnin nga puna e tij dhe e bashkëshortes, si dhe nga kontratat e qirasë me “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}”. Në lidhje me të ardhurat nga puna e bashkëshortes pranë “{\*\*\*}” deri në qershor 2005 (çështje e trajtuar në parashtrimet e Komisionerit Publik të datës 25.06.2019<sup>113</sup>), trupi gjykues analizoi dokumentin e paraqitur nga subjekti gjatë gjykimit në Kolegj<sup>114</sup> dhe vlerësoi se kjo e ardhur plotëson kërkesat e udhëzimit nr. 4095/2016, të ILDKPKI-së (pika 20<sup>115</sup>) dhe, për rrjedhojë, ajo konsiderohet e ardhur e ligjshme. Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të pretenduara nga qiraja, shih arsyetimin e trupit gjykues në paragrafin 68 të këtij vendimi.
64. Trupi gjykues, referuar analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, për periudhën 01.01.2006 deri në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes 07.06.2006 (në kushtet kur vetë subjekti deklaroi pagesën e apartamentit “në fillim të vitit”, pa specifikuar datën konkrete), vëren se subjekti i rivlerësimit ndodhet në pamundësi financiare për të justifikuar me burime të ligjshme shpenzimet e kryera për periudhën 01.01.2006 – 07.06.2006, përfshirë edhe blerjen e apartamentit në Durrës, me diferencë të pambuluar në vlerën 458.761 lekë<sup>116</sup>. Ky

<sup>111</sup> Shih provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ të Komisionit.

<sup>112</sup> [https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/Arkiva\\_e\\_kursit\\_te\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/)

<sup>113</sup> Shih <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/Parashtrimet-e-%C3%A7%C3%ABshtjes-dat%C3%AB-25.6.2019-3.pdf> (faqe 15).

<sup>114</sup> Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare<sup>114</sup>, nr. {\*\*\*} prot., datë 31.01.2019, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas të cilit znj. N.Z. për periudhën gusht 1999 – dhjetor 2002 dhe për periudhën janar 2003 – qershor 2005 ka realizuar të ardhura mbi bazë të të cilave është derdhur kontribut nga subjekti “{\*\*\*}”.

<sup>115</sup> Pika 20 parashikon se deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga pagat shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për të ardhurat neto nga institucioni pranë të cilit kanë qenë dhe janë të punësuar subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë.

<sup>116</sup> Në këtë përlllogaritje janë konsideruar të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes për periudhën 01.01.2006 deri më 30.05.2006; pakësimet e gjendjeve të bankës deri më 07.06.2006; shpenzimet e jetesës sipas

konkluzion rrjedh nga analiza e gjendjes së llogarive bankare të subjektit deri në muajin qershor 2006<sup>117</sup>, pretendimeve të tij për tërheqje nga llogaria bankare, të cilat siç u shtjellua më sipër, nuk u provuan, nga njëra anë, dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit paraardhës, duke krahasuar deklaratat periodike vjetore të subjektit me shpenzimet e kryera deri në periudhën në fjalë. Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij në Kolegj, pretendoi edhe për kursime në formë *cash* në banesë<sup>118</sup>. Ky pretendim i subjektit, në analizë të deklaratave të tij periodike vjetore (shih paragrafin 84 më poshtë për shtjellim më të hollësishëm) nuk rezultoi bindës për trupin gjykues. Po ashtu, trupi gjykues vëren edhe që pretendimi i subjektit se të ardhurat në total të vitit 2006 mjaftonin për këtë investim të vetëm të vitit 2006, do të ishte me vend nëse kjo pasuri do të ishte blerë në fund të vitit 2006. Duke pasur parasysh që kontrata daton në qershorin e vitit 2006 dhe pohimet e subjektit po ashtu konfirmojnë pagesën përpara gjysmës së dytë të vitit, ky pretendim i subjektit për t'ia nënshtruar analizës financiare gjithë të ardhurat e vitit 2006, nuk mbështetet në fakte dhe prova dhe nuk u pranua.

64. Në konkluzion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie sipas nenit 33, pika 5, germa "a" dhe "b" të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se deklaratimet mbi këtë pasuri janë të pasakta, pasi subjekti nuk arriti të vërtetojë tërheqjen nga llogaria bankare të shumës prej 16000 USD në fillim të vitit 2006, kohë në cilën ka deklaruar dhënien e kësaj shume.

*B/3 Shkaqet e ankimit për të ardhurat nga qiraja pas vitit 2001, të deklaruara si burim krijimi pasurie dhe mbulimit të shpenzimeve ndër vite*

65. *Lidhur me të ardhurat nga qiraja për periudhën 2001 – 2007<sup>119</sup>, Komisioneri Publik vlerëson se referuar nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e ligjshme nga qiratë, për shumën totale prej rreth 8,4 milionë lekësh. Komisioneri Publik ka analizuar këto të ardhura të ndara në periudha, duke arsyetuar se:*

---

*metodologjisë së ILDKPKI-së, referuar të dhënave të INSTAT-it për pesë muaj të vitit 2006; shpenzimet për udhëtime të kryera nga subjekti ose familjarët e tij deri në 07.06.2006.*

<sup>117</sup> Nga analiza e gjendjeve të llogarive të dërguara nga banka "Intesa Sanpaolo" me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.01.2018, rezulton se: i) deri më 31.12.2003, subjekti nuk ka depozita në Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot banka "Intesa Sanpaolo"); ii) sipas konfirmimit të lëvizjeve bankare të dërguar nga Banka, depozita prej 1,2 milionë lekësh është çelur më 29.03.2004 (në datën kur është dorëzuar deklarata e vitit 2003) dhe nuk ka qenë gjendje më 31.12.2003. Kjo depozitë është tërhequr më 07.04.2006, tërheqje e cila është deklaruar edhe nga subjekti në DV-2006; iii) depozita e përbashkët me bashkëshorten në USD është çelur më 13.12.2004 dhe gjendja e saj më 31.12.2004 është 16.093,6 USD. Balanca e saj është rritur në vitin 2005, duke rezultuar me një total prej 31.576,23 USD më 31.12.2005, për të mbetur e pandryshuar në principal deri në vitin 2008, kur depozita është maturuar në datën 27.11.2008, me vlerë maturimi 33.891 USD, nga e cila subjekti ka tërhequr gjithsej 33.000 USD (10.000 USD po në këtë datë dhe 23.000 USD në datën 02.12.2008); iv) për sa u përket llogarive rrjedhëse në USD pranë bankës "Intesa Sanpaolo", nga kontrolli i lëvizjeve ditore (debitime/kreditime) në asnjë moment nuk figuron ndonjë tërheqje prej 16.000 USD ose e përafërt me 16.000 USD në vitin 2006.

<sup>118</sup> Subjekti i rivlerësimit në ankimin kundërshtues dhe në parashtrimet e paraqitura në seancën publike të datës 10.07.2019 pretendoi mbi mbajtjen e gjendjes *cash* prej rreth 900.000 lekësh për shpenzime urgjente familjare.

<sup>119</sup> Komisioneri Publik analizën financiare mbi ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja, e ka shtrirë për periudhën 1997 – 2007, duke pretenduar se për këtë periudhë subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme. Të ardhurat nga qiraja për periudhën para vitit 1999 janë përfshirë në shkakun e parë të ankimit, në kuadër të trajtimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të 4 pasurive të paluajtshme të ndodhura në Tiranë, sipas deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën vetting.



(i) të ardhurat nga qiraja për periudhën 1997-1998, me qiramarrës “{\*\*\*}” janë trajtuar në shkakun e parë të ankimit; (ii) të ardhurat nga qiraja për periudhën janar 1999 - tetor 2001, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasi: (a) subjekti i rivlerësimit nuk rezulton me titull pronësie për objektin e dhënë me qira; (b) nuk rezulton palë kontraktuese në kontratën e qirasë; dhe (c) nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurën e deklaruar në shumën 23.760,00 USD (neto); (iii) të ardhurat nga qiraja për periudhën tetor 2001 - shkurt 2003, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasi subjekti i rivlerësimit: (a) nuk rezulton palë kontraktuese në kontratën e qirasë; dhe (b) nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurën e deklaruar në shumën 11.520,00 USD (neto); (iv) të ardhurat nga qiraja për periudhën shkurt 2003 – dhjetor 2005, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasi subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurën e deklaruar në shumën 25.200.00 USD (neto); (v) të ardhurat nga qiraja për vitin 2007 me qiramarrës “Qendra {\*\*\*}”, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, pasi subjekti i rivlerësimit nuk është palë në kontratë dhe nuk mund të identifikohet qartë pasuria e dhënë me qira dhe të ardhurat e realizuara nga kjo marrëdhënie.

(vi) të ardhurat nga qiraja për periudhën 2005-2006, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasi subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara në shumën 4.800,00 USD dhe 2.160,00 euro; (vi) të ardhurat nga qiraja për vitin 2007, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasi subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues marrëdhënien kontraktuale dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara në shumën 270.000,00 lekë.

66. Për sau përket të ardhurave nga qiratë, Komisioni fillimisht ka konstatuar se pjesa më e madhe e kontratave përkatëse janë bërë pa akt noterial, gjë që lë vend për dyshime, sidomos sepse deklaratat e bëra nga subjekti i rivlerësimit nuk përputhen me dokumentacionin përkatës shkresor që ndodhet në dosje<sup>120</sup>. Më tej në vendim është arsyetuar se në kontratat e qirasë, të administruara si provë, palët kanë rënë dakord që detyrimi ligjor për të paguar tatimin mbi të ardhurat mbi shumën e çmimit mujor të qirasë, do të jetë në ngarkim të palës qiramarrëse. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer ndonjë shkelje ndër vite nga përfitimi i të ardhurave respektive nga qiraja, për t'u vlerësuar se ka shmangie të detyrimeve fiskale.<sup>121</sup> Mospagimi i detyrimeve fiskale mund të konsiderohet shkelje e etikës së magjistratit apo si shkelje administrative sipas parashikimeve respektive ligjore, por jo si shkak për të aplikuar masa disiplinore, sipas nenit D të Kushtetutës, arsyeton Komisioni.<sup>122</sup>
67. Subjekti i rivlerësimit parashtroi se të gjitha kontratat e qirasë përcaktojnë qartë çmimin mujor të përdorimit të sendit dhe se secila nga kontratat, sikurse në çdo veprim parapërgatitor ndërmjet palëve të ardhshme kontraktore, ka të përcaktuar se detyrimet tatimore do të shlyhen në burimin e krijimit të të ardhurave, sikurse edhe ligji dhe aktet nënligjore parashikon, që nënkupton se

<sup>120</sup> Shih faqen 25 të vendimit.

<sup>121</sup> Shih faqen 26 të vendimit të Komisionit.

<sup>122</sup> Shih faqen 27 të vendimit të Komisionit.

qiramarrësi në momentin e shlyerjes së detyrimit mujor paguan pjesën e të ardhurave neto të qirasë, kurse pjesa tjetër e çmimit të përcaktuar në kontratë duhet të shërbente për shlyerjen e detyrimit tatimor.<sup>123</sup> Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa dokumente për të provuar kryerjen e pagesës së qirasë dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore<sup>124</sup>.

68. Trupi gjykues i Kolegjit, referuar periudhës së trajtuar nga Komisioneri Publik në këtë shkak ankimi, konkretisht viteve 2001-2007, vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat e pasurisë si burim krijimi të pasurisë të paluajtshme të ndodhur në Durrës dhe të likuiditeteve) të ardhura nga qiraja (me përjashtim të deklaratës së vitit 2004, në të cilën nuk është deklaruar e ardhur nga qiraja) nga kontratat me qiramarrës subjekte si “{\*\*\*}”<sup>125</sup>, “{\*\*\*}”<sup>126</sup> dhe {\*\*\*}<sup>127</sup>. Trupi gjykues i Kolegjit duke analizuar dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe provat e paraqitura nga subjekti gjatë gjykimit në Kolegj vëren se:

(i) për periudhat 1997-1999 dhe janar 1999 - tetor 2001 vlerësimi mbi të ardhurat nga qiraja me “{\*\*\*}” është i njëjtë, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka titull pronësie mbi hapësirën e dhënë me qira, nuk rezulton të jetë palë në kontratën e qirasë (znj. M.H paraqitet si pronare e vetme ligjore) dhe nuk rezulton t’i ketë dhënë autorizim përfaqësimi znj. M.H për të lidhur kontrata qiraje në emër të tij dhe të bashkëshortes së tij, nuk rezulton e provuar me dokumentacion bankar ose dokumentacion të rregullt ligjor marrja reale e pjesës takuese të qirasë prej tij dhe bashkëshortes së tij, si dhe nuk u vërtetua shlyerja e detyrimit tatimor për t’i konsideruar këto të ardhura të ligjshme, siç është shtjelluar në paragrafët 54, 55 dhe 56 të këtij vendimi;

<sup>123</sup> Shih faqen 20 të apelit kundërshtues.

<sup>124</sup> U administrua: (i) deklarata nr. prot. {\*\*\*}, datë 17.06.2019, e Administratorit të Përgjithshëm të “{\*\*\*}”, sipas së cilës kjo shoqëri ka llogaritur dhe derdhur në favor të Drejtorisë Rajonale Tatimore VIP tatim në burim (bashkëlidhur pagesat e kryera me transferta bankare): viti 2005 - për shumën 4.800 USD, paguar si qira për znj. N.Z. është llogaritur dhe mbajtur tatimi në burim në vlerën 533 USD (49.730 lekë), në datat: 07.01.2005; 01.06.2005; 15.07.2005; 01.11.2005 dhe 13.12.2005. Nga administratori në deklaratë është dhënë sqarimi se tatimi në burim është derdhur edhe për qira të tjera të likuiduara nga shoqëria dhe prandaj totali ka vlerë më të lartë; viti 2006 - për shumën 2160 euro, paguar si qira për znj. N.Z., është llogaritur dhe mbajtur tatimi në burim në vlerën 240 euro (29.664 lekë), në datën 12.06.2006; (ii) deklarata nr. prot. {\*\*\*}, datë 08.07.2019, e administratorit, z. S.V, të shoqërisë “{\*\*\*}” për pagesën e qirasë dhe tatimit për vitin 2007, për shumën 270.000 lekë qira për znj. N.Z. dhe tatim 30.000 lekë të mbajtur në burim, të shoqëruar me 2 njoftime debit datë 23.07.2007 dhe 19.11.2007 për pagesën e tatimit.

<sup>125</sup> Me “{\*\*\*}” përgjatë periudhës 1 shtator 2002 - 30 qershor 2006, znj. M.H ka lidhur 4 kontrata për marrje ambienti me qira për zyra të hapësirës 250 m<sup>2</sup> (në kontrata nuk specifikohet kati apo ambienti i dhënë me qira, por sipas deklarimeve të subjektit kjo hapësirë i përket njësisë bibliotekë), sipas periudhave: 1 shtator 2002 – 31 gusht 2003; 1 shtator 2003 – 31 dhjetor 2004; 1 janar 2005 – 31.12.2005; dhe 1 janar 2006 – 30 qershor 2006. Vlera e qirasë të kontratat që u përkasin periudhave 1997 – 2005 është 3200 USD në muaj, ndërsa për kontratën për periudhën 2006 është 3200 euro. Në kontratën për periudhën 1 janar 2005 - 31 dhjetor 2005 parashikohet se pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja është detyrim i qiradhënësit, ndërsa për periudhën 1 janar 2006 – 30 qershor 2006, detyrimi për pagimin e tatimit është i {\*\*\*}.

<sup>126</sup> Për periudhën 2005 – 2006 me shoqërinë “{\*\*\*}” janë lidhur 2 kontrata qiraje: njëra për periudhën 1 janar 2005 – 31 dhjetor 2005 me qiradhënësit Xhezair Zaganjori, N.Z., A.M dhe K.M., për dhënien me qira të sipërfaqes 131 m<sup>2</sup> bodrum dhe 19 m<sup>2</sup> zyrë, me vlerë 800 USD në muaj neto me detyrimin që tatimi do të paguhej nga shoqëria; dhe tjetra 1 janar 2006 – 31 janar 2006, me të njëjtat palë për dhënie me qira të sipërfaqes 65 m<sup>2</sup> bodrum dhe 19 m<sup>2</sup> zyrë. “{\*\*\*}” ka lëshuar dy vërtetime sipas të cilave ka paguar tatim në burim për vitin 2005, 2006 dhe 2007 për pagesën e qirasë në emër të znj. N.Z. për ambientet bodrum dhe apartament/zyra.

<sup>127</sup> Rezulton e nënshkruar vetëm një kontratë më datë 23.5.2007, firmosur ndërmjet qiradhënësit A.M, (cituar “pronar i ligjshëm”) dhe qiramarrës {\*\*\*} Shqipëri, përfaqësuar nga E.H, për dhënien me qira të një sipërfaqeje 100 m<sup>2</sup>, me afat 3-mujor, për çmimin 550 euro/muaj.

(ii) për periudhën tetor 2001 - shkurt 2003, vlen e njëjta qasje me dy periudhat e sipërcituara në pikën (i), me ndryshimin se për këtë periudhë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij janë pronarë të ligjshëm të ¼ pjesë të njërive të përbashkëta të shërbimit, të ndodhura në katin e parë të godinës (bibliotekë dhe zyrë);

(iii) për periudhën shkurt 2003 – dhjetor 2005, të ardhurat nga qiraja rrjedhin nga kontrata me “{\*\*\*}”, për të cilën pavarësisht se nga dokumentacioni u provua titulli i pronësisë së subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij (prej tetorit të vitit 2001) mbi njësinë e dhënë me qira, dhe u provua nëpërmjet autorizimit për përfaqësim nga znj. M.H, cilësimi i tyre si dy ndër qiradhënësit për ambientet lëshuar “{\*\*\*}”, shlyerja e detyrimit tatimor nga znj. M.H, sikurse ajo ka deklaruar për të gjithë të ardhurën e përfituar dhe sikurse është përcaktuar në nenin 3/1 të kontratës së qirasë për periudhën 1 janar 2005 - 31 dhjetor 2005 nuk u provua;

(iv) për periudhën 1 janar 2005 –31 dhjetor 2006, të ardhurat rrjedhin nga qiraja me shoqërinë “{\*\*\*}”. Për të vërtetuar pagesën e tatimit për këto të ardhura, gjatë gjykimit në Kolegj subjekti paraqiti mandate bankare mbi derdhjet e kryera nga shoqëria në fjalë pranë bankës “Intesa Sanpaolo” dhe vërtetim nga shoqëria mbi derdhjet e tatimit, me sqarimin se në këto pagesa është përfshirë tatimi në burim edhe për qira të tjera të likuiduara nga shoqëria. Mandatpagesat e datave 31.01.2006 dhe 29.12.2006 nuk konfirmojnë pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja që u referohet dy kontratave të sipërcituara, ku qiradhënësi është edhe subjekti. Këto mandate mbajnë shënimin e thjeshtë “tatim mbi qira/tatim në burim”, pa identifikuar cilës kontratë qiramarrjeje të shoqërisë “{\*\*\*}” i referohen këto pagesa. Nga ana tjetër rezulton se kjo shoqëri figuron qiramarrëse në më shumë se një kontratë – sipas vërtetimit nga “{\*\*\*}”<sup>128</sup> – që nënkupton edhe qiradhënësi të tjerë përpos subjektit dhe bashkëshortes. Në dritë të sa më sipër, subjekti nuk provoi se tatimet e paguara nga “{\*\*\*}”, me gjithë vlerën e tyre provuese për tatime të paguara nga kjo shoqëri në periudhën kohore në fjalë, duke mos identifikuar pronën për të cilën është kryer tatimi, nuk paraqesin vlerë provuese për të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit;

(v) për periudhën 2007, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë kontratë qiraje të nënshkruar me “{\*\*\*}” për këtë vit, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe gjatë gjykimit në Kolegj. Nga dokumentacioni në fashikull, rezulton se të gjitha kontratat mes kësaj shoqërie dhe subjektit e bashkëshortes, me përjashtim të kësaj periudhe kohore, janë kryer me shkrim, megjithëse në kufirin kohor njëvjeçar, mbi të cilin ligji detyron formën shkresore.<sup>129</sup> Subjekti dorëzoi një vërtetim nga kjo shoqëri mbi pagesën e kryer për qira dhe tatim mbi qiranë për znj. N.Z., në shumën 270.000 lekë, të shoqëruar me mandatpagesat bankare të datave 23.07.2007 dhe 19.11.2007 gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, në seancën gjyqësore të datës 10.07.2019. Këto dokumente, pavarësisht vlerës provuese e cila u pranua nga trupi gjykues, në kushtet kur hapësira e dhënë me qira është në bashkëpronësi, nuk provojnë cilat janë palët kontraktore dhe për cilën kontratë bëhet fjalë dhe për cilën shumë të ardhurash. Për këtë arsye, trupi gjykues nuk i dha vlerë provuese.

(vi) për vitin 2007, subjekti deklaroi të ardhurat nga kontrata e qirasë me Qendrën {\*\*\*}. Referuar të dhënave të kësaj kontrate të administruar nga Komisioni, konstatohet se qiradhënësi ka arkëtuar shumat e qirasë sipas mandatpagesave dhe rezulton që detyrimet tatimore të jenë paguar rregullisht. Ndërkohë që subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj nuk paraqiti asnjë

<sup>128</sup> Shih poshtëshënimin 126 më sipër.

<sup>129</sup> Shih nenin 803 të Kodit Civil, paragrafi i katërt: “Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë.”

dokumentacion provues ligjor që qiradhënësi<sup>130</sup> që figuron në kontratën e qirasë ka vepruar si person i autorizuar prej tij dhe prej bashkëshortes për të dhënë ¼ e pjesës takuese me qira apo që pjesa takuese e qirasë të jetë transferuar në llogari të tij ose të bashkëshortes së tij.

69. Në konkluzion të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të vërtetojë bindshëm përmbushjen e detyrimeve tatimore me qëllim konsiderimin e të ardhurave nga kontratat e qirasë me “{\*\*\*}”, “{\*\*\*}” ShPK dhe Qendra {\*\*\*} të ligjshme, gjë që ndikon në mungesën e burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë, apartament, me sipërfaqe 81 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Durrës, shtimit të gjendjeve të llogarive bankare dhe mbulimit të shpenzimeve ndër vite, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D, pikave 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ka kryer deklarim të pasaktë sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

*B/4 Shkakui i ankimit për shpenzimet dhe kostot e shkollimit dhe jetesës së personave të lidhur, fëmijëve R.Z. dhe M.Z.*

70. *Lidhur me shpenzimet dhe kostot e shkollimit dhe jetesës së personave të lidhur, fëmijëve R.Z. dhe M.Z., Komisioneri Publik vlerëson se, referuar nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, dhe ka mungesë të burimeve dhe të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e shkollimit dhe të jetesës të fëmijëve të tij.*
71. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje ndërmjet deklaratave periodike të viteve 2009, 2010 dhe 2011, me deklaratën e pasurisë së dorëzuar nga subjekti për efekt të procesit të rivlerësimit (*vetting*), për sa u përket shpenzimeve të shkollimit të djalit R.Z., por “të gjitha këto shpenzime janë përfshirë në deklaratën e pasurisë së dorëzuar për procesin e rivlerësimit”.<sup>131</sup> Për rrjedhojë, Komisioni arrin në përfundimin që subjekti i rivlerësimit nuk ka fshehur pasuri “në deklaratën objekt kushtetues shqyrtimi.”<sup>132</sup> Ndërsa për shkollimin e djalit tjetër, M.Z., Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë të gjitha shpenzimet e kryera për shkollimin e djalit, por ndërkohë ka dorëzuar historikun e llogarisë dhe të transfertave nga banka “Raiffeisen” ShA, me të cilën provon çdo shumë të shpenzuar për studimet e djalit, e nxjerrë në fundin e vitit 2017, duke provuar vërtetësinë, saktësinë dhe burimin e ligjshëm të shpenzimeve të kryera për studimin e djalit.<sup>133</sup>
72. Subjekti i rivlerësimit në apelin kundërshtues<sup>134</sup> dhe në parashtrimet e tij përpara Kolegjit gjatë gjykimit<sup>135</sup>, pretendoi se ka vënë në dispozicion të gjitha transaksionet bankare për të mundësuar verifikimin dhe llogaritjen e çdo shume të dërguar fëmijëve. Pasaktësitë e shpenzimeve vijnë si rezultat i mungesës së një metodologjie në raportimin që kërkohet për këto raste. Faturat e shkollimit të djalit R.Z., që u përkasin 10 viteve më parë, është e vështirë të sigurohen, ndërkohë që për djalin M.Z., krahas pagesave bankare, ka paraqitur edhe shpenzimet e tjera të shkollimit

<sup>130</sup> Shih poshtëshënimin 127 më sipër.

<sup>131</sup> Shih faqen 28 të vendimit.

<sup>132</sup> Shih faqen 28 të vendimit.

<sup>133</sup> Shih faqen 35 të vendimit.

<sup>134</sup> Shih faqet 21-23 të apelit kundërshtues.

<sup>135</sup> Shih parashtrimet me shkrim të depozituara në seancën e datës 10.07.2019.

dhe të jetesës. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa akte në cilësinë e provave për të vërtetuar shpenzimet e shkollimit dhe të jetesës së djalit të tij M.Z.<sup>136</sup>.

73. Trupi gjykues i Kolegjit, nga shqyrtimi i deklaratave ndër vite, përgjigjeve të dhëna në pyetësorët e Komisionit (datë 15.12.2017 dhe 14.02.2018) dhe nga lëvizjet e llogarive bankare të verifikuara nga Njësia e Shërbimit Ligjor, lidhur me shkollimin e dy fëmijëve të subjektit të rivlerësimit vëren se:
- a) për djalin R.Z., të shkolluar në Angli, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
    - i) në deklaratën periodike vjetore 2008, pagesë në shumën 9400 paund; në përgjigjet e pyetësorit të datës 14.02.2018<sup>137</sup>, ka deklaruar vlerën 11000 paund për vitet 2008-2009, ndërsa nga lëvizjet e llogarive bankare për vitin 2008 rezulton pagesa 6679 paund;
    - ii) në deklaratën periodike vjetore 2009, pagesë në shumën 12000 paund, shumë që konfirmohet nga lëvizjet e llogarive bankare për vitin 2009 (me diferencë të papërfillshme, prej 0,29 paund);
    - iii) në deklaratën periodike vjetore 2010, pagesë në shumën 12500 paund, në përgjigjet e pyetësorit 14.02.2018, ka deklaruar shumën 17386 paund – vlerë që rezulton edhe nga lëvizjet e llogarive bankare për vitin 2010;
    - iii) në deklaratën periodike 2011, pagesë në shumën 13200 paund, shumë që e rikonfirmon në pyetësorin e datës 15.12.2017<sup>138</sup>, ndërsa në përgjigjet e pyetësorit të datës 14.02.2018, deklaroi shumën 20565 paund – vlerë që rezulton edhe nga lëvizjet e llogarive bankare për vitin 2011;
    - iv) në deklaratën periodike 2012, pagesë në shumën 17500 paund, shumë që e rikonfirmon në pyetësorin e datës 15.12.2017, ndërsa në përgjigjet e pyetësorit të datës 14.02.2018, deklaroi shumën 17338 paund. Nga lëvizjet e llogarive bankare për vitin 2012, rezultoi pagesa prej 17465 paund;
    - iv) në deklaratën periodike të vitit 2013, pagesë në shumën 7500 paund, shumë që e rikonfirmon në pyetësorin e datës 15.12.2017 dhe pyetësorin e datës 14.02.2018, ndërsa nga lëvizjet e llogarive bankare për vitin 2013 rezultoi pagesa 8677 paund;
  - b) për djalin M.Z., të shkolluar në Gjermani, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
    - i) në vitin 2012 nuk ka deklarime nga ana e subjektit, ndërkohë që rezultoi lëvizje në llogari bankare në vlerën 2296 euro;
    - ii) në deklaratën periodike 2013, pagesë në shumën 9000 euro; në përgjigjet e pyetësorit të datës 15.12.2017 deklaroi 2400 euro, në përgjigjet e pyetësorit të datës 14.02.2018 deklaroi 9000 euro, ndërsa nga lëvizjet e llogarisë bankare rezultoi pagesa 5837 euro;
    - iii) në deklaratën periodike 2014, pagesë në shumën 9000 euro; në përgjigjet e pyetësorit të datës 15.12.2017 deklaroi pagesën shumën 9850 euro, në përgjigjet e pyetësorit të datës 14.02.2018 deklaroi shumën 9000 euro, ndërsa nga lëvizjet e llogarisë bankare rezultoi pagesa 12024 euro<sup>139</sup>;

---

<sup>136</sup> (i) Konfirmim nga Ndërmarrja {\*\*\*}, datë 11.02.2019, sipas të cilit z. M.Z. ka jetuar në ambientet studentore dhe kontrata për këtë dhomë ka qenë 01.10.2014 – 30.09.2017, paguar në total 11.121 euro; (ii) certifikatë lidhur me detyrimet e qirasë<sup>136</sup>, nga C.W, {\*\*\*}, sipas së cilës z. M.Z. nga viti 01.11.2017 e në vazhdim është qiramarrës në {\*\*\*} dhe shuma totale mujore që ai paguan është 710 euro; (iii) konfirmim i pagesave të “fees” së shërbimit studentor në Universitetin {\*\*\*}, datë 07.02.2019, sipas së cilës M.Z. ka bërë pagesa në total për periudhën 2013-2019, në total 131070 euro; (iv) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 03.07.2018, të bankës “Raiffeisen”, sipas së cilës konfirmohet se për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesa me jasthtë: datë 22.01.2014, shuma 2970 për M.Z. (qira) dhe në datë 26.09.2014 shuma 9000 euro për M.Z. (pagesë për studime).

<sup>137</sup> Pyetësori i datës 14.02.2018.

<sup>138</sup> Shih germën A, pikën 7 të përgjigjeve të kthyer në datën 25.12.2017, të pyetësorit të datës 15.12.2017.

<sup>139</sup> Shih fashikullin nr. 3, përgjigjen dërguar nga banka “Raiffeisen” te Komisioni.

iv) në deklaratën periodike 2015, pagesë në shumën 9000 euro; në përgjigjet e pyetësorit të datës 15.12.2017 deklararon pagesën shumën 9850 euro, në përgjigjet e pyetësorit të datës 14.02.2018 deklararon shumën 10500 euro, ndërsa nga lëvizjet e llogarisë bankare rezulton pagesa 7226 euro; v) në deklaratën periodike 2016, pagesë në shumën 13700 euro; në përgjigjet e pyetësorit të datës 15.12.2017 deklararon pagesën shumën 9850 euro, në përgjigjet e pyetësorit të datës 14.02.2018 deklararon shumën 13700 euro, ndërsa nga lëvizjet e llogarisë bankare rezulton pagesa 13755 euro.

74. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk është i saktë në deklarimin e shpenzimeve të shkollimit për të dy fëmijët, pasaktësi të evidentuara në disa deklarata pasurive vjetore dhe që kanë marzhe të konsiderueshme diference, sikurse rezulton të jetë vlera 1.700 paund në vitin 2008; vlera 4886 paund në vitin 2010; vlera 7365 paund në vitin 20011 dhe vlera 2977 euro në vitin 2014. Trupi gjykues vëren edhe se referuar legjislacionit në fuqi për deklarimin e pasurive<sup>140</sup>, shpenzimet e kryera përtej vlerës 300.000 lekë për të birin, M.Z., në kuadrin e shpenzimeve të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton t'i ketë deklaruar.
75. Nga dokumentacioni i paraqitur gjatë gjykimit në Kolegji, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte/dokumente provuese për të vërtetuar shpenzimet e shkollimit dhe të jetesës së djalit të tij, z. R.Z., gjatë periudhës së shkollimit në vitet 2008-2013 në Britaninë e Madhe. Përkundër pretendimit të subjektit të rivlerësimit për vështirësinë e sigurimit të faturave për shkak të kohës së gjatë (rreth 10 vite), trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë akt apo provë që të vërtetonte përpjekjet e tij për të siguruar këto të dokumente, apo të vërtetonte se këto dokumente janë zhdukur, kanë humbur, nuk mund të bëhen përsëri apo nuk mund të merren në rrugë tjetër, duke çuar në pamundësinë objektive të subjektit, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016<sup>141</sup>.
76. Ndërsa lidhur me dokumentacionin mbi shpenzimet e shkollimit dhe të jetesës të djalit M.Z. në Gjermani, të paraqitur në gjykim në seancën e datës 25.06.2019, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky dokumentacion i paraqitur, sikurse ishin: i) konfirmim nga Ndërmarrja {\*\*\*}, datë 11.02.2019, sipas të cilit z. M.Z. ka jetuar në ambientet studentore dhe kontrata për këtë dhomë ka qenë 01.10.2014 – 30.09.2017, paguar në total 11.121 euro; ii) vërtetim lidhur me detyrimet e qirasë, nga C.W, {\*\*\*}, sipas së cilës z. M.Z. nga data 01.11.2017 e në vazhdim është qiramarrës në {\*\*\*} dhe shuma totale mujore që ai paguan është 710 euro dhe konfirmimi i pagesave të *fees* së shërbimit studentor në Universitetin {\*\*\*}, datë 07.02.2019, sipas të cilit M.Z. ka bërë pagesa në total për periudhën 2013- 2019, në total 131070 euro, ndonëse është paraqitur në formën e rregullt ligjore<sup>142</sup>, nuk vërteton plotësisht shpenzimet e jetesës dhe të shkollimit për periudhën

<sup>140</sup> Ligji nr. 85/2012, datë 18.09.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar”, parashikonte në ndryshimet e nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, detyrimin e subjekteve deklaruese të deklarojnë në ILDKPKI brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të çdo shpenzimi me vlerë mbi 500.000 (pesëqind mijë) lekë, të kryer gjatë vitit të deklarimit. Në vitin 2014, me ligjin nr. 45/2014, datë 24.04.2014, u përcaktua detyrimi për të deklaruar shpenzimet me vlerë mbi 300.000 (treqind mijë) lekë, të kryera gjatë vitit të deklarimit.

<sup>141</sup> Neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor [...]”.

<sup>142</sup> Dokumentacioni rezulton i shoqëruar me vulë apostile, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

2014 e në vijim për të justifikuar shpenzimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit. Në vlerësim të përmbajtjes së këtyre dokumenteve, trupi gjykues vëren se ato i referohen pagesës semestrale të shkollës dhe qirasë mujore. Dokumentacioni i sjellë nuk provon shpenzimet e ushqimit, shpenzimet për libra, transport dhe pagesa të tjera që nevojiten për jetesën e një studenti<sup>143</sup>.

77. Trupi gjykues i Kolegjit, referuar analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, konstatoi se për periudhën 2008 deri në 2016, periudhë në të cilën përfshihen në veçanti vitet 2011, 2012 dhe 2014, të ngritura në ankim nga Komisioneri Publik, që përkon me shpenzimet e kryera për shkollimin e fëmijëve në Britaninë e Madhe dhe Gjermani, subjekti i rivlerësimit gjendet në pamjaftueshmëri financiare në vlerën 2932.554,52 lekë për të mbuluar me të ardhura të ligjshme kursimet dhe shpenzimet e deklaruara për këtë periudhë.
78. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të pambështetur në kuadrin kushtetues dhe ligjor të procesit të rivlerësimit, arsyetimin e Komisionit se *juridiksioni kushtetues dhe ligjor i saj kushtëzohet dhe mjaftohet me kontrollin e deklaratës vetting të subjektit të deklarimit. Nga kontrolli i saj, rezulton se subjekti i deklarimit ka pasqyruar me detaje çdo të ardhur të shpenzuar gjatë viteve 2008-2013 për studimet e djalit, R. Z., në Angli. Kjo do të thotë se subjekti i rivlerësimit nuk ka fshehur apo ka deklaruar çdo të ardhur të detyrueshme nga ligji për t'u deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting*<sup>144</sup>, sepse sikurse është argumentuar edhe në paragrafin 22.14 të këtij vendimi, kontrolli dhe krahasimi i deklarimeve të mëparshme me deklaratën e pasurisë, gjatë vlerësimit të pasurisë, është i domosdoshëm, pasi shërben për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi mjaftueshmërinë e deklarimeve të tij apo ligjshmërinë e të ardhurave të tij në vite.
79. Në konkluzion të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarimin e shpenzimeve të kryera për shkollimin e fëmijëve në Britaninë e Madhe dhe në Gjermani, nuk vërtetoi me dokumentacion të plotë ligjor shpenzimet e jetesës dhe të shkollimit të tyre dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Një detajim i analizës shtjellohet më poshtë, në paragrafin 83.

*B/4 Shkaku i ankimit për mosmbulimin me të ardhura të ligjshme të shpenzimeve dhe kursimeve vjetore për vitet 2011, 2012 dhe 2014*

80. *Lidhur me mbulimin me të ardhura të ligjshme të shpenzimeve dhe kursimeve për vitet 2011, 2012 dhe 2014, Komisioneri Publik vlerëson se referuar nenit D, pikave 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet për vitin 2011 në masën 189647,22 lekë, për vitin 2012 në masën 1.372.389,92 lekë dhe për vitin 2014 në masën 538.979,67 lekë për një total diference negative për këto vite, prej 2.101.016 lekësh.*

---

<sup>143</sup> Meqenëse burimet zyrtare të statistikave të Gjermanisë, përfshirë Eurostat, nuk përmbajnë studentët si kategori më vete, për analizë u përdor niveli i shpenzimeve kryesore për konsum të kategorisë së konsumatorit nën 30 vjeç dhe shpenzimet kryesore për konsum të kategorisë së konsumatorit person i papunë. Këto statistika tregojnë se shpenzimet për këto dy kategori janë më të larta se niveli i shpenzimeve prej rreth 9.000 eurosh në vit, i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>144</sup> Shih faqen 30 të vendimit.

81. Komisioni argumenton se nga shqyrtimi i të ardhurave të subjektit të rivlerësimit ndër vite, rezultoi se të ardhurat e bashkësisë ligjore çdo vit, nga burime të ndryshme dhe të marra si shumatore e përgjithshme, rezultojnë ndjeshëm më të mëdha sesa shpenzimet dhe se në këtë mënyrë, në çdo vit, bashkësia ligjore ka pasur bilanc pozitiv, çka justifikon vlerat e kursyera në llogari bankare ndër vite apo me të cilat janë kryer transaksionet për pasuri të paluajtshme apo shkollimin e fëmijëve. Ky konkluzion del nga aritmetika e të hyrave dhe shpenzimeve të deklaruara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit dhe nga deklaratimet e çdo të ardhure të fituar ndër vite nga puna e ligjshme apo nga marrëdhëniet kontraktore të ligjshme.<sup>145</sup>
82. Në apelin kundërshtues, subjekti i rivlerësimit parashtron se shifrat e tabelës në ankim janë hipotetike, të pasakta dhe shumë të fryra, veçanërisht lidhur me përdorimin në këto 3 vite të kartës së kreditit, si dhe të shpenzimeve jashtë shtetit, duke qenë se kjo kartë është përdorur edhe nga institucioni për arsye pune. Subjekti kërkoi ballafaqimin me gjetjet dhe përlllogaritjet konkrete të tabelës me qëllim argumentimin dhe paraqitjen në cilësinë e provës të vërtetën për çdo shpenzim dhe të ardhur. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa dokumente në cilësinë e provës për të vërtetuar se të ardhurat familjare janë më të larta se shpenzimet dhe se një pjesë e shpenzimeve i përkasin kartës së kreditit të përdorur për qëllime pune, përfshirë edhe mbulimin e shpenzimeve të punonjësve të Gjykatës së Lartë<sup>146</sup>. Ndërkohë që në seancat e datave 25.06.2019 dhe 10.07.2019, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se ka deklaruar në çdo kohë që mban gjendje *cash* rreth 900.000 lekë, për të mbuluar shpenzimet familjare urgjente.
83. Trupi gjykues, referuar analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, konstatoi se për vitet 2011, 2012 dhe 2014, subjekti i rivlerësimit kishte mundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet në vitin 2011, me vlerën 455.199 lekë. Për sa u përket viteve 2012 dhe 2014, mungon aftësia financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara në vlerën 2.932.554,52 lekë. Analiza financiare e kryer në Kolegj u mbështet në të ardhurat nga punësimi i subjektit të rivlerësimit dhe i dy personave të lidhur me të, bashkëshortes dhe djalit R.Z.<sup>147</sup> dhe nga të ardhurat e ligjshme të qirasë, sipas të dhënave nga institucionet financiare<sup>148</sup>. Në analizën financiare u konsideruan shpenzimet dhe

---

<sup>145</sup> Shih faqen 23 të vendimit.

<sup>146</sup> (i) Vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 20.11.2018, nga Fakulteti i Drejtësisë se subjekti i rivlerësimit ka qenë punonjës mësimor joefektiv dhe të ardhurat për vitet 2009-2016 janë në total 9.980.529 lekë (bruto) dhe 8.534.733 lekë (neto); (ii) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 22.10.2018, nga banka "Raiffeisen", sipas të cilit Gjykata e Lartë ka vetëm llogari buxhetore dhe jo llogari rrjedhëse dhe, për rrjedhojë, nuk mund të pajiset me kartë krediti për institucionin; (iii) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 23.10.2018, i Gjykatës së Lartë, sipas të cilit ky institucion nuk ka disponuar kartë krediti dhe pagesat janë kryer nga karta e kreditit të subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, Gjykata e Lartë ka bërë rimbursimin; (iv) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 28.02.2019, i Gjykatës së Lartë (4 vërtetime), sipas të cilit subjekti i rivlerësimit është rimbursuar në vlerën 1094,55 euro; 1739 euro; 129,98 euro; 1595,03 euro dhe 649 euro; (v) vërtetim nga H.S.S, datë 27.02.2019, sipas të cilit për vizitën studimore të kryer në GjEDNJ në periudhën 02.06.2014 - 06.06.2014 është paguar shuma 480 euro dhe për vizitën studimore në periudhën 28.11.2010 - 02.12.2010 për vizitën studimore në GjNDD është paguar shuma 880,23 euro.

<sup>147</sup> Vërtetimet e punësimit nga institucionet publike dhe jopublike, nga organizatat vendase dhe të huaja, nga aktivitetet private të ushtruara për të cilat deklarohet dhe vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara.

<sup>148</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 20.07.2017, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, drejtuar ILDKPKI-së.



kursimet e deklaruara nga subjekti rivlerësimit dhe dy personat e lidhur me të, si dhe likuiditetet që rezultojnë nga llogaritë bankare, sipas vërtetimeve të administruara nga Komisioni. Nga ana tjetër, pas dokumentacionit provues të sjellë nga subjekti i rivlerësimit lidhur me shpenzimet e Gjykatës së Lartë, të cilat për arsye praktike janë kryer nëpërmjet kartës së kreditit të subjektit të rivlerësimit, nuk u përfshinë në analizën financiare si shpenzime personale të subjektit ose të personave të lidhur me të, në total prej 5.207,56 eurosh (konvertuar në 729.235 lekë).<sup>149</sup>

84. Lidhur me deklarimin gjatë gjykimit mbi mbajtjen e shumës prej 900.000 lekësh si *cash* në shtëpi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në *cash* në vlerat 300.000 lekë dhe 600.000 lekë, respektivisht në deklaratat periodike vjetore të vitit 2003 dhe në atë të vitit 2004. Në vijim, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar ndryshime, shtime apo pakësime të gjendjes *cash*. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të theksojë se si subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së prej vitit 2003, mbështetur në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte çdo ndryshim të mundshëm të gjendjes së kursimeve *cash*, nëse kjo kishte ndodhur në vitin respektiv. Në formularin e deklaratës së pasurisë, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, kërkohet nga deklaruesit: *Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) në: [...] të çdo lloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.*

Kjo rubrikë e deklaratës detajon detyrimin për zbatim të nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, që parashikon: *[...] Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...].*

85. Nga aktet në fashikull, e më konkretisht deklaratat periodike vjetore 2003-2016 dhe nga ajo *vetting* rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar që nga viti 2005<sup>150</sup> shitesa dhe pakësime të kësaj shume në banesë në zbatim të detyrimeve të parashikuara më sipër, që nënkupton ose që shuma në fjalë nuk është përdorur ose shitesat dhe pakësimet e saj nuk janë deklaruar sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe ligjit nr. 84/2016 – gjurmë të kësaj shume nuk gjenden as në deklaratën *vetting*. Për këto arsye, në konkluzion të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk është bindës dhe, për pasojë, nuk mund të merret në konsideratë. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të

<sup>149</sup> Shih poshtëshënimin 146 më sipër për shkresat që vërtetuan shpenzimet zyrtare të institucionit nëpërmjet kartës së kreditit të subjektit të rivlerësimit.

<sup>150</sup> Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2003, të dorëzuar më 29.03.2004, gjendje *cash* 0,3 milionë lekë (burimi: të ardhura personale), ndërsa në deklaratën e pasurisë për vitin 2004, të dorëzuar në vitin 2005 ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 600.000 lekë. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të krijonte këtë gjendje *cash* në fund të vitit 2004, duke marrë në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe lëvizjet e likuiditeteve në banka.

burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës.

*C) Mbi denoncimet e publikut të depozituara në Kolegj ndaj subjektit të rivlerësimit*

86. Pranë Kolegjit, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit kanë ardhur një sërë denoncimesh, si më poshtë:

- Denoncues V.Ç - nr. {\*\*\*}prot., datë 02.05.2018, nr. {\*\*\*} prot., datë 18.03.2019 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 08.07.2019;
- Denoncuese H.K - nr. {\*\*\*} prot., datë 25.07.2018 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 27.06.2019;
- Denoncues S.B - nr. {\*\*\*} prot., datë 26.07.2018;
- Denoncues V.Q - nr. {\*\*\*} prot., datë 02.08.2018 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 04.07.2019;
- Denoncuese E.M - nr. {\*\*\*} prot., datë 15.08.2018, nr. {\*\*\*} prot., datë 11.06.2019, {\*\*\*} prot., datë 19.06.2019, nr. {\*\*\*} prot., datë 04.07.2019 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 09.07.2019;
- Denoncues A.H - nr. {\*\*\*} prot., datë 11.09.2018;
- Denoncues M.G - nr. {\*\*\*} prot., datë 23.10.2018;
- Denoncues S.M(H) - nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2018, nr. {\*\*\*} prot., datë 07.11.2018 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 15.07.2019;
- Denoncues R.H.Rr - nr. {\*\*\*} prot., datë 15.11.2018;
- Denoncues Shoqata {\*\*\*} (Kryetar - av. N.P) - nr. {\*\*\*}, datë 22.11.2018;
- Denoncues Av. F.Gj, përfaqësues i S.H dhe Gj.K - nr. {\*\*\*}, datë 17.12.2018;
- Denoncues Av. F.Gj - nr. {\*\*\*} prot., datë 21.01.2019;
- Denoncues z. F.L - nr. {\*\*\*} prot., datë 23.01.2019;
- Denoncues Gj.F - nr. {\*\*\*} prot., datë 22.02.2019 dhe nr. {\*\*\*}, datë 25.02.2019;
- Denoncues H.G - nr. {\*\*\*}, datë 25.02.2019, nr. {\*\*\*} prot., datë 05.04.2019 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 22.07.2019;
- Denoncues S.M - {\*\*\*} prot., datë 05.03.2019;
- Denoncues Av. D.H - nr. {\*\*\*} prot., datë 15.03.2019;
- Denoncues L.Ç - nr. {\*\*\*}, datë 18.03.2019 (përcjellë nga KPK me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.03.2019);
- Denoncues S.H - nr. {\*\*\*} prot., datë 26.12.2018 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 27.03.2019;
- Denoncues A.B - nr. {\*\*\*} prot., datë 03.04.2019;
- Denoncues K.M - nr. {\*\*\*} prot., datë 03.04.2019;
- Denoncues Av. F.Ç - nr. {\*\*\*} prot., datë 30.04.2019 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 30.04.2019;
- Denoncues A.Z - nr. {\*\*\*} prot., datë 08.05.2019;
- Denoncues V.Z - nr. {\*\*\*} prot., datë 16.05.2019;
- Denoncues “B.S” - nr. {\*\*\*} prot., datë 21.05.2019;
- Denoncues R.Ll - nr. {\*\*\*} prot., datë 17.06.2019;
- Denoncues H.Th – nr. {\*\*\*} prot., datë 17.06.2019;
- Denoncues Z.H – nr. {\*\*\*} prot., datë 09.07.2019;

° Denoncues H.R – nr. {\*\*\*} prot., datë 16.07.2019.

87. Trupi gjykues i Kolegjit, nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre denoncimeve, konstatoi se përgjithësisht ato lidheshin me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe nuk përmbanin fakte apo rrethana të cilat mund të përbënin provë në këtë proces gjyqësor, në përputhje me nenin 53, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, këto denoncime nuk iu nënshtruan hetimit gjyqësor.
88. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, të neneve 33, pika 5, germat “a” dhe “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2014, vlerëson se vendimi nr. 46, datë 24.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duhet ndryshuar për sa vijon:
1. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mbulimin me të ardhura të ligjshme të krijimit të 4 (katër) pasurive të paluajtshme të ndodhura në Tiranë dhe shpenzimet e kryera deri në vitin 1999, vit në të cilin pretendon se ka shlyer tërësisht ndaj bashkëpronarëve diferencën e mbetur për vlerën e investimit të ndërtimit të godinës, si dhe është i pasaktë në deklaratimet e tij, në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003 dhe në deklaratën *vetting*, lidhur me sipërfaqet, vlerën dhe burimet e krijimit të 4 (katër) pasurive të paluajtshme të ndodhura në Tiranë. Në këto kushte, subjekti gjendet në situatën e parashikuar nga neni 33 pika 5, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
  2. Subjekti i rivlerësimit është i pasaktë në deklarinimin e burimit të krijimit të pasurisë së paluajtshme “apartament”, të ndodhur në Durrës, pasi nuk arriti të provojë tërheqjen e shumës prej 16000 USD nga llogaria bankare në vitin 2006, periudhë në të cilën deklaroi përdorimin e kësaj shume për blerjen e apartamentit, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vlerën negative prej 458.761 lekësh. Në këto kushte, subjekti gjendet në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
  3. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë dhe nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara nga qiratë për periudhën 1999-2007, duke u gjendur në mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për krijimin e pasurisë së apartamentit, me sipërfaqe 81 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Durrës, shtimit të gjendjeve të llogarive bankare dhe mbulimit të shpenzimeve ndër vite. Në këto kushte, subjekti gjendet në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
  4. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarinimin e shpenzimeve të kryera për shkollimin dhe jetesën e personave të lidhur, fëmijëve R.Z. dhe M.Z. dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar likuiditetet e përdorura për shpenzimet e kryera. Në këto kushte, subjekti gjendet në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
  5. Subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara për vitin 2012 në masën 1.402.445,49 lekë dhe për vitin 2014 në masën 1.530.109 lekë (gjithsej për të dyja vitet në vlerën 2.932.554,52 lekë). Në këto kushte, subjekti gjendet në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

## **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbështetur në faktet e provuara në gjykim dhe në ligjin e zbatueshëm për çështjen, sipas nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016,

### **VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 46, datë 24.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Xhezair Zaganjori, gjyqtar me detyrë kryetar i Gjykatës së Lartë.
2. Ky vendim është përfundimtar, me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot në Tiranë, më datë 26.07.2019.

**GJYQTARE**

**Natasha Mulaj**

*nënshkrimi*

**GJYQTAR**

**Luan Daci**

*nënshkrimi*

**GJYQTAR**

**Sokol Çomo**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Rezarta Schuetz**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana Shtylla**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, anëtare e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) që shqyrtoi ankimin e Komisionerit Publik (në vijim “KP”) ndaj vendimit nr. 46, datë 24.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit Xhezair Zaganjori, dakordësohem me vendimin e trupit gjykues, por po parashtoj një arsyetim paralel, të ndryshëm nga arsyetimi i anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, në këtë vendim.
  2. Arsyetimi i ndryshëm lidhet me:
    - a) argumentet e paraqitura për konkluzionin e trupit gjykues sa u përket “të ardhurave që përjashtohen nga detyrimi tatimor”, në interpretim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, konteksti në të cilin është përdorur referimi në legjislacionin në fuqi, si dhe një paragraf i vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 08.06.2016, për të mbështetur këtë qëndrim (paragrafët 22.13 dhe 37 të vendimit);
    - b) argumentet për mënyrën dhe momentin e fitimit të 4 (katër) pasurive të paluajtshme, të ndodhura në të njëjtin pallat, me cilësimin: “apartament banimi” me sipërfaqe 293 m<sup>2</sup>, “dyqan/bibliotekë” me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, “bodrum” me sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>, “zyrë” me sipërfaqe 15 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, ndërtuar në vitin 1997 (paragrafët 30 dhe 31 të vendimit);
- 2.a.** Lidhur me argumentet që anëtarët e tjerë të trupit gjykues parashtrojnë në nënparagrafët e dytë dhe të tretë të paragrafit 22.13, ritheksimit të tyre në paragrafin 37 të vendimit dhe konkretisht argumenteve të shtjelluara për rëndësinë e vjeljes së detyrimeve tatimore në Shqipëri, garantimin e përmbushjes rigoroze të këtyre detyrimeve nga individët dhe personat fizikë, pasi çdo veprim ose mosveprim i tyre që ka për qëllim shmangien nga këto detyrime ndëshkohet administrativisht dhe penalisht, të sjella këto argumente në mbështetje të konkluzionit: *Trupi gjykues, në vlerësim të këtij parashtrimi të Komisionerit, përkundër parashtrimin të subjektit të rivlerësimit të shtjelluar më sipër në paragrafin 22.3, vëren se vjelja e detyrimeve tatimore në Shqipëri përbën një nga burimet e buxhetit të shtetit edhe sipas ligjit përkatës. Për këtë qëllim, ekziston një kuadër aktesh ligjore dhe nënligjore që synojnë edhe përmbushjen rigoroze të detyrimeve tatimore nga individët dhe personat fizikë. Shmangia e pagesës së detyrimeve tatimore përbën edhe sanksion administrativ, edhe penal, dhe masat përkatëse janë të parashikuara në ligjin nr. 8438/1998 dhe në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 33, datë 08.06.2016, ndër të tjera shprehet: [...] Për më tepër, duke qenë se detyrimet tatimore përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave të buxhetit të shtetit, garantimi i sjelljeve ligjore të tatimpaguesve siguron krahas qëndrueshmërisë ekonomike, edhe mundësinë e zbatimit të politikave sociale efektive. [...]*
- Për këtë arsye, trupi gjykues vëren që parashtrimi i Komisionerit që përjashtimi nga detyrimi për pagimin e tatimit bëhet vetëm me ligj, është i drejtë, pasi bazohet në parimet thelbësore të legjislacionit që rregullon tatimet. Për këtë qëllim, legjislatori ka parashikuar në mënyrë të shprehur dhe shteruese në nenin 9 të ligjit nr. 8438/1998, rastet e të ardhurave të përjashtuara*

*nga pagesa e tatimit. Kuadri ligjor për tatimet nuk lë vend për interpretime mbi mungesa të mundshme rregullimi ligjor, në kontekst të mospagimit të detyrimeve tatimore, në kushtet kur janë parashikuar të ardhurat e tatueshme dhe ato të përjashtueshme, duke parandaluar dhe më tej ndëshkuar çdo veprim apo mosveprim që synon shmangien e tyre, arsyetoj si vijon.*

Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar që në kuadër të procesit të rivlerësimit, për efekt të kontrollit të pasurisë që kanë në pronësi apo në përdorim subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, këta të fundit duhet të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tyre. Gjithashtu, po sipas këtij neni, konsiderohen pasuri e ligjshme të ardhurat të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Përcaktimet kushtetuese kanë gjetur zbërthimin e tyre në nenin 3, pika 19 e nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), të cilat në brendinë e tyre kanë referuar edhe në parashikimet e posaçme të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) (në vijim “ligji nr. 8438/1998”). Sipas këtyre parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, që një e ardhur të konsiderohet e ligjshme për efekt të këtij procesi, ajo duhet të ketë një burim të ligjshëm, të jetë deklaruar në organet tatimore dhe për të të jenë paguar detyrimet tatimore sipas legjislacionit të posaçëm tatimor në fuqi. Sa u përket rasteve kur një e ardhur përjashtohet nga detyrimi tatimor, theksoj se ligji nr. 8438/1998, në nenin 8/1 të tij ka përcaktuar një listë shteruese të të ardhurave që përjashtohen nga detyrimi tatimor, e cila në asnjë rast nuk mund të plotësohet apo dhe të interpretohet përtej parashikimeve të kësaj dispozite dhe përcaktimeve të tjera të këtij ligji, si dhe kuptimit që ajo duhet të marrë në kuadër të procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe Kolegji.

Në vlerësimin tim, parashikimet e sipërcituara të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 84/2016, lidhur me burimin dhe të ardhurat e ligjshme, kanë pasur për qëllim dhënien e një kornize kushtetuese dhe ligjore, brenda së cilës ato duhet të vlerësohen nga organet e rivlerësimit, duke u ndalur ky vlerësim në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, pra vetëm dhe për qëllim të këtij procesi. Mbështetur në këtë kuptim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, arsyetoj se organet e rivlerësimit, nëpërmjet verifikimit dhe vlerësimit që u bëjnë burimeve dhe të ardhurave nëse janë të ligjshme, synojnë që të provojnë në kuadër të këtij procesi ligjshmërinë e pasurisë që ka në pronësi subjekti i rivlerësimit. Në asnjë rast nuk mund të synohet që evidentimi apo konkluzioni i këtij kontrolli se jemi para shmangies së detyrimit tatimor, të çojë në përfundimin që subjekti i rivlerësimit të jetë subjekt i ndëshkimit administrativ apo dhe penal nga organet kompetente, për këtë shmangie.

Në përfundim, bazuar në sa më sipër, arsyetoj se vlerësimet që kryejnë Komisioni dhe Kolegji lidhur me burimet dhe të ardhurat e ligjshme për subjektet e rivlerësimit, nuk mund të shërbejnë për identifikimin dhe, për pasojë, ndëshkimin e individëve që u janë shmangur detyrimeve tatimore sipas legjislacionit tatimor, apo si një mjet institucional (agjent tatimor) për të garantuar sjellje ligjore të subjekteve tatimore e përmirësim të balancave të buxhetit të shtetit, si dhe për të parandaluar shmangiet nga zbatimi i legjislacionit tatimor. Një interpretim i tillë i pikës 3 të nenit

D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe njohja e një kompetence të tillë Komisionit dhe Kolegjit, vlerësoj se është përtej juridiksionit të tyre.

**2.b.** Sa u përket argumenteve të trajtuara nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues për mënyrën dhe momentin e fitimit të 4 (katër) pasurive të paluajtshme, të ndodhura në të njëjtin pallat me cilësimin: “apartament banimi” me sipërfaqe 293 m<sup>2</sup>, “dyqan/bibliotekë” me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, “bodrum” me sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>, “zyrë” me sipërfaqe 15 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, ndërtuar në vitin 1997, arsyetoj si vijon.

**2.b.1.** Lidhur me argumentet e parashtruara nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues në nënparagrafin e dytë të paragrafit 30 si dhe në paragrafin 31 të vendimit, sipas të cilave në këndvështrimin procedural Kolegji nuk mund të konstatojë fakte, përfshirë këtu dhe situatën faktike për mënyrën dhe momentin e fitimit të pronësisë mbi 4 (katër) pasuritë e paluajtshme<sup>151</sup>, pasi kjo i përket juridiksionit civil, arsyetoj se sipas ligjit civil procedural dhe material, në një çështje në të cilën kundërshtohet apo kërkohet të vërtetohet e drejta e fitimit të pronësisë me një nga mënyrat e parashikuara në ligj, apo mbrojtja e interesave të caktuar civilë pasurorë, është gjykata civile ajo që duhet të japë një zgjidhje bazuar në faktet e provuara dhe në ligjin material. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë parashikon disa institute të fitimit të pronësisë në mënyrë origjinale/klasike, ndërmjet të cilave në nenet 173 e vijues, fitimin e pronësisë me bashkim dhe përzjerje. Për këtë arsye, Kolegji duhet të vlerësojë faktet, provat dhe argumentet e parashtruara në ankimin e KP, në apelin kundërshtues të subjektit të rivlerësimit, në parashtruesat dhe konkluzionet përfundimtare të tyre në seancë gjyqësore publike, por ky vlerësim dhe cilësim nuk mund dhe nuk duhet të konsiderohet si ai i gjykatës në një çështje civile, për të njohur të drejtën e pronësisë së subjektit të rivlerësimit dhe interesave pasurorë që rrjedhin prej saj.

Në vijim të sa më sipër, ndryshe nga sa arsyetojnë anëtarët e tjerë të trupit gjykues mendoj se Kolegji për çështjet që ka në gjykim, bazuar në nenin 65 të ligjit nr.84/2016, nenin 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe në nenet 6, 8, 12 dhe 16 të Kodit të Procedurës Civile, vlerëson dhe bën një cilësim të saktë të situatës faktike dhe provave për zgjidhjen e çështjes, bazuar në legjislacionin e procesit të rivlerësimit.

Komisioni dhe Kolegji, gjatë procesit të rivlerësimit dhe vetëm për efekt të këtij procesi, duhet të vlerësojnë fakte dhe prova jo vetëm për çështje të fitimit të pronësisë, por edhe për të vërtetuar nëse ka ekzistuar një marrëdhënie e caktuar kontraktuale apo një veprimtari ekonomike, e cila në kuptim të legjislacionit në fuqi konsiderohet si burim i ligjshëm, si për shembull ekzistencën e një marrëdhënie porosie, një marrëdhënie pune, një veprimtarie profesionale apo tregtare.

Vlerësimi dhe cilësimi i Kolegjit për këtë situatë faktike duhet të bëhet brenda juridiksionit të tij, vetëm në kontekstin e procesit të rivlerësimit dhe gjykoj se është i domosdoshëm në kuadër të

---

<sup>151</sup> “Apartament banimi” me sipërfaqe 293 m<sup>2</sup>, “dyqan/bibliotekë” me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, “bodrum” me sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>, “zyrë” me sipërfaqe 15 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, ndërtuar në vitin 1997.

kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, me qëllim arritjen e bindjes për ligjshmërinë e burimeve dhe të ardhurave për krijimin e saj. Për më tepër, arsyetohet se vlerësimi dhe cilësimi që marrin faktet gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, apo gjykimit në Kolegj, nuk janë të detyrueshme për t'u cilësuar si të tilla nga gjykata civile në një proces civil.

**2.b.2.** Lidhur me argumentet e paraqitura në paragrafët 28 dhe 29 të vendimit, ndryshe nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues, për efekt të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Xhezair Zaganjori, bëj një vlerësim të ndryshëm të situatës faktike për 4 (katër) pasuritë e paluajtshme në të njëjtin pallat, bazuar në provat dhe argumentet e administruara në Komision dhe Kolegj. Gjatë hetimit administrativ dhe shqyrtimit në Komision, por dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit Xhezair Zaganjori ka paraqitur disa akte, nëpërmjet të cilave ka pretenduar të provojë se cila ka qenë situata faktike për mënyrën dhe momentin e fitimit të pronësisë mbi këto 4 (katër) pasuri të paluajtshme.

Në fashikullin e gjykimit janë administruar disa prova<sup>152</sup>, të cilat në këndvështrimin formal janë konsideruar nga trupi gjykues se plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, nëpërmjet të cilave subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të provojë në kuadër të këtij procesi:

- a) situatën faktike të zhvillimit të pronës së kthyer pronarëve<sup>153</sup>, z. H.M. dhe znj. Sh.Z.<sup>154</sup>, një sipërfaqe prej 207 m<sup>2</sup> dhe njohur për kompensim një sipërfaqe prej 385 m<sup>2</sup>; si dhe
- b) momentin kur kjo godinë është bërë funksionale dhe kur ai ka filluar ta posedojë atë.

Referuar deklaramentit për herë të parë të pasurisë në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit Xhezair Zaganjori ka deklaruar të 4 (katër) pasuritë e paluajtshme, duke referuar për secilën prej tyre vlerën e shpenzuar<sup>155</sup> prej tij, në total në shumën 9,1 milionë lekë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në

---

<sup>152</sup> a) Vendimi i Këshillit të Rregullim Territorit Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 13.04.1996, "Për miratimin e lejes së ndërtimit për godinën 5 (pesë) kate me kërkesë të pronarëve"; b) vendimi i Këshillit të Rregullim Territorit Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 4.07.1997, "Për miratimin e rinovimit të lejes dhe shtesës së katit për këtë ndërtim"; c) kontratë sipërmarrjeje e datës 1.08.1996 midis palëve: familjes M-Z, e përfaqësuar nga M.H dhe shoqërisë "{\*\*\*}" ShPK, përfaqësuar nga presidenti i firmës, z. Dh.Gj.; ç) kontratë për furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike, datë 13.12.1997, ndërmjet z. Xhezair Zaganjori dhe Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, Filiali Elektrik Tiranë; d) akt kolaudimi tekniko-ekonomik për godinën 7 (shtatë) kate, me investitor z. H.M dhe znj. Sh.Z., datë 24.08.2000; dh) kërkesë nga familjet M-Z drejtuar Zyrës së Hipotekës Tiranë, më datë 18.10.2000, për hipotekimin e objektit "Godinë 7-katëshe polifunksionale dhe parkim nëntokë"; e) vendim i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) ish-Pronarëve i Bashkisë Tiranë, nr. {\*\*\*}, datë 13.03.2001, nëpërmjet të cilit u është kthyer pronarëve, z. H.M. dhe znj. Sh.Z., pronësia mbi këtë truall (si kompensim me një truall ekuivalent brenda pronës së tyre); ë) kontratë shitblerjeje me nr. {\*\*\*} rep, nr. {\*\*\*} kol, datë 13.01.1999, me palë shitëse subjektin e rivlerësimit dhe prindërit e tij.

<sup>153</sup> Kjo pronë u është kthyer pronarëve me vendim të Komisionit të Kthim Kompensimit të Pronave nr. {\*\*\*}, datë 20.09.1994.

<sup>154</sup> Nëna e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit Xhezair Zaganjori.

<sup>155</sup> Për apartamentin në bashkëpronësi me bashkëshorten, me sipërfaqe 287 m<sup>2</sup>, vlera 7,4 milionë lekë; për bibliotekën, pjesën ideale të tij dhe të bashkëshortes (sipërfaqja 70 m<sup>2</sup>) në bashkëpronësi me 6 persona të tjerë të familjes M-Z., vlera 1,8 milionë lekë; për bodrumin, pjesën ideale të tij dhe të bashkëshortes (sipërfaqja 90 m<sup>2</sup>) në bashkëpronësi me 6 persona të tjerë të familjes M-Z, vlera 1,5 milionë lekë.



deklaratën e pasurisë së rivlerësimit ka deklaruar të 4 (katra) pasuritë e paluajtshme, duke referuar për secilën prej tyre vlerën e shpenzuar<sup>156</sup>/investuar prej tij, në total në shumën 8,4 milionë lekë.

**2.b.3.** Në një vlerësim të ndryshëm nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues e trupit gjykues, arsyetohet se nëpërmjet këtyre akteve rezultoi që:

a) në vitin 1996, në momentin kur është ndërtuar kjo godinë, origjina e të paktën 292 m<sup>2</sup> truall<sup>157</sup> ka qenë pronë e z. H.M. dhe znj. Sh.Z.<sup>158</sup> dhe më pas në vitin 2001 ata janë kompensuar në sipërfaqen pronë shtetërore prej 385 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e njëjtë në madhësi, e cila i ishte njohur, por nuk i ishte kthyer me vendim të KKKP Tiranë në vitin 1994;

b) prona është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi pasi janë dhënë lejet për shesh ndërtimi dhe ndërtimin e godinës nga Bashkia Tiranë, pra organi kompetent për verifikimin e plotësisimit të kushteve dhe kriterëve ligjore nga pronarët mbi të gjithë sipërfaqen në pronësi që do të zhvillohej;

c) sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 01.08.1996:

- i. palë në këtë kontratë është familja M-Z, e përfaqësuar nga znj. M.H;
- ii. investitorë për financimin<sup>159</sup> e punimeve janë familja M-Z, duke përfshirë në këtë mënyrë dhe trashëgimtarët ligjorë të këtyre familjeve;
- iii. pagesa për ndërtimin e godinës bëhej nga investitorët<sup>160</sup>, pra familja M-Z, me para në dorë, sipas situacioneve të punimeve që paraqiteshin nga sipërmarrësi. Pra mënyra e pagesës e dakortësuar nga palët ka qenë me para në dorë, përfshirë këtu dhe pagesa në formë investimi e subjektit të rivlerësimit;
- iv. afati i punimeve<sup>161</sup> ishte deri më 31 mars 1997, me mundësi shtyrje nëse investitori, pra familja M-Z, do të rriste volumin e punimeve<sup>162</sup>;

ç) përdorimi i apartamentit ka filluar të paktën nga data që është lidhur kontrata me KESh-in në emër të subjektit të rivlerësimit, pra 13.12.1997, por dhe në vijim nga prindërit e tij, duke qenë se është provuar që në datën 13.01.1999, ai së bashku me prindërit e tij kanë shitur apartamentin që kanë pasur në pronësi së bashku dhe ku prindërit jetonin. Ndërkohë nuk ka rezultuar e provuar as gjatë hetimit administrativ në Komision dhe as gjatë gjykimit në Kolegj, që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur një kontratë qiraje për këtë apartament;

---

<sup>156</sup> Për apartamentin në bashkëpronësi me bashkëshorten, me sipërfaqe 287 m<sup>2</sup>, vlera 5,8 milionë lekë; për bibliotekën pjesën ideale të tij dhe të bashkëshortes (sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>) në bashkëpronësi me 6 persona të tjerë të familjes M-Z, vlera 1,4 milionë lekë; për bodrumin pjesën ideale të tij dhe të bashkëshortes (sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>) në bashkëpronësi me 6 persona të tjerë të familjes M-Z vlera 800 mijë lekë dhe për zyrën, pjesën ideale të tij dhe të bashkëshortes (sipërfaqe 15 m<sup>2</sup>) në bashkëpronësi me 6 persona të tjerë të familjes M-Z, vlera 400 mijë lekë.

<sup>157</sup> 207 m<sup>2</sup>, e kthyer me vendimin e KKKP-së Tiranë në vitin 1994 dhe 85 m<sup>2</sup> sipërfaqe e blerë me kontratë shitblerjeje nga pronarët, z. H.M dhe znj. Sh.Z..

<sup>158</sup> Znj. Sh.Z.i është nëna e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe, sipas neneve 360 e vijues të Kodit Civil, trashëgimtarët ligjorë, në plotësim të kushteve ligjore, do të kishin të drejtën e trashëgimisë mbi këtë pronë dhe investimin e kryer.

<sup>159</sup> Neni "Objekti i kontratës", paragrafi i dytë.

<sup>160</sup> Neni "Kryerja e pagesës dhe forma e saj".

<sup>161</sup> Neni "Afatet e punimeve".

<sup>162</sup> Shtimi i volumit të punimeve ka ndodhur me Vendimin e Këshillit të Rregullim Territorit (KRrT) Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 4.07.1997 për miratimin e rinovimit të lejes dhe shtesës kati për këtë ndërtim.

d) godina, sipas aktit të kolaudimit për kërkesat tekniko-ekonomike të godinës, datë 20.08.2000, ka pasur një vlerë faktike të punimeve në shumën 38 milionë lekë<sup>163</sup>;

dh) familja M-Z e ka konsideruar veten në cilësinë e investitorit, bazuar edhe në kërkesën e paraqitur më datë 18.10.2000, pranë zyrës së hipotekës Tiranë, për regjistrimin e kësaj godine;

e) subjekti i rivlerësimit në deklarin për herë të parë të pasurisë në vitin 2003, por dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ka pranuar që për këto 4 (katër) pasuri të paluajtshme, vlera e tyre në total respektivisht është 9,1 apo 8,4 milionë lekë, pra ¼ pjesë e vlerës totale faktike të punimeve, sipas aktit të kolaudimit për këtë investim, pra nuk është në total 2 milionë lekë, siç ka qenë e parashikuar për këto pasuri në katër kontratat e shitblerjes<sup>164</sup> me z. H.M. dhe znj. Sh.Z., më datë 06.10.2001<sup>165</sup>;

ë) kontratat e shitblerjes të datës 06.10.2001 rikonfirmojnë situatën faktike që ekzistonte para nënshkrimit të tyre, lidhur me 4 (katër) pasuritë e paluajtshme, pra posedimin në masën 100% nga subjekti i rivlerësimit Xhezair Zaganjori dhe bashkëshortja e tij vetëm të apartamentit me sipërfaqe 287 m<sup>2</sup>, ndërkohë që për tri sipërfaqet e tjera, si biblioteka, bodrumi dhe zyra, konfirmohet vazhdimi i posedimit të tyre në bashkëpronësi të çiftit Zaganjori dhe 6 bashkëpronarëve të tjerë.

**2.b.4.** Anëtarët e tjerë të trupit gjykues në ndarjen B të vendimit, në vlerësimin e tyre për mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të paguar vlerën e 4 (katër) pasurive të paluajtshme, pranojnë investimin e subjektit për zhvillimin e pronës së analizuar më sipër në paragrafin 2.b.3. të këtij mendimi paralel, duke marrë në konsideratë vlerën e deklaruar dhe të pranuar prej tij për këto pasuri: 9,1 milionë lekë në total në deklarin për herë të parë në vitin 2003 dhe 8,4 milionë lekë në total në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Ky vlerësim vjen në kundërshtim me atë që vetë anëtarët e tjerë të trupit gjykues kanë arsyetuar në ndarjen A të vendimit, ku kanë pranuar se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për vlerën dhe kohën e dhënies së shumave në formën e investimeve për realizimin e 4 (katër) pasurive mbetën të paprovuara.

**2.b.5.** Nga situata faktike e analizuar më sipër, arsyetohet se për qëllim të kontrollit të pasurisë dhe burimeve të krijimit të saj, rezulton se subjekti i rivlerësimit Xhezair Zaganjori, 4 (katër) pasuritë e paluajtshme:

a) i ka poseduar jo si pasojë e kontratave të shitblerjes së datës 06.10.2001;

b) këto pasuri janë zhvilluar nëpërmjet investimit në kuadër të familjeve M-Z; dhe

c) kanë si moment të përdorimit të tyre të paktën datën kur apartamenti ka filluar të përdoret nga subjekti, sipas kontratës së tij me KESh-in, pra datën 13.12.1997.

Vlerësimi i mësipërm i situatës faktike lidhur me 4 (katër) pasuritë e paluajtshme, i përgjigjet në mënyrë të plotë edhe konkluzionit të anëtarëve të tjerë të trupit gjykues në paragrafin 1 të pikës 88 të vendimit<sup>166</sup>, në të cilin konkludohet që subjekti i rivlerësimit ka investuar për krijimin e këtyre

<sup>163</sup> Sipas pikës 7 të këtij akti, "Vlera faktike e punimeve", citoj: "38.000.000 (tridhjetë e tetë milionë lekë)".

<sup>164</sup> Me vlerë nga 500 mijë lekë secila.

<sup>165</sup> Duke pranuar në këtë mënyrë që si mënyra dhe momenti i fitimit të pronësisë, nuk kanë qenë kontratat e shitblerjes.

<sup>166</sup> "Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mbulimin me të ardhura të ligjshme të krijimit të 4 (katër) pasurive të paluajtshme të ndodhura në Tiranë dhe shpenzimet e kryera deri në vitin 1999, vit në të cilin pretendon se ka shlyer

pasurive, por nuk provoi me të ardhura të ligjshme shpenzimet e kryera për to deri në vitin 1999, vit në të cilin pretendon se ka shlyer tërësisht ndaj bashkëpronarëve diferencën e mbetur për vlerën e investimit të ndërtimit të godinës.

Arsyetimi i mësipërm lidhur me situatën faktike për këto 4 (katër) pasuri të paluajtshme nga subjekti i rivlerësimit, passjell një arsyetim të ndryshëm nga ai i anëtarëve të tjerë të trupit gjykues në paragrafët në vijim të vendimit, kryesisht për ata që lidhen me analizën e kontratave të shitblerjes së datës 06.10.2001, si dhe për paragrafët ku është arsyetuar nëse subjekti kishte të drejtën për të përfituar të ardhura nga qiraja e pasurisë në bashkëpronësi para datës së sipërcituar. Për këto të fundit, ndryshe nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues, arsyetoj se subjekti mund të përfitonte të ardhura nga qiraja edhe para tetorit 2001, por ato nuk mund të konsiderohen të ligjshme, pasi nuk u provua pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura të pretenduara. Pagesat e tatimit mbi qira të kryera nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, pranë Bankës së Kursimeve për llogari të familjes M., përgjatë periudhës tetor 1998 – shkurt 2000<sup>167</sup>, dhe në Bankën “Intesa San Paolo”, për periudhën mars 2000 – janar 2001<sup>168</sup>, nuk provojnë se cilës pasuri i perkasin, dhe nuk i referohen në asnjë rast qirasë së përfituar nga “{\*\*\*}” për pasuritë në bashkëpronësi, të dhëna me qira për llogari edhe të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij.

## **GJYQTARE**

### **Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

---

*tërësisht ndaj bashkëpronarëve diferencën e mbetur për vlerën e investimit të ndërtimit të godinës, si dhe është i pasaktë në deklaratimet e tij në deklaratën fillestare të pasurisë së vitit 2003 dhe në deklaratën vetting lidhur me sipërfaqet, vlerën dhe burimet të krijimit të 4 (katër) pasurive të paluajtshme të ndodhura në Tiranë. Në këto kushte, subjekti gjendet në situatën e parashikuar nga neni 33 pika 5, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.”*

<sup>167</sup> Dokumentacion i paraqitur jo në formën e rregullt ligjore (kopje e panjësuar me origjinalin).

<sup>168</sup> Në janar të vitit 2001 kanë hyrë në fuqi ndryshimet në ligjin nr. 8438/1998, të cilat kalonin detyrimin për tatimin në burim mbi të ardhurat nga qiraja te qiramarrësi, nëse është ishte person fizik apo juridik tregtar.